

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI I EDUKIMIT

DREJTIMI: MËSIMDHËNIE E GJUHËS DHE LETËRSISË SHQIPE

Studimet Postdiplomike – Master



TEZA MASTER

**Kriteret e përzgjedhjes së poezisë në tekstet shkollore të shkallës së
tretë të kurrikulës dhe të nxëniet e saj**

Mentorja:

Prof. asoc. dr. Myrvete Dreshaj-Baliu

Kandidatja:

Adelina Qarkaj

Prishtinë, 2022

© [2021]-[Adelina Qarkaj] Të gjitha të drejtat të rezervuara

ABSTRAKT

Një ndër krijimet më të lëvruara të letërsisë shqipe është poezia, gjini letrare ku bota e brendshme, mendimet dhe ndjenjat më sublime shprehen përmes vargjeve. Poezia është lloji më i kultivuar i krijimtarisë poetike. Ajo është një organizim i veçantë gjuhësor në të cilin futen në relacione shumë të ndërlikuara kuptimet, fjalët, tingujt e nganjëherë edhe forma grafike, pamja etj. Ajo është rezultat i përbashkët i veprimit të të gjitha elementeve dhe se pikërisht pamundësia e ndarjes së elementeve, qofshin ato më të voglat të këtij organizimi gjuhësor, e dallojnë nga format e tjera të shkrimit, ku kuptimet formohen me njësi të tjera brenda teksteve. Rëndësia e poezisë shihet nga pozicioni që zë në librat shkollorë, gjatë të gjitha niveleve shkollore. Në poezi shprehen idealet shoqërore dhe artistike më shumë e më shpejt se në gjinitë e tjera letrare. Pra, nxënësit bien në kontakt qysh herët me lloje të ndryshme të krijimeve poetike, si ato didaktike, atdhetare, humoristike, për natyrën, për kafshët, për bimët etj.

Në këtë punim diplome jemi përpjekur të paraqesim poezinë shqipe dhe të huaj, që është përzgjedhur të mësohet, interpretohet dhe analizohet në tekstet shkollore të klasës VI dhe VII. Pra, qëllimi i këtij hulumtimi është identifikimi i teksteve poetike brenda këtyre librave shkollorë të shkallës së tretë të kurrikulës dhe se sa kjo përzgjedhje është e përshtatshme dhe efikase për këtë nivel shkollor.

Objekt i këtij punimi janë librat shkollorë të klasës VI dhe VII, më saktësisht poezitë e përzgjedhura dhe të përfshira në këto tekste. Gjithashtu gjatë punimit të kësaj teme të diplomës janë realizuar pyetësorët, një me nxënësit dhe një me mësimdhënësit e klasave përkatëse të katër shkollave të qytetit të Mitrovicës: ShFMU “Abdullah Shabani”, “Musa Hoti”, “Ismail Qemali” dhe “Andon Zako Çajupi.

Përmes këtij punimi kemi arritur të shohim shkallën e kriterëve të përzgjedhjes së poezisë në këto tekste dhe të njohjes së saj nga nxënësit, të aftësisë dhe zhvillimit psikik e intelektual të tyre në të kuptuarit dhe në të përjetuarit e saj, në zgjimin e fantazisë dhe kënaqësisë që e marrin nëpërmjet tingëllimës dhe muzikalitetit të saj.

Fjalët kyçe: *Poezi, kurrikulë, tekst shkollor, përzgjedhje, kriterë, nxënës, të nxënës.*

ABSTRACT

One of the most valuable creations of Albanian literature is poetry, the literary genre where the inner world, the most sublime thoughts, feelings, are expressed through verses. Poetry is the most cultivated type of poetic creativity. It is a special linguistic organization in which meanings, words, sounds, sometimes graphic forms, appearance etc., are introduced in very complex relations. It is the result of the action of all the elements and the punctuality of the impossibility of separating the elements, be they more to be linguistically organized, and distinguish the format of others of writing, where meanings are formed with other units within the texts. The importance of poetry is seen from its position in the school books, throughout this school level. In poetry the social and artistic idea is expressed much faster than in other literary genres. So, students come in contact from an early age with different types of poetic creations, such as didactic, patriotic, humorous, about nature, animals, plants, etc.

In this thesis, we have tried to present ourselves in Albanian and foreign, which has been selected to be taught, interpreted and analysed in textbooks of grades VI and VII. So, the purpose of this research is to identify the poetic texts within the textbooks of the third level of the curriculum and how much this selection is necessary and efficient for this school level.

The object of the work are the sixth and seventh grade school books, more precisely the selected poems and included in these texts. During the work on this topic of diplomacy, questionnaires were completed, one of the students and a teacher of the fourth part of the city of Mitrovica: ShFMU "Abdullah Shabani", "Musa Hoti", Ismail Qemali " and " Andon Zako Çajupi ". Through the work we have managed to see the degree of criteria for the selection of poetry in these texts and its recognition by students, the ability and psychic ability of their intellectuals to understand and not to appear, to awaken a fantasy and pleasure. That participates in its sound and musicality.

Keywords: Poetry, curriculum, textbook, selection, criteria, student, learner.

DEDIKIM

Këtë punim diplome ua dedikoj prindërve të mi, të cilët përherë qenë dorë e zgjatur për ndihmë dhe një shpresë e dhënë.

Babushi dhe nana besuan fuqishëm në mua, ndaj sot le t'i gëzohen suksesit tim!

FALËNDERIM

Shtigjet e ngushta e rrugët e vështira bëhen më lehtë të kalueshme me ndihmën e miqve, familjarëve e gjithë atyre që na qëndrojnë pranë në rrugëtimin e jetës. Nga zemra u jam mirënjohëse dhe falënderuese të gjithë atyre që ndihmuan në realizimin e këtij punimi. Përjetësisht falënderuese ndaj mentores sime, Prof. dr. Myrvete Dreshaj-Baliu, e cila për asnjë moment nuk kurseu këshillat, udhëzimet e rekomandimet në mënyrë që punimi im të jetë sa më i realizuar. Këshillat dhe profesionalizmi i saj janë rruga ime e ndritur. Kemi nevojë për njerëz inspirues e plot pozitivitet si Profesoresha, me të çdo rrugë bëhet e ndritur, çdo urë e kalueshme dhe çdo përfundim i lumtur. Me fat që e njoha dhe isha studentja e saj. Falënderim zemre shkon për familjen time, këta janë mbështetja ime më e madhe, krahu im i djathtë gjatë gjithë rrugëtimin tim dhe ngritjes intelektuale.

Faleminderit!

Përmbajtja	
ABSTRAKT	III
DEDIKIM	V
FALËNDERIM	VI
Lista e figurave	X
I. HYRJE	13
II. SHQYRTIMI I LITERATURËS	15
II.1 Arti poetik.....	19
II.2 Llojet e poezisë	21
II.2.1 Poezia lirike	21
II.2.2 Poezia epike.....	24
II.2.3 Llojet e poezisë epike	26
II.2.4 Poezia dramatike	27
II.3 Elementet e poezisë	29
II.3.1 Muzikaliteti.....	30
II.3.2 Imazhi poetik.....	30
II.3.4 Vargu	31
II.3.5 Rima.....	32
II.3.6 Figurat stilistike	32
II.4 Ndikimi i poezisë të nxënësit dhe perceptimi i saj	36

II.5 Kriteret për hartimin e teksteve shkollore dhe përzgjedhjes së poezive në shkallën e tretë të kurrikulës.....	39
II.6 Poezia në tekstet shkollore të shkallës së tretë të kurrikulës, përfshirja e pjeshme e poezive në librin e klasës VI.....	46
II.6.1 Përfaqësimi i poezisë në librin Gjuha shqipe 6 - Fletore pune.....	54
II.6.2 Mospërfshirja e poezive në tekstin Gjuhë shqipe 7.....	55
II.6.3 Poezia në librin Gjuha shqipe 7 - Fletore pune	59
II.6.4. Mungesa e aparaturës didaktike për poezinë në tekstet shkollore të shkallës së tretë të kurrikulës (Gjuha shqipe 6 dhe 7).....	66
II.7 Krahasimi i teksteve Gjuhë shqipe 6 dhe 7 (botimet e Dukagjinit), të përcaktuara me kurrikulë dhe tekstet paraprake, Leximi letrar 6 (botimet Albas) dhe Leximi letrar 7 (botimet Libri shkollor).....	72
III. METODOLOGJIA	77
III.1. Qëllimi i hulumtimit.....	77
III.2. Pyetjet e hulumtimit	77
III.4. Hipotezat e këtij punimi janë:	78
IV. ANALIZA E TË DHËNAVE DHE REZULTATET.....	81
Testimi i hipotezave	109
IV. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME	111
Rekomandimet	113
Bibliografia	114
SHTOJCA A.....	116

Pyetësor për nxënës.....	116
SHTOJCA B	118
Pyetësor për mësimdhënës.....	118

Lista e figurave

Figura 1. A ju pëlqen poezia?	81
Figura 2. A mësoni shpesh poezi?	81
Figura 3. A mësoni poezi përmendsh?	69
Figura 4. A i kuptoni poezitë që i mësoni në shkollë?	70
Figura 5. A i komentoni poezitë që i mësoni në shkollë?	71
Figura 6. A ju duken interesante poezitë që i mësoni në shkollë?	85
Figura 7. A e dini ndonjë poezi që e keni mësuar në shkollë?	85
Figura 8. A ju pëlqejnë më shumë poezitë e shkruara nga shkrimtarët shqiptarë apo të huaj?	73
Figura 9. A i recitoni poezitë që i mësoni, në shkollë, në klasë dhe në programe?	73
Figura 10. A i njihni figurat stilistike?	87

Lista e Tabelave

Tabela 1. Shpërndarja e mostrës sipas nivelit shkollor dhe gjinisë.	79
Tabela 2. Shpërndarja e mostrës sipas nivelit shkollor dhe moshës	79
Tabela 3. Sa është e përfaqësuar poezia në tekstet shkollore të shkallës së tretë të kurrikulës	89
Tabela 4. Sa jeni të kënaqur me përzgjedhjen e poezive në tekstet shkollore të shkallës së tretë	90
Tabela 5. Sa janë të perceptueshme poezitë e përfshira në këto tekste?	91
Tabela 6. Sa e kanë plotësuar kriterin e përzgjedhjes poezitë në tekstet shkollore të shkallës së tretë	92
Tabela 7. Sa e ndiejnë nxënësit poezinë gjatë interpretimit.....	93
Tabela 8. Sa janë të përshtatshme me moshën e nxënësve poezitë e përzgjedhura në shkallën e tretë të kurrikulës	94
Tabela 9. Me cilat metoda e shpjegoni poezinë para nxënësve	94
Tabela 10. Sa janë të vështira për t'u analizuar poezitë e përzgjedhura në tekstet shkollore të shkallës së tretë	95
Tabela 11. Ju si mësimdhënës gjatë shpjegimit të poezisë, sa shpesh ofroni të dhëna të tjera që nuk ofrohen në libër	97
Tabela 12. A janë të përfshira të gjitha llojet e poezive në tekstet shkollore	98
Tabela 13. Sa është e përfaqësuar poezia në tekstet shkollore të shkallës së tretë	99
Tabela 14. Sa jeni të kënaqur me përzgjedhjen e poezive në tekstet shkollore të shkallës së tretë	100
Tabela 15. Sa janë të perceptueshme poezitë e përfshira në këto tekste.....	101

Tabela 16. Sa e kanë plotësuar kriterin e përzgjedhjes poezitë në tekstet shkollore të shkallës së tretë	102
Tabela 17. Sa e ndiejnë nxënësit poezinë gjatë interpretimit.....	103
Tabela 18. Sa janë të përshtatshme me moshën e nxënëave poezitë e përzgjedhura në shkallën e tretë të kurrikulës	104
Tabela 19. Me cilat metoda e shpjegoni poezinë para nxënësve	105
Tabela 20. Sa janë të vështira për t'u analizuar poezitë e përzgjedhura në tekstet shkollore të shkallës së tretë	106
Tabela 21. Ju si mësimdhënës gjatë shpjegimit të poezisë, sa shpesh ofroni të dhëna të tjera që nuk ofrohen në libër.	107
Tabela 22. A janë të përfshira të gjitha llojet e poezive në tekstet shkollore	108

HYRJE

Poezia është gjini letrare në të cilën mendimet e ndjenjat shprehen në vargje. Konsiderohet se poezia është lloji më i vjetër i krijimtarisë letrare. Me poezi autori shpreh ndjenjat, por edhe vështrimin e tij për ndonjë dukuri apo ngjarje me një gjuhë të fuqishme artistike. Letërsia shqipe, e, në veçanti poezia, zë një vend të rëndësishëm në planprogramet e shkollës dhe në tekstet shkollore. Si gjini letrare poezia lexohet, mësohet, analizohet dhe interpretohet që nga fillimi i shkollës e deri në fund të saj.

Leximi i librave jep ndihmesë në ndërtimin e mendjes së të riut. Lexuesit, jo vetëm që zgjerojnë horizontin e tyre, por edhe identitetin e tyre parësor, kështu që ata janë në gjendje që të shprehin më lehtë mendime dhe t'i arrijnë objektivat e tyre. Krijimi artistik, duke transmetuar një informacion të caktuar, në të njëjtën kohë u transmeton lexuesve kënaqësi estetike. Së bashku me argëtimin e zbavitjen dhe kënaqësitë, leximi i një krijimi artistik e pajis nxënësin me një sasi dijenish të reja, realizon funksionin njohës. Gjatë leximit ose pasi e mbarojnë leximin, nxënësit bien në mendime, meditojnë, nxjerrin përfundimet e veta, miratojnë apo kundërshtojnë krijimet artistike, nxjerrin mësim nga përvoja e tyre, mësim që mund t'u shërbejnë më vonë në jetë.

Pra, duke lexuar një krijim artistik, qoftë poezi apo prozë, nxënësi emocionohet, gëzohet apo hidhërohet, pëlqen apo urren një dukuri, një veprim, një ves, një virtyt. Krijimi artistik ka vepruar mbi mendimet e nxënësit mbi karakterin e tij, në vullnetin e psikologjinë e tij. Ndaj themi se me forcën emocionuese, vepra artistike realizon edhe funksionin edukues. Fëmija është qenie e njomë njerëzore. Gjatë leximit ai kërkon të dëfrehet e të argëtohet. Poeti për fëmijë Mark Krasniqi shprehet: Fëmijët, para së gjithash, duan lojën dhe argëtimin. Letërsia që shkruhet për ta duhet së pari t'u ofrojë këtë kënaqësi të tyre.

Pra, në këtë punim do të përpiqemi të sjellim një gjini letrare të letërsisë shqipe, saktësisht poezinë, dhe do të flasim për të në rrafshin me të gjerë, duke analizuar llojet dhe format e saj. Do të përpiqemi të theksojmë se çfarë roli ka dhe çfarë vendi zë kjo gjini në tekstet shkollore të shkollës së tretë si dhe sa janë të edukuar nxënësit ta përvetësojnë një kulturë të tillë. Në pjesën e parë të punimit do të flasim për gjininë letrare, poezinë në përgjithësi, duke vazhduar më pas me llojet dhe format e kësaj gjinie, duke shpjeguar me radhë, poezinë lirike, epike dhe atë dramatike. Në pjesën e dytë do të mundohemi të shohim se sa janë të pranishme këto lloje të poezive nëpër librat

e gjuhës dhe letërsisë që janë dedikuar për nxënësit e klasave VI dhe VII. Do të shohim se a janë dhënë informacione dhe poezi të mjaftueshme për secilin lloj, në mënyrë që ata t'i dallojnë ata nëpër libra të ndryshëm, qofshin ato tekste shkollore dhe të tjera. Pjesa e tretë e punimit të kësaj diplome do t'ia japë hapësirën edhe hulumtimit që do të organizohet nëpër shkollat fillore, përmes dy pyetësorëve, një për nxënës të klasave VI dhe VII, si dhe një pyetësor për mësuesin duke u munduar që të sjellim rezultate sa më të sakta, në mënyrë që ky punim të jetë sa më i realizuar.

Nga ky punim masteri do të përpiqemi të nxjerrim rezultate të mjaftueshme për sa i përket përzgjedhjes së poezive dhe llojeve të saj dhe mënyrën se si ato u ofrohen nxënësve, me qëllim të njohjes së tyre, analizës dhe interpretimit. Në kuadër të këtij hulumtimi është e rëndësishme të theksohet se nxënësit duhet t'i dinë gjërat elementare për poezinë, si gjini letrare dhe, në veçanti, llojet dhe veçoritë e poezisë. Nëpërmjet njohjes dhe analizës së poezive nxënësit do të arrijnë të krijojnë një kulturë leximi e shkrimi, pse jo edhe krijimi. Një lexues i mirë dhe i rregullt mund të bëhet edhe një krijues i shkëlqyer.

II. SHQYRTIMI I LITERATURËS

Të folurit dhe gjuha luajnë rol dhe funksion të shumëfishtë në jetën e njeriut dhe në zhvillimin e shoqërisë njerëzore në përgjithësi dhe të kombit në veçanti. Brada shprehet se Gjuha shqipe si lëndë mësimi paraqet sistem të përbërë njohurish, shkathtësish dhe shprehish lidhur me kulturën gjuhësore dhe me krijimtarinë kulminante letrare të kombit tonë dhe të kombeve të avancuara. Gjuha shqipe ka për objektiv arsimor njohjen dhe aftësimin e nxënësve të kuptojnë, të përjetojnë dhe të përvetësojnë sistemin elementar të njohurive nga historia e letërsisë, nga teoria e letërsisë dhe nga kritika letrare, nga krijimtaria bashkëkohore letraro-artistike nga poezia, proza, poezia dramatike dhe filmi. (Brada, 2005).

Lënda e gjuhës shqipe dhe ajo e letërsisë zënë një vend të rëndësishëm në planet dhe programet mësimore duke synuar që të sigurojnë përvetësimin e qëndrueshëm të elementeve bazë të normës letrare. Në mënyrë të veçantë, letërsia me pasurinë e mjeteve shprehëse që burojnë nga ligjërimi i gjallë i popullit e zgjeron formimin gjuhësor të nxënësve, krijon tek ata ndjenjën e së bukurës për gjuhën e shijen e shëndoshë gjuhësore. (Gjokutaj, 2012).

Gjuha shqipe luan rol të rëndësishëm për mësimdhënien dhe mësimnxënien nëpër shkollat tona. Meqë tema e kësaj diplome do të jetë nga letërsia, saktësisht poezia, është hulumtuar pjesa ku janë përfshirë tekstet poetike të shkruara nga autorët tanë, por edhe të huaj të tekstet shkollore të shkallës së tretë të kurrikulës të përcaktuara nga MASHT-i si dhe tekstet e Albasit e të Librit shkollor, të cilat janë përdorur më parë për këtë shkallë kurrikule. Të rëndësishme së parë do të jenë tekstet shkollore të përcaktuara me kurrikulë: Librat bazë të gjuhës dhe letërsisë shqipe për klasat VI dhe VII, fletoret e punës për këto dy klasë si dhe tekstet e Albasit dhe të Librit shkollor për shkallën e tretë. Për realizimin e këtij punimi të diplomës rëndësi të veçantë ka poezia dhe vendi që zë në tekstet shkollore, andaj është e rëndësishme t'i theksojmë veçoritë e saj themelore. Për poezinë ka studime dhe shkrime kritike të shumta, ne në punimin tonë do të shfrytëzojmë disa studime nga autorët shqiptarë dhe të huaj. Studiuesi Ali Aliu shprehet: Përgjithësisht në letërsi ekzistojnë lloje të atilla ku në radhë të parë shquhet dhe mbizotëron prirja dhe natyra lirike që do

të thotë shquhet disponimi emocional, intim dhe subjektiv i poetit, siç janë llojet letrare të shkurtra në vargje - vëllimet me poezi. (Aliu, 1986).

Ekzistojnë lloje të atilla letrare të cilat në radhë të parë mbizotëron rrëfimi i mirëfilltë i një ngjarjeje e transponimi objektiv i ngjarjes nga realiteti ku kemi personazhe karakter dhe ku shkrimtari rrëfen përmes të tjerëve, pra objektivisht siç janë llojet e gjata letrare në prozë dhe vargje - romani, novela, epi etj. Brenda këtyre veçorive themelore do të hyjnë edhe llojet e gjinisë dramatike, të cilat dallohen për shkak se komunikimi i tyre primar bëhet përmes realizimit skenik, teatër, film, ku do të hynin komedia, tragjedia, drama etj.

Lirizmi prek ndjenjat, në thelb shpërthimet lirike janë në natyrën e poezisë, ato e parapëlqejnë poezinë për shfaqjen e tyre. Për ta realizuar më së miri këtë derdhje ndjenjash poezia zgjedh format më të përshtatshme e më të mira, zgjedh formën poetike: qoftë si poezi e rimuar, me një rregullsi të përcaktuar qartë të ndërtimit të vargut poetik, që është e lëvruar me shekuj dhe poezia e re s'bën tjetër veç shkon në hullinë e tradicionales, ndër më të njohurat po përmendim: vjershat e rimuara me sistem vargu të përcaktuar, baladat, sonetet, elegjitë, rregullat e ndërtimit të të cilave po i japim, për të mos e rënduar librin; qoftë përmes formash poetike të gjetura nga vetë autorët, apo të huazuara nga ndonjë paraardhës, por që aspak nuk na pengon ta shqyrtojmë si krijim origjinal. (P. Tevo, 2000).

Poezia është një krijim artistik shpirtëror, me vlerë të dëshmuar estetike, universale për qytetërimin botëror. Ajo këtë karakter e ka argumentuar me historinë e vet brenda historisë së popujve të njohur sot. Madje shpesh ajo i ka mbijetuar edhe krijesat civilizuese të shumë popujve, duke u kthyer në diçka të vlefshme dhe të rëndësishme për ata popuj, vendet e tyre dhe kohën. (Rahmani, 2008). Ndërkaq Milivoj Solar thekson se poezia është tip i tillë në të cilën vëmendje të posaçme u kushtohet veçorive të gjuhës, gjë që del nga fakti se fjala, përveç që shënjon diçka, ka edhe "vlerë" të pavarur, si fjalë që "tingëllon", nëse fjalët organizohen në mënyrë që të mos ndërliqhen vetëm me lidhjet e kuptimeve të tyre të para, por edhe me disa karakteristika të tyre tingullore (për shembull me rimat), me disa lidhje që nuk varen vetëm nga ritmi i natyrshëm i të folurit, por e drejtojnë kuptimin në drejtim të asociacioneve jo të zakonshme në marrëveshjen e përgjithshme, patjetër lind poezia. Poezia sikur kërkon që të lirohemi krejtësisht nga shprehja e përdorimit të përditshëm të fjalëve. Ajo kërkon që kuptimi i saj të mos realizohet mbi themelet e lidhjeve

kuptimore të drejtpërdrejta, midis fjalëve, si shenja të rastit, por të realizohet në një fushë më të gjerë të kuptimeve dhe sugjerimeve, që i krijon gjuha në të gjitha përmasat e veta. (Solar, 2004).

Letërsia është një shkrim që thërret për lexim dhe i përfshin lexuesit në problemet e kuptimit. Le të marrim, bie fjala, poezinë; Studiuesi amerikan Lorens Perin thotë: Në të gjitha kohërat dhe në të gjitha vendet poezia është shkruar, lexuar dhe dëgjuar nga të tëra llojet dhe shkallët shoqërore të njerëzve që nga ushtarakë, qeveritarë, gjyqtarë, mjekë, fermerë. Në të gjitha kohërat ajo ka qenë veçanërisht çështje e edukimit, inteligjencës, ndjeshmërisë, si dhe u është drejtuar në formën më të thjeshtë të pashkolluarve dhe fëmijëve. Përse? Sepse ajo, së pari, ka dhënë kënaqësi, njerëzit e kanë dëgjuar, lexuar apo recituar, sepse ajo u dhuronte kënaqësi të veçantë. (Bishqemi, 2004)

Poezia, para se gjithash, duhet të bartë karakterin edukativ e didaktik, për ta arritur realizimin e vet letrar. Agim Deva thekson se Arti për fëmijë, pa pasurinë e vet nuk është art. Gaqo Bushaka shprehet se karakteri qëllimor, më saktë funksional edukues është një tipar i brendshëm tipologjik i llojit i pamungueshëm në asnjë vepër të letërsisë së mirëfilltë për fëmijë të çdo vendi e çdo epoke: dihet gjithashtu se funksioni-edukues dhe vlera estetike janë cilësi që nuk e përjashtojnë njëra-tjetrën.

Domenin didaktik të poezisë e vë në pah edhe Zejnullah Rrahmani i cili thekson se letërsia-poezia didaktike synon të japë këshilla ose të mësojë. Nganjëherë kjo poezi quhet kështu për t'u dalluar nga poezia tjetër e cila konsiderohet si poezi e pastër. Në këtë rast kjo e dyta, do të thotë që është e krijuar ashtu që nuk jep udhëzime ose mësim (përfshirë ato morale), po është krijuar për t'u shijuar estetikisht. (Rrahmani, 2001).

Agim Vinca ka studiuar poezinë e sotme shqipe në tërësi, në rrafshin historiko-letrar, strukturën e poezisë, përkatësisht strukturën e procesit të zhvillimit të saj në periudhën ndërmjet viteve 1945-1980. Sipas Vincës, poezia e sotme shqipe në pikëpamje historiko-letrare mund të konsiderohet si një fenomen në zhvillim e sipër, si një proces i papërfunduar. Për këtë arsye, si dhe për shkak të gjeografisë së saj specifike letrare, studimi i poezisë së sotme shqipe përcillet me vështirësi të natyrave të ndryshme: ideore dhe estetike, teorike dhe praktike. Sipas disa të dhënave bibliografike, vetëm në letërsinë që krijohet në Shqipëri, në periudhën ndërmjet viteve 1944-1976, janë botuar rreth 490 botime me poezi, kurse në Kosovë, respektivisht në Jugosllavi, prej çlirimit e deri në fund të vitit kalendarik 1980, janë publikuar gjithsej 244 përmbledhje vjershash origjinale

për të rritur pa llogaritur këtu edhe ribotimet dhe botimet me poezi të zgjedhura, që, po ashtu, janë të shumta dhe që, doemos, duhen konsultuar. (Vinca, 1985).

Studiuesi Deva thekson se me plot të drejtë mund të thuhet se letërsia për fëmijë sot e ka vendin e vet autoritativ në sistemin e gjithmbarshëm të vlerave tona letrare dhe paraqet një hark të begatshëm problemor, ku, pa dyshim, poezia luan rol të rëndësishëm, jo vetëm për kah impulset e saj kreative, por edhe për kah reflekset kohore-historike që ndërliohen me të, për kah pesha e gjithmbarshme e socialitetit të saj tematik. E të gjitha këto projektohen aktivisht edhe në botën e fëmijëve, ku poeti huazon “lëndën” e parë që t’ua kthejë sërish fëmijëve në trajtë më të gdhendur, më estetike, më komplekse për kah porosia dhe më selektive për kah pjesët e përmbajtjes kuptimore. (Deva, 1986).

Poezia jonë për fëmijë është në lidhshmëri të ngushtë me të gjitha fenomenet shpirtërore, materiale dhe intelektuale, sociale e kulturore-arsimore të fëmijëve tanë, të cilët letërsinë, pothuaj në çdo periudhë, e kanë konsideruar udhërrëfyese të denjë të botës së tyre, që është në zhvillim e sipër. Poeti e ka formën e vet të komunikimit, e cila duhet t’u qëndrojë kritereve të duhura. Lindjen e poezisë shqipe për fëmijë e ndihmuan disa faktorë: 1.Trashëgimia e pasur poetike për fëmijë në folklorin tonë burimor; 2.Rrethanat politiko-shoqërore, të cilat shtruan kërkesën e zhvillimit të artit letrar për të vegjlit dhe ambiciet arsimore-iluministe të shkrimtarëve tanë të parë. Prandaj, periudha bifurkative didaktike-moralizuese, në të vërtetë, përfaqësohet përmes shkrimtarëve të Rilindjes sonë Kombëtare. (Deva, 1986).

Nga kjo vijmë në përfundim se krijimet poetike zgjojnë te nxënësit fantazinë dhe kënaqësinë nëpërmjet tingëllimit dhe muzikalitetit të tyre dhe mësimi i tyre në shkollë është i rëndësishëm së veçantë.

II.1 Arti poetik

Poezia është trajta e vjetër e shprehjes letrare. Nëse më herët termin poezi shpesh e kemi përdorur për letërsi, tash është vendi ta përcaktojmë si emërtim vetëm për atë pjesë të letërsisë, e cila si mjet të shprehjes së vet e ka vargun. Në shikim sipërfaqësor si dhe në jetën e përditshme, ky përkufizim me anë të vargut është kryesisht i drejtë, mirëpo në realitetin e poezisë ky përcaktim shpesh është i pamjaftueshëm, sepse nuk duhet të harrojmë që edhe vetë kuptimi i vargut sot është një nocion mjaft i gjerë dhe, përveç vargut tradicional, të matur, ku dihet numri i rrokjeve, i theksave, përfundimet e vargut me rimë, ekziston edhe vargu i lirë, i cili përkon kryesisht me poezinë moderne e me poezinë e sotme, varg që është i çliruar nga elementet e përmendura. Kjo shprehje e vargut në krijime të caktuara arrin deri në shkallë të barazimit me tekstin e prozës, të paktën nga ana e jashtme, grafike e paraqitjes:

“Në pritje zbardhet lumi, zbardhen shelgjet, zbardhet kurora e tij. As zhurmë as bubullimë, as rrjedhë e trembur. Ngrica niset në gishtat e këmbëve e mbaron në zemër. Ura luhetet gjithnjë. Vijnë të dëshpëruarit dhe të shtangur lexojnë qeshjet e dashurive të para në kurorat e zbardhura të plakave të tejlumit. Ura e lotëve. Gjuha e vajit të parë. (Rrahmani, Teoria e letërsisë, fq. 155, 2008)

Kështu kuptimin e poezisë duhet kërkuar përtej organizimit të jashtëm gjuhësor. Natyrisht që edhe një tekst i këtillë poezie nuk i prish të gjitha shenjat që e përcaktojnë, filluar nga fakti që poezia ndodhet me një libër poezish e deri tek elementet e shprehjes gjuhësore dhe të shprehësisë stilistike në të cilën ajo që është vlerë semantike dhe ajo është shprehje, formë, konkretizim grafik, janë e njëjta gjë, janë një tërësi dhe dalin nga njëra-tjetra.

Në procesin e të kuptuarit të saj këto gjëra nuk mund të ndahen. Këto vlejnjë sidomos për tipin e poezisë që e njohim si poezi e shkurtër, ose e vogël, të cilën zakonisht e identifikojmë me poezinë lirike, sepse analiza e kësaj poezie, në të vërtetë, dëshmon që poezia lirike, sado e gjatë të jetë, prapë është relativisht e vogël në krahasim me disa lloje të tjera të poezisë që në traditën poetike i

njohim si lloje të poezisë epike. Kjo ndarje mbështetet në tipare të tjera që janë në natyrën e dallimeve midis këtyre dy gjinive, dallime që janë të natyrës së tyre dhe, njëkohësisht, të strukturës ku shkurtësia dhe gjatësia janë tipare dalluese, sepse përcaktojnë strukturën e brendshme, ndërtimin e kompozicionit, lidhjen e njësive të veçanta etj. Por, edhe në rastin e parë edhe në rastin e dytë është një fije e artë që rrjedh nëpër krijimin poetik dhe që është ajo lidhja midis krijimit e krijuesit, poetit. Poezia është krijim i poetit. (Rrahmani, Teoria e letërsisë, fq. 156, 2008).

Poezia është një krijim artistik shpirtëror, me vlerë të dëshmuar estetike e universale për qytetërimin botëror. Ajo këtë karakter e ka argumentuar me historinë e vet brenda historisë së popujve të njohur sot. Madje shpesh ajo i ka mbijetuar edhe krijesat civilizuese të shumë popujve, duke u kthyer në diçka të vlefshme dhe të rëndësishme për ata popuj, vendet e tyre dhe kohën. Lirisht mund të thuhet që poezia i ka mbijetuar popujt e ndryshëm duke argumentuar kështu se ajo përmban në vete atë që e quajmë frymë të përhershme. Shumë popuj të cilët në rrjedhën e tyre historike nuk e kanë zhvilluar, ose, të paktën, në një fazë të atij zhvillimi nuk e kanë kultivuar, mësimin, shkrim-leximin, e kanë zhvilluar poezinë e pashkruar apo gojore, kurse popuj të tjerë të mësuar e kanë zhvilluar poezinë shumë më të gjerë e më të rëndësishme për nga vlerat e saj sesa poezia gojore, në formë të shkruar. Kultura e shkruar ka bërë të mundur përcjelljen e njohurive në mënyrë shumë më të thellë e më sistematike midis brezëve të veta përgjatë historisë së popujve, edhe njerëzimit në tërësi. Kjo ka bërë që edhe funksioni i poezisë si dhe vlerat e saj përgjithësisht të jenë më të rëndësishme e më të mëdha. Me qenien e vet, poezia shpejt i ka kaluar barrierat gjuhësore të popujve, kështu që mund të themi se poezia nuk njih barrierat, për të nuk paraqet pengesë qenia e kulturës tjetër në të cilën e nis funksionimin.

Ta zëmë *Iliada* e Homerit në leximin e saj shqip; gjithashtu nuk njih barrierat e moshës: ne vazhdojmë ta lexojmë me kënaqësi veprën e Naim Frashërit *Lulet e verës*, edhe pse ajo është shkruar rreth njëqind vjet më përpara; ose të natyrës së zhanrit, për shembull, e lexojmë me pasion veprën e madhe të Gjergj Fishtës *Lahuta e Malcis* që në këtë aspekt paraqet për kohën e sotme zhanër që nuk kultivohet më; dhe më në fund vlera e poezisë nuk kufizohet nga përkatësia e saj në aspektin e religjionit të autorit, ose pikëpamjeve religjioze që ajo mund të shprehë: bota e krishterë e lexon me interes të veçantë veprën e madhe të Xhalaludin Rumi: ashtu siç lexohet në botën islame vepra e Xhon Miltonit *Parajsa e humbur*. Brenda kulturës shqipe njësoj

funksionon vepra e N. Frashërit, e cila me një pjesë të rëndësishme të saj (*Lulet e verës, Fletore e bektashinjve, Qerbelaja*) shpreh një frymë të fuqishme religjioze islamike, ku bën pjesë edhe një misticizëm i Naimit. (Rrahmani, Teoria e letërsisë, fq. 157, 2008).

II.2 Llojet e poezisë

Poezia është një zhanër letrar që mund të paraqitet në mënyra të ndryshme, ndër llojet më të përdorura nga poetet janë: poezia lirike, epike dhe dramatike.

II.2.1 Poezia lirike

Poezia lirike është quajtur sipas instrumentit lyra me të cilën përcillej kur këndohej ose vallëzohej. Disa prej elementeve përcjellëse në ndërkohë i ka humbur, mirëpo esencën e shprehjes së vet e ka ruajtur nëpër mijëvjeçarë: lirika është poezi e shkurtër që i shpreh ndjenjat dhe mendimet tona në mënyrë të bukur dhe muzikore.

Nga ajo që ka arritur si trashëgimi poetike e lashtësisë, ne e shohim se lirika i lidh fjalët dhe kuptimet në mënyrë të befasishme dhe të papritura, të shumtën duke përafuar koncepte e ide që nuk janë të afërta dhe shpesh kundërshtohen dhe janë të papajtueshme përveçse në botën e poezisë, të vjershës.

Poezinë lirike e përjetojmë nga pozicioni i njeriut që është futur befasisht në një kopsht dhe duke e kërkuar rrugën për të dalë prej aty, futemi përfundimisht thellë e më thellë dhe me gjuhën e mendjes mund të prekim e përjetojmë si kënaqësi estetike gjërat që i ndeshim përgjatë leximit, t'i ndiejmë ato shpeshherë pothuajse sikur të ishin ndjenjat tona, të ishte qëndrimi ynë, të ishte bota e fshehtë që hapet përmes gjuhës së figurshme, pikërisht bota jonë. Pozicioni i leximit është identik me pozicionin e poetit i cili e shkruan vjershën:

Poezia lirike kombinon fjalën e zgjedhur, shprehëse, gjuhën e figurshme, tingëllimin e këndshëm, ritmin, për ta shprehur në pak vargje esencën e botës së veprës:

Jam mahnitur nga bukuri,

sepse kur të shoh.

Më mbushet mendja se Hermiona kurrë nuk ka qenë.

Kaq e bukur (Rrahmani, Teoria e letërsisë, fq. 225, 2008)

Lirika përshkruan ndjenjat, shpreh brendësinë, shpirtin e njeriut. Ajo në një pjesë të momentit e ndërton figurën që flet një mijë herë më shumë se fjala:

Ne nuk mundemi

të matemi me perënditë

nga bukuria

por ti....(Rrahmani, Teoria e letërsisë, fq. 225, 2008)

Nëse emocioni kryesor në një poezi të këtillë lirike është urrejtja ose përçmimi, dhe nëse shprehësia e saj është spirituoze, poezia zakonisht quhet satirë. Përkundër organizimit të ndjeshëm, në të cilin zgjidhet e renditet çdo tingull, çdo fjalë, çdo varg, çdo kuptim etj. Poezia lirike e ruan aftësinë e drejtpërdrejtë me atë që e lexon, sepse autori i drejtohet atij nga pozita brenda poezisë. Poeti e shkruan poezinë lirike nga pozicioni i vetes, unë, poeti, është brenda veprës poetike, ndërsa lexuesi futet në këtë pozitë në çastin e fillimit të leximit.

Lirika lexohet si të ishte pjesë e vetes, si ligjërim personal, sepse ajo përmbledh në vete, pos funksioneve të tjera të paktën, edhe një funksion shprehës:

Këtu vaji e trishtimi veç ndihen ndër shpija këtu ndihet... tingëllimi i hekrave t'mija e gjama e një t'shkretit qi merr vala e detit (Rrahmani, Teoria e letërsisë, fq. 226, 2008)

Këtu afektiviteti është krijuar përmes ritmit të enumeracionit të kuptimeve të trishta, në fjalët dominon tingulli dhe fjalët me burim onomatopeik, të gjitha të fushës tematike të një gjendje të rëndë shpirtërore, ku të vetmet koncepte që dalin jashtë kësaj fushë janë valët e detit që shuajnë qoftë edhe gjëmën e vajit dhe hekurat; ftohtësia e tyre metalike shpreh kulmin e moskokëçarjes së rrethit ndaj ndjenjës kaq të thellë të njeriut. Poezia lirike temën e vet e realizon, jo si epika apo dramatika përmes ndërtimeve fabulative, po me anë të lidhjes së asociacioneve të caktuara të motiveve. Poezia lirike i ka temat e pakufizuara, prandaj vendosja e tematikës si kriter për klasifikimin e lirikës në lloje e shpie secilin, që provon ta bëjë këtë në sprovë, çka të

konsiderojë si lloj e çka jo. Sipas këtij kriteri dallojmë: lirika e dashurisë, lirika atdhetare, lirika e peizazhit, lirika sociale, lirika religjioze, lirika mendimtare.

Llojet e lirikës që i hasim prej antikës janë: himni, oda, elegjia, idili, ditirambi, epigrami, epitafi.

Një klasifikim tjetër i mundshëm i poezisë lirike është ndarja e saj në:

- poezinë lirike tradicionale

- poezinë lirike moderne.

Himni është një këngë e lashtë e zhvilluar në kultura të pasura me mite. Zakonisht himni u kushtohet hyjnive, atyre krijesave të larta, figura e të cilave ishte e denjë për respekt e lavdërime madhështore.

Elegjia sipas greqishtes elegos - vajtim, ishin poezitë e shkruara me diskun elegjiak. Më vonë ky lloj i lirikës ka marrë karakterin e poezisë që i këndon pikëllimit, për personin e dashur të humbur ose për diçka të parrealizueshme. Elegjinë e përcakton toni i dhimbshëm pikëllues. Në poezinë shqipe elegjitë më të njohura janë ajo e A. Z. Çajupit, *Vaje*, si dhe dy elegjitë tipike për zhanrin, të Fan. S. Nolit, elegjia *Shpell' e Dragobisë* dhe *Syrgjyn-vdekur*.

Oda - greqisht ode ose aoide, këngë, këndim, një vjershë me origjinë greke, dikur edhe himni konsiderohej veçse një odë e shenjë, gjë që na shtyn të përfundojmë që edhe këtu i këndohet një personi i cili meriton një adhurim e një lavdërim të lartë, për shkak se ka bërë një vepër të madhe ose ka korrur një fitore të rëndësishme.

Epitafi është një mbishkrim në rrasë të varrit dhe zakonisht shpreh një qëndrim ndaj faktit që jeta kalon. Mund të jetë një mendim shumë i dendur mbi fatin e njeriut.

- Lirika e dashurisë është një nga temat së cilës nuk i shpëton asnjë poet. Dashuria përbën fushën e gjerë e të begatshme të ndjenjës që ushqen djali për vajzën dhe anasjelltas.

- Lirika atdhetare është ajo poezi e cila i këndon me dashuri të madhe atdheut, bukurisë fizike të natyrës së atdheut ose vetive e anëve pozitive të karakterit nacional.

- Lirika e peizazhit, nganjëherë vështirë dallohet prej lirikës atdhetare, sepse porsia ajo u këndon bukurive të natyrës, por poezia e peizazhit e sheh objektin e vet model që reflekton me bukurinë e vet mbi ndjenjën estetike të poetit dhe mesazh tjetër pos mesazhit estetik, zakonisht nuk ka.

- Lirika sociale ndryshe quhet edhe shoqërore dhe, pasi të shumtën kjo lirikë trajton jetën e shtresave të varfra e të pafat, ka qenë lloji i preferuar në disa periudha të letërsisë e, veçanërisht, në sistemin socialist, ku edhe është shfrytëzuar si një lloj propagande në kryqëzatën kundër të pasurve.

II.2.2 Poezia epike

Derisa poezia lirike ka zhvilluar zhanre të shumta dhe të ndryshme, përfshirë edhe llojllojshmërinë e formave të saj, poezia narrative faktikisht përfaqësohet prej formave epike. Poezia epike ka zhvilluar vetëm disa lloje të pakta dhe mendohet që ato, të gjitha, kanë dalë nga njëra-tjetra duke u veçuar për nga qëllimi dhe nga mënyra se si i përdor konvencat e gjinisë për t'ia arritur atij qëllimi. Poezia narrative tregon ngjarje në të cilat marrin pjesë personazhe të ndryshme, heronj, mbretër e perëndi.

Gjatësia e krijimeve epike varet nga ngjarja të cilën e tregon. Ka vepra epike që përmbledhin një incident të vetëm të ngjarjeve më të mëdha dhe në këtë rast, duke pasur për qëllim, të tregojnë vetëm një element të veçuar e të vogël të “ngjarjeve” të shumta që mund të kenë ndodhur, por me të cilat nuk merret, zhvillojnë një subjekt relativisht të thjeshtë dhe me strukturë drejtvizore. E tillë është balada, shpesh e shkruar në strofa, gjë që përgjithësisht nuk është forma e epikës. Të tjera krijime të poezisë narrative i njohim si poema, tema e të cilave mund të jetë edhe biografi, autobiografi, ose mund të kenë karakter humoristik dhe satirik. Lirikën e kemi përcaktuar si lidhje asociacionesh mbi një ose më tepër motive, ku secili, në njëfarë mënyre, është i ri dhe i panjohur, andaj edhe befasues për lexuesin.

Poezia epike trajton ngjarje nga e kaluara dhe të njohura historikisht. Në këtë aspekt poezia epike nuk ofron befasi, sepse lexuesi e di si e kur ka filluar, si ka kulmuar dhe si ka përfunduar një ngjarje. Poezia epike tani përtej kësaj njohjeje i ofron lexuesit një shikim, një variant, mbi ngjarjet duke i trajtuar ato nga një pozicion i dëshmitarit të largët dhe të paanshëm, i cili në mënyrë të ftohtë flet për ngjarje moti të përfunduara dhe të njohura. Në veprën epike e gjejmë gjithë botën e

një kolektivi: botën historike, atë kulturore dhe botën shpirtërore, kështu që kemi përshtypjen e një universi të tërë ku bëjnë pjesë qeniet anonime, njerëzit e dalluar, heronjtë, prijësit, gjysmëperënditë, Zoti etj.

Ndryshe nga poezia lirike e cila është e shkruar në atë mënyrë që lexuesi menjëherë futet brenda, e lexon poezinë si të veten, do të thotë poeti identifikohet në mënyrë me lexuesin, në poezinë epike është narratori (tregimtari) ai që merr rolin e ndërmjetësuesit midis asaj që tregohet dhe lexuesit dyfish duke e krijuar distancën: nga lexuesi dhe nga ngjarjet.

Elementet që i përmendëm deri tash: gjatësia e veprës epike, tema e madhe nga ngjarjet e rëndësishme historike për një kolektiv, fabula e përbërë shpesh prej linjave të shumta që zhvillohen paralelisht ose duke u pleksur personazhet e shumtë, rrëfimi, përshkrimet e shumta e shpesh të gjera të botës e të natyrës etj., bëjnë që vepra epike të ketë një ndërtim apo kompozicion mjaft të lirë, kështu që aty gjejmë një ndarje në pjesë të veçanta, në këngë ose aventura, ose kreu, libri etj. Për veprën epike është karakteristike mënyra e hyrjes në ngjarje pasi poeti supozon që lexuesi e di ngjarjen dhe përfundimin e saj, kështu që këto fakte realisht mbeten jashtë interesimit të tij dhe nuk zgjojnë interesim.

Për këtë arsye vepra nuk nis me fillimin e ngjarjeve në kohë, në epikë gjerësisht aplikohet parimi të cilin e kanë formuluar latinët: *in media res* (në qendër të ndodhive) dhe që nënkupton futjen në situatë të konfliktit, i cili ndodhet para shthurjes. Kësaj i paraprin vetëm një hyrje e shkurtër në të cilën kërkohet ndihma e perëndive dhe mund të përmendet tema e veprës:

Këndo hyjneshë, mërinë e Akil Pelidit që shumë hidhërimet e kobe akejve u sollti

dhe para kohe në skëterrë gremisi

me mijëra shpirtra burrërorë fatosash. (Rrahmani, Teoria e letërsisë, fq.314, 2008)

II.2.3 Llojet e poezisë epike

Epi - Ky lloj e ka marrë emrin nga fjala greke epos - fjala, tregimi; dhe paraqet formën e gjatë të krijimit në vargje. Në përdorim janë edhe termat epos, epope, këngë epike etj., fjalë të cilat vetëm pjesërisht janë të sakta dhe shpesh ngatërrohen si kuptime. Disa me fjalën epos kuptojnë ciklin e epeve që, në njëfarë mënyre, lidhen midis tyre qoftë edhe vetëm me konceptin e gjerë e të mbështetur mbi traditën popullore mitike. Nganjëherë me këtë emër i quajnë ciklet e këngëve epike, të cilat si zhvillim kanë ngelur në një stadium më të ulët sesa epi. Ndërkaq fjala epope u vihet zakonisht epeve të mëdha për dallim nga epet e zakonshme. Në këtë rast epope do të emërtoheshin *Iliada*, *Eneida*, por edhe *Komedia Hyjnore*.

Epi synon ta kapë jetën në totalitetin shoqëror, historik dhe shpirtëror, andaj në ngjarjet e tij marrin pjesë njerëzit nga të gjitha shtresat e një populli, mirëpo heronjtë e tij janë prijësit, mbretërit, gjysmë-hyjnitet etj. Një ep të tillë në letërsinë shqipe e ka shkruar Gjergj Fishta, *Lahuta e Malcis*, në të cilën ka përfshirë periudhën rreth tridhjetëvjeçare që nga Lidhja e Prizrenit deri me shpalljen e pavarësisë dhe krijimin e shtetit shqiptar, pra një periudhë lufte për çlirim nga turqit dhe për mbrojtjen e territoreve shqiptare nga shtetet fqinje.

Kënga epike

Është lloj më i shkurtër sesa epi dhe ndryshe nga epi përfshinte jetën në totalitetin e saj, kjo zakonisht trajton një ngjarje, një episod jete gjithashtu të rëndësishëm, njësoj madhështor dhe pothuajse me të njëjtat personazhe. Një cikël i ngjashëm këngësh epike formon ciklin e *Këngëve të Mujit e Halilit*, ose siç e quajnë ndryshe *Cikli i Këngëve të Kreshnikëve*.

Poema

Rruga normale e zhvillimit të zhanreve epike në periudhën e romantizmit ishte pasurimi i tyre me elemente lirike. Kjo periudhë edhe njihet me faktin se i përziente llojet. Nga epika ka marrë tipin e krijimit fabulativ, pra trajtimin e ngjarjeve të caktuara të cilave u bashkohen një mori motivesh

asociative të tipit të lirikës, kështu që kemi krijimin, i cili ngjarjen e caktuar e këndon me nota të dukshme lirike.

Për periudhën e Romantizmit poema e ka kuptimin ta zëmë të një vepre siç ishin poemat e De Radës: *Këngët e Milosaos*, *Serafina Topia* etj. (Rrahmani, Teoria e letërsisë, fq. 333, 2008)

Romanca

Quhet sipas gjuhës spanjolle, el romance, me të cilën emërohej gjuha popullore spanjolle për dallim nga latinishtja, gjuhë prej së cilës e ka origjinën. Tema e romancës është temë dashurie, brenda ka një ngjarje të cilën e trajton me ritëm të shpejtë, me ton të theksuar e të kthjellët, ndërsa romancat e vjetra mund të trajtonin edhe tema dashurie me përfundim tragjik. Në poezinë shqipe këtë lloj e ka shkruar me sukses Lasgush Poradeci.

II.2.4 Poezia dramatike

Kur e përmendim dramën, menjëherë na shkon mendja për veprat që zakonisht shfaqen në teatër. Madje, edhe kur veprat e tilla i lexojmë, nuk mund të shkëputemi nga mendimi se ato leximin më autentik mund ta kenë në skenën e teatrit derisa ne qëndrojmë në vendin tonë bashkë me publikun, kurse atje para nesh në skenën e rregulluar në mënyrë të veçantë për t'u shfaqur vepra, zhvillohet para syve tanë intriga e fabulës e organizuar si një varg ngjarjesh të lidhura në atë mënyrë që me kapërcimin e një mikroteme, pason ashpërsimi i konfliktit dhe kështu syzheu ngrihet mbi konfliktin i cili nis, rritet e kulmon dhe zgjidhet në fundin e dramës.

Poezia dramatike është gjini e lashtë dhe shumë e rëndësishme e letërsisë që e ka ruajtur vazhdimësinë që nga antika e deri më sot. Mendohet që ka dalë nga forma poetike e quajtur ditiramb që këndohej në lojërat e kremteve të Dionisit, që më herët kremtohej si kult fallusor helen. Gradualisht nga kori që këndonte, do të jetë ndarë këngëtari, kështu që kënga mund të këndohej herë nga grupi e herë nga këngëtari. Prijësi i grupit, korifeu shndërrohej, me ndihmën e maskave, në persona të ndryshëm dhe ky është aktori i parë. Kori kishte rolin e komentuesit.

Poezia dramatike trajton një konflikt i cili është vendimtar për ta zgjidhur dilemën jetësore të personazhit, ai nuk është konflikt që mund të zgjidhet në mënyrë të rëndomtë, përfundimi i tij

shënon ndërrimin e gjendjes nga lumturia në tragjedi dhe, anasjelltas, nga fatkeqësia në lumturi. Ndryshimi i parë e cilëson tragjedinë, ndërsa i dyti komedinë.

Kompozicioni i dramës ndërtohet në atë mënyrë që një konflikt midis heronjve të saj të mund të zhvillohet në mënyrë të plotë, meqenëse heronjtë e saj këtë mund ta arrijnë vetëm përmes veprimit dhe të folurit, është e nevojshme që midis këtyre dy elementeve të ekzistojë uniteti i harmonishëm. Këtë unitet e ka hetuar i pari Aristoteli dhe e ka trajtuar si parim të unitetit të veprimit. Meqenëse veprimi në një vepër dramatike duhet të jetë i plotë, ai domosdo ka fillimin, mesin dhe përfundimin. Në mbështetje të parimit mbi unitetin janë përpunuar gjerësisht fazat nëpër të cilat duhet të kalojë një veprim konflikt dramatik për të qenë i plotë: ekspozicioni, thurja, kulmi, peripecia dhe zgjidhja.

Ekspozicioni është hyrja e cila paraqet fillimin e domosdoshëm të dramës. Këtë e bën shpallja, lista e veçantë e shfaqjes ose në disa drama, prologu i veçantë i cili tregon për ngjarjet që i paraprijnë veprimit të dramës. Veprimi i dramës fillon e thuret me futjen e motivit të ri dinamik i cili zakonisht paraqet thelbin e mëvonshëm të konfliktit. Kulmi i thurjes arrin kur ngjarja e caktuar shtron nevojën e zgjidhjes, mirëpo zgjidhja nuk shtrihet ende në horizont. Peripecia shënon momentin vendimtar kur ngjarja merr befasisht një drejtim, ndërsa shthurja është kur zgjidhen të gjitha kundërshtitë e konfliktet. Të folurit që i afrohet monologut, në të cilin zakonisht njëri nga heronjtë i shpreh disa qëndrime ndaj veprimit të heronjve të tjerë, mirëpo jo si dialog me ta, e quajmë të folurit anash. Këtë të folur e dëgjon publiku, por jo edhe ata që janë në skenë. Dialogu i dramës është i veçantë e i ndryshëm nga biseda e përditshme dhe nga dialogu i veprës në prozë.

Përveç dialogut (greqisht dialogos-bisedim), në dramë përdoret shpesh edhe monologu (sipas greqishtes monos-një, vetë dhe logos-fjalë).

Llojet e hershme të kësaj gjinie janë tragjedia dhe komedia, të shkruara në vargje. Sot përgjithësisht dramat shkruhen në prozë.

Aristoteli në veprën e tij *Poetika* e ka konsideruar tragjedinë (gr. tragës-edh, kec, dhe ode) si imitim i veprimeve të njerëzve më të lartë, veprim që lidhet me diçka të rëndësishme dhe me një stil që, po ashtu, është i lartë. Tragjedia shkruhej në vargje dhe trajtonte tema të rëndësishme si për

individët ashtu edhe për shoqërinë në kuptim më të gjerë. Në fillim ajo kishte numër më të vogël të personazheve dhe ngjarje relativisht të thjeshtë. Tematika e saj ishte e lidhur ngushtë me mitet. Tragjeditë e reja kanë ndryshuar në disa aspekte: shprehjen në varg, kanë inkadruar numër të madh personazhesh, kanë ndryshuar parimet e tjera pos atij të veprimit, mirëpo edhe më tutje heroi i tyre është hero tragjik, faji i tij është gjithnjë tragjik dhe përfundimi tragjik. Tragjedia, sipas rregullave, duhej të shkruhej në vargje, me stil të lartë, në pesë akte dhe të respektonte tri unitetet e tragjedisë, uniteti i veprimit, i vendit dhe i kohës.

Komedia është lloji i lashtë i poezisë dramatike. Origjina e saj shkon në lashtësinë antike dhe mendohet të ketë dalë nga ritet popullore, gjë që sugjerohet nga emri komedi (gr. komodia, nga komos, gazmor dhe ode-këngë). Kori i komedisë dallohet nga kori i tragjedisë, dhe tek Aristofani përbëhej nga përzierjet fantastike, njerëz, kafshë, fenomene natyrore etj. Derisa tragjedia ishte imitim i veprimeve të larta, komedia përcaktohej si imitim i veprimeve të ulëta me stil të ulët.

Në hierarkinë e vlerave heronjtë e komedisë përcaktohen më të ulët se njeriu i zakonshëm, prandaj veprimi i tyre, sjellja, ndjenjat etj., janë qesharake, madje edhe fatkeqësia e tyre duket qesharake dhe e padëmshme. Si formë komedia ishte shumë më e lirë se tragjedia, prandaj është më vështirë të përcaktohen vetitë e përbashkëta. Ndoshta karakteristika thelbësore e veprave të kësaj natyre mund të konsiderohet të qeshurit, fakti që na shtynë të qeshemi kur i shikojmë në skenë ose kur i lexojmë.

II.3 Elementet e poezisë

Poezia përbëhet prej fjalëve, tingëllimeve, figurave, imazheve poetike, ideve, rimave etj., elemente këto që janë harmonizuar brenda formës së poezisë, të shkruar në vargje. Kuptimi i saj, ashtu sikur edhe komunikimi i saj me njerëzit, zë fill në lexim. Shpesh nuk mjafton vetëm leximi, sidomos nuk mjafton leximi kur kemi të bëjmë me një poezi të mirë. Ka shumë poezi që na shtynë t'i mësojmë përmendsh dhe t'i ruajmë në memorien tonë për vite e vite. Kjo tregon që komunikimi midis poezisë dhe lexuesit është shpesh i një rëndësie të madhe dhe ka forma jashtëzakonisht të ndjeshme të atij komunikimi. Sigurisht që ka edhe elemente të largëta të një trashëgimie komunikuese me poezinë. Elementet e tilla nuk janë ndaras. Poezia e mirë zakonisht

i përmban shumicën e elementeve të cilat i përmendëm, por ndodh dhe të mos i ketë dhe sërish poezia nuk humb nga kualiteti.

Ka poezi që mund të kuptohet vetëm në saje të kuptimit të figurave të saj. Ajo është e shkruar me gjuhën e figurave, me gjuhë të figurshme. Poezi të tjera janë të fuqishme e të vlefshme artistikisht, por nuk përmbajnë figura të tilla, janë të shkruara me gjuhën e zakonshme.

II.3.1 Muzikaliteti

Leximi i poezisë nxjerr në shesh menjëherë organizimin tingullor dhe muzikal të poezisë. Këto elemente shfaqen dhe kuptohen shumë më mirë gjatë leximit me zë të lartë ose gjatë recitimit. Janë ato elemente ritmike të cilat e karakterizojnë vargun në përgjithësi: tingujt sonorë, rrokjet e theksuara dhe të patheksuara që përsëriten në intervale ritmike, përfundimet e theksuara dhe me rima, asonancat e ndryshme dhe përgjithësisht përsëritjet e niveleve të ndryshme. Duke lexuar vargjet e poezisë mund të ndihet se si zë fill një lloj melodie e cila shkon duke u ngritur në përfundim në mënyrë të zhurmshme (të bukur për veshin) dhe pastaj vazhdon melodinë e vargut të dytë, e cila gjithashtu përfundon me të njëjtën tingëllimë, duke formuar me atë rast rimën. Poezia *Vaji i Bylbylit* e N. Mjedës mund të japë përgjigje për disa prej elementeve që i përmendëm.

Pushoj murrllani/ me duhi t'vet bylbyl i vorfen/ Çou mos rri shkret (rimat ABCB, vargu pesërrokësh) etj.

II.3.2 Imazhi poetik

Poezia ndërton imazhe poetike. Piktura të krijuara me anë të fjalës. Kur e lexojmë një poezi, mjafton të mbylлим sytë dhe të përfytyrojmë pamjen që na e krijojnë fjalët e poezisë.

Nganjëherë pamja është shumë e qartë dhe konkrete, kurse ndonjëherë është më vështirë të krijohet ajo pamje, mirëpo nuk është e pamundur asnjëherë. Poeti zgjedh dhe përdor fjalë të tilla që ngacmojnë shqisat e lexuesit, ai dërgon drejt lexuesit imazhe të kapshme të cilat ngacmojnë veshin, syrin dhe shpesh edhe shqisën e të prekurit, të të nuhaturit. Ata e bëjnë këtë duke përdorur fjalë të zakonshme, mirëpo të vendosura në lidhje të reja dhe të papritura, kështu që edhe gjërat e tilla të zakonshme përnjëherë, kur i gjejmë në poezi, na duken të reja e të rëndësishme. Poezia i bën gjërat e zakonshme të bukura dhe të përjetohen si poetike.

II.3.3 Strofa

Strofë është të shprehurit e një mendimi dhe ndjenje me anën e disa vargjeve, të cilat përbëjnë një njësi të plotë ritmike dhe rimore. Strofa duhet të ketë disa vargje të lidhura midis tyre me anën e rimës dhe të ritmit. Llojet e strofave emërtohen në bazë të numrit të vargjeve.

Kështu kemi strofa dyvargëshe (*distiku*), strofa trivargëshe (*tercina*), katërvargëshe (*katrena*), pesëvargëshi (*pentastiku*), gjashtëvargëshe (*sektina*), shtatëvargëshe (*septima*), tetëvargëshe (*oktava*), nëntëvargëshe (*nona*), dhjetëvargëshe (*decima*) etj.

Distiku është strofa më e rrallë. Katrena apo strofa katërshe është më e përhapur dhe s'ka poet që nuk shërbehet me të. Më të rralla janë strofat me më shumë vargje. Soneti ose tingëllima është lloj i vjershës me katërmëdhjetë vargje të ndara në katër strofa: dy katrena dhe dy tercina. Ka një sistem standard të rimës.

II.3.4 Vargu

Vargu është njësi. Prej fillimit të një vargu deri në mbarim të tij krijohet një kuptim poetik. Poezia shqipe ka pasur një shumicë vargjesh në fondin e saj kulturor të shprehjes poetike. Të shumtit janë të tipit trokaiik. Kjo do të thotë që në sistemin metrik të shqipes që është një sistem me vlera të dyfishta: rrokje + theks, shumica e vargjeve "shqipe" janë me rrokje çifte: katër, gjashtë, tetë e dhjetë rrokje dhe, sipas logjikës së këtij sistemi të vargëzimit, theksat rrahin në rrokje teke: 1, 3, 5, 7, 9. etj..

Një strukturë të tillë vargu mund ta shpjegojmë me faktin që shumë fjalë të gjuhës shqipe janë fjalë të theksuara në rrokjen e parafundit, pra të natyrës së këmbës trokaiike: - - V; dhe është fakt i njohur që gjuha shqipe ka një theks fjale. Në metrikën shqipe dallohen tri lloje vargjesh: vargjet popullore, vargjet e huazuara dhe vargjet e krijuara. Si lloj i veçantë shpesh përmenden edhe vargjet e lira.

II.3.5 Rima

Edhe rima është veçori e llojeve letrare në vargje. Ajo krijon harmoni në mes vargjeve. Rima arrihet kur rrokjet e fundit të më shumë vargjeve, duke filluar nga rrokja e fundit e theksuar, përputhen në ngjashmëri, krijojnë muzikalitet, harmoni tingujsh. Mund të thuhet se rimë është përsëritja e të njëjtave zanore ose bashkëtingëllore, pra përsëritja e rrokjeve të theksuara në fund të dy a më shumë vargjeve.

Për shembull:

Bariu, shokë, bariu/ kur gjëmon e fryn veriu. Rimën mund ta klasifikojmë edhe nga aspekti i vendit (largësisë) që rimon: rimë e puthur, kur rimat janë në vargjet që shkojnë njëri pas tjetrit: AA BB. Kur të gjitha vargjet janë me të njëjtën rimë kemi monorimë.

Kur rimon vargu i parë me të tretin dhe i dyti me të katërtin, atëherë kemi rimë të alternuar: ABAB. Rima e kryqëzuar është kur vargu i parë rimon me të katërtin, ndërsa i dyti me të tretin: ABBA. Kemi një rimë që lidhet në më shumë vargje: ABA, BCB, CDC, të cilën e quajmë rima zinxhirore.

Kemi një rimë që e quajmë të ndërprerë, se një segment i saj shkëputet: ABAC. Më në fund kemi një rimë të brendshme e cila rimon dy fjalë brenda të njëjtit varg ose brenda vargjeve të ndryshme po jo në mbarim të linjës melodike.

II.3.6 Figurat stilistike

Nocioni i figurës stilistike krahas atij të stilit është ndër nocionet themelore të stilistikës së letërsisë dhe, njëkohësisht, lidhja që është vazhduar nga retorika në stilistikë. Në shek. XVIII trajtimi retorik inkudron shembujt letrarë për figurat. Interesim i veçantë i ka trajtuar figurat e quajtura trope, ndonjëra prej të cilave, p.sh. metafora, qysh në antikë, është konsideruar mbretëreshë e figurave. Në organizimin gjuhësor stilistik të poezisë një kategori të veçantë stilistike e përbëjnë zhvendosjet e fjalëve nga kuptimet e tyre të zakonshme (nga kuptimi i parë) dhe vendosja e lidhjeve të tjera kuptimore të fjalëve që kryesisht bëhet në kuptimet e dyta. Kur një proces të tillë të kryer e hasim

në tekstin poetik, e quajmë figurë. Figura lidhet me kërkesat e veçanta të ndërtimit të imazhit poetik, është formë e konkretizimit të ideve dhe e individualizon shprehjen poetike.

Figurat letrare ndahen në: Figurat tingullore (*të intonacioni*), figurat e fjalorit (*të leksikut*), *figurat e fjalës (tropet)*, figurat e sintaksës (*të kuptimit*).

Figurat tingullore parim organizues e kanë përsëritjen e tingujve brenda njësisë poetike (vargut), në kuadër të një njësie të kompozicionit (strofa) ose në gjithë veprën poetike (poezia). Ndër figurat tingullore më të njohurat janë:

Asonanca emrin e ka marrë nga lat. Assonare - bashkëtingëllim i harmonishëm. Është përsëritje e zanoreve të njëjta në varg: *Fëmijë pa nanë si nata pa hanë*

Aliteracioni - përsëritja e tingujve mund të ketë karakter të përsëritjes së bashkëtingëlloreve: *Err në terr në Ferr.*

Onomatopeja vjen nga greqishtja onoma - emër, poieo - bëj, krijoj. Është fjalë tingullimituese ose përshkrim i dukurive a i sendeve, duke shfrytëzuar imitimin e zhurmave e të zërave: *Nën kërkëllime zingjirësh, frymëmarrje luanësh, ulurimë, kujë e lemeri.*

Anafora është figurë stilistike që formohet duke përsëritur të njëjtin element në fillim të dy a më shumë vargjeve ose frazave, për t'i dhënë forcë shprehjes: *Për atë mot që do të mbruhet brumi në magje, për atë mot që do të vaditej ara mbi lumë.*

Epifora është figurë stilistike që formohet duke përsëritur të njëjtin element në fund të dy a më shumë vargjeve ose frazave, për t'i dhënë forcë shprehjes: *Si s'na u ndanë armiqtë të neveritshmit, barbarët - armiqtë.*

Ndër figurat më të njohura të fjalorit janë: Huazimet, dialektizmat, fjalëformimi dhe fjalët e reja. Ndër figurat më të njohura të fjalës janë: metafora, metonimia, ironia, sarkazma, epiteti, alegoria, krahasimi, antiteza, hiperbola, litota etj.

Metafora vjen nga greqishtja metaphorë - tejbartje, transport. Është quajtur nga grekët e vjetër mbretëresha e tropeve. Ajo emërton një send a një dukuri me emrin e një sendi a dukurie tjetër që i ngjan. Pra, metafora është përdorimi i një fjalë në një kuptim të ngjashëm, por të ndryshëm nga

kuptimi i saj i zakonshëm duke e lidhur me një fjalë tjetër, pa të cilën nuk do të përdorej në mënyrë asnjansë. *Udha dredhon, deti qeshte, telat e zemrës, det i tërbuar* etj.

Metonimia - vjen nga greqishtja metonymia - ndërrim, zëvendësim emri. Është një fjalë e figurshme, që përftohet duke zëvendësuar një emër të një sendi, të një frymori a dukurie me një emër tjetër, që ka lidhje me të nga prania e përbashkët në kohë, në hapësirë, si rrjedhim, si shkak. Te metonimia kuptimi i figurshëm fshin kuptimin e parë.

Shembull: Nëse themi *i ka hyrë lepuri në bark* në këtë rast është përdorur lepuri si emër konkret në vend të frikës si emër jokonkret (abstrakt).

Ironia vjen nga greqishtja eironeia - tallje e fshehur, shtirje. Është tallje e hollë dhe e fshehur me intonacion lavdëruës, që nënkupton të kundërtën. Është përdorimi i fjalës me kuptimin e antonimit të saj.

Shembull: *Falë zotave, fatkeqësia ime ia kalon shpresës*. Këtu kuptimi i vërtetë është i kundërti.

Sarkazma vjen nga greqishtja sarkasmos (sarkazo - kafshoj , “shqyej mishin”). Është ironia shumë e hidhur, therëse, demaskuese dhe e pamëshirshme. Shembull: *Mjerimi gjithashtu len edhe në trashëgim - jo veç nëpër banka dhe në gja të patundshme, por eshtrat e shtrembëta e në gjoks ndoj dhimbë*. Në këtë rast kemi të përdorur sarkazëm, sepse Migjeni, me një tallje të hidhur e plot vrerë, thekson se mjerimi nuk lë si trashëgim pasuri të ndryshme, por vetëm eshtra të shtrembur e dhembje në gjoks.

Epiteti vjen nga greqishtja epitheton - shtojcë, vënie përsipër. Epiteti është një fjalë përcaktuese, zakonisht mbiemër, që i shtohet një emri për t’ia pasuruar kuptimin, duke i dhënë bukuri artistike, duke shprehur një vlerësim, një qëndrim nga autori, ose duke i vënë në dukje një anë. Shembull: *Akil këmbëshpejti, dhelptra dinake, toka e zezë*, etj.

Alegoria vjen nga greqishtja allegoria, nga allos - tjetër dhe agereia - flas, them, d.m.th. të folur për ta kuptuar ndryshe. Alegoria është një paraqitje e tërthortë ose shprehje, prapa së cilës nënkuptohet një domethënie tjetër; metaforë e zgjeruar. Alegoria ndërtohet mbi bazën e simboleve. *Vaji i bilbilit* i Ndre Mjedës është një krijim alegorik i ndërtuar mbi bazën e simboleve (bilbili simbolizon shqiptarin e robëruar, kafazi pushtimin turk) etj.

Ndër figurat më të njohura të kuptimit janë:

Krahasimi është vënia ballë për ballë e dy dukurive, dy sendeve a dy frymorëve të ngjashëm nga ana e jashtme, për të ndriçuar më mirë njërin prej tyre, për ta bërë më të gjallë e më të pasur mendimin.

Shembull: Ai ishte i shpejtë si vetëtima.

Personifikimi është figurë stilistike, me anën e së cilës sendit (ose kafshës) i vishen tiparet e njeriut, gjërat pa shpirt e pa vetëdije paraqiten sikur mendojnë, veprojnë e flasin si njerëz.

Shembull: Valët me brigje, bajnë kuvendime.

Antiteza vjen nga greqishtja antithesis = kundërvënie, anti-kundër, thesis-vendosje, vënie. Antiteza përfitohet duke vënë ballë për ballë dy anë, dy gjendje, dy pamje, dy dukuri të kundërta, që të dalë me shprehës e më në pah mendimi i autorit. Shembull: *Ti në gjak të tyre varrin ke O i pavarrosuri Skënderbe.*

Kontrasti ndërtohet duke vënë përballë në mënyrë të theksuar dy karaktere njerëzore, dy sende a dukuri, por duke kundërvënë figura a tablo të tëra, jo anë të veçanta, si te antiteza. Kontrasti tregon një kundërshti të fuqishme, një skajshmëri të dyfishtë. Për shembull: *Kur nënat tona stomakboshe punonin njëzet orë në ditë, ajo urdhëronte një shërbëtore ta krihte me krehër të florinjte.*

Hiperbola është figurë stilistike që ndërtohet mbi bazën e zmadhimit jashtë mase deri në tepri të qenieve, sendeve a tipareve të tyre, për të bërë përshtypje ose për të theksuar mendimin. Shembull: *Në mur, përsipër vatrës, varej një shpatë e kohërave të vjetra që s'e ngre dot njeriu i sotëm as me dy duar.*

Litota është e kundërta e hiperbolës dhe autori thotë më pak, duke lënë të kuptohet më shumë. Litota përdoret për modesti, për druajtje dhe rrallëherë edhe për ironi. Shembull: Kur Skënderbeu kthehet në Krujë, ai i drejtohet kështu komandantit të kështjellës:

E dini si kam luftuar

për Sulltan' e për Turqinë

dhe qysh ai më ka shuar vëllezërit e shtëpinë?!

II.4 Ndikimi i poezisë tek nxënësit dhe perceptimi i saj

Në historinë e poezisë mund të jepen shembuj kur ajo vërtet ka përfituar nga trajtimi i ritmit dhe motivit universal, ashtu siç mund të jepen shumë shembuj ku poezia duke trajtuar një gjë fare personale dhe të veçantë prek në të veçantën dhe personalen që është e njeriut dhe kështu vetvetiu bëhet universale; ashtu siç mund të përmenden edhe raste të tjera që një pjesë e saj duke kaluar kohën e vet, humb nga fuqia dhe universalja dhe bëhet e vogël dhe e parëndësishme.

Poezia është shumë e rëndësishme, e kënaq veshin kur e lexojmë, mbase e kemi dëgjuar si diçka të këndshme, si tingëllim të dashur për veshin, ajo tingëllimë e bukur së bashku me kuptimin e fjalëve ikën tutje drejt thellësisë së lexuesit dhe prek atje zemrën e tij duke pas zbuluar ndjesi të ngjashme në zemrën e tij, ose thënë me terminologjinë psikologjike, prek ndjenjën. Pasi të ketë hyrë kështu brenda lexuesit, duke i shkaktuar atij një kënaqësi dëgjimi dhe një ngacmim të ndjenjës, ai mesazh i pranuar kështu vazhdon edhe më thellë drejt mendjes duke ndërtuar përshtypjen estetike dhe përfundimisht synon të shtrihet si një përvojë shpirtërore, pra futet në hapësirën e shpirtit. Poezia del kështu si një përplotësim i kënaqësisë dhe gjakim ndaj së bukurës ku fuqia e fjalës shtohet përmes realizimit të saj gati muzikor.

Jo pak njerëz pajtohen se poezia, mbretëresha e të gjitha arteve, qëndron mbi pikturën, muzikën dhe artet vizuale; ajo di t'i sintetizojë intencat më të thella të shpirtit njerëzor duke i ndriçuar edhe fshehtësitë më misterioze, duke e freskuar atë përmes aktit krijues, prandaj lexuesi është ai që do të frymëzohet nga kjo “dhuratë” hyjnore që i ofrohet atij me anë të poezisë. (Sopaj, 2010)

Për poezinë, prandaj shpërblimi më i madh është kur ajo ia prek thellësitë më të fshehta shpirtërore lexuesit dhe kur ai e pëlqen atë. Duke qenë dhuratë hyjnore që fisnikëron shpirtin njerëzor, poezia rrezaton ngrohtësi të pafund duke ia pushtuar atij ndjenjat, duke e magjepsur me “zbulimin”, të cilin ai, lexuesi, në nëndijen e tij që e ka poseduar, tani e njeh më mirë, tani e dëgjon të shqiptuar si material foljor-zëror që atij i vjen nga “jashtë”, nga krijuesi.

Nëpër librat e shenjtë poezia është cilësuar si diçka e mistershme që perëndia ua sjell brezave, popujve dhe epokave të mrekullohen me fshehtësitë ose hiret e Hyjit. Prandaj, poezia është diçka që rrezaton jashtë çdo konteksti dhe di t'i magjepsë njerëzit me fuqinë e saj tërheqëse. Nëpër epoka të caktuara të zhvillimit njerëzor, në stadime të mirëvajtjes njerëzore, ne flasim për atmosferë

krijuese, për oaza ose copëza kohërash në të cilat poetët, krijuesit e poezisë, çmohen si profetë, shenjtorë, gjysmëperëndi që njerëzve ua hapin sytë e avenirit të tyre (Sopaj, 2010).

Poezia është më tepër se një krijim i bukur artistik, ajo është thjesht një fshehtësi shpirtërore. Ajo tashmë nuk është vetëm një krijim prej fjalësh të zgjedhura që me një gjuhë solemne shpreh një gjendje të caktuar shpirtërore, por më tepër ajo shpalon një dhembje a një gëzim, një mllef a një mendim racional, një grotesk a një ndjenjë solemne. Mirëpo, poezia në qenien e saj përbëhet edhe gjatë leximit përmes saj bartet nga autori përmes veprës, te lexuesi shumë më tepër sesa kënaqësia; ajo është gjithashtu një mënyrë e komunikimit e rëndësishme për komunikim njerëzor. Ajo është një pjesë integrale e secilit, një shprehësi e shpresave të thella të njeriut, poetit dhe lexuesit, shprehësi e fuqishme e dëshirave dhe ëndrrave të tij.

Semjuel Tejlor Kolrixi thotë se poezia qëndron në fjalët më të mira, në radhitjen më të mirë (Rrahmani, Teoria e letërsisë, fq. 164, 2008); kurse poeti Edgar Allen Po, mendonte se poezia ishte “krijim ritmik i së bukurës”, ndërsa Robert Frost thotë se ajo është arritje përjashta përkatësisë së shprehjes një përpjekje për të gjetur kënaqësinë. Poeti bashkëkohor Ismail Kadare e shpreh poezinë si manifestim të artikulimit në çastin e vështirësisë. Është butësia, natyra e poezisë, e krijuar në një atmosferë jopoetike. (Rrahmani, Teoria e letërsisë, fq. 164, 2008).

Ndryshe nga gjuha e rëndomtë, thotë studiuesi e poeti Nehas Sopaj, gjuha e poezisë ka një melodi të mëvetësishme, ajo përmes ritmit e rimës, lexuesit ia fisnikëron shpirtin duke ia kumtuar të vërtetat objektive fëmijërore, ato të cilat ai i ka ditur në mendjen e tij, por të cilat tani i ka rastisur t’i dëgjojë kaq bukur, me një sintetizim siç i dëgjon në hartimin e autorit për fëmijë. (Bishqemi, Hyrje në teorinë e letërsisë për fëmijë, fq. 143, 2004).

P. Tevo Z. L., (2000) theksojnë mendimin e Rene Valos për poezinë dhe ndikimin që ka ajo te lexuesi. Sipas Valos, poezia është zbukurim i jetës. Ç’përfaqëson pra poezia? Ka një nevojë, një nevojë të lindur bashkë me njeriun, është kjo nevojë universale, një ngulmim i qenies njerëzore, në tërësi dhe secilit individ në veçanti, për ta zbukuruar dhe idealizuar jetën me këngë, me fjalët e këngëve, ku spikatin nuanca ndijimesh, emocionesh, ndjenjash, pasionesh dhe deri tek idetë ndonjëherë.

Gyjo te “Arti në këndvështrimin sociologjik” e cilëson poezinë si magji që për një çast, edhe pas një fjalë të vetme, bën të shfaqet një botë. (P.Tevo Z. L., 2000). Veprat artistike (poezitë) kanë shërbyer për të transmetuar një informacion të caktuar mbi realitetin: mbi jetën e njerëzve, mbi ndjenjat dhe mendimet e tyre.

Falë kësaj “ngarkese informative” veprat artistike kanë shërbyer si mjet komunikimi midis njerëzve. Krijimi letrar, apo teksti letrar (poezia) është një kod, me një sistem të caktuar shenjash, me një gjuhë të veçantë. Që ta kuptosh atë, që ta marrësh informacionin që përcjell ajo, duhet ta lexosh e ta dekodosh. Krijimi artistik, duke transmetuar një informacion të caktuar, në të njëjtën kohë u transmeton lexuesve kënaqësi estetike. Ky është i ashtuquajturi funksion i kënaqësisë. Kjo kënaqësi rrjedh nga përmbajtja e librit që lexojmë, po edhe nga forma, nga mënyra me të cilin është shkruar ai, nga mjeshtëria artistike e shkrimtarit. Te lexuesi - nxënës kjo kënaqësi më tepër buron nga përmbajtja sesa nga forma e veprës letrare, sepse, siç kemi vënë në dukje edhe më parë, lexuesi i moshës së njomë nuk e ka përgatitjen e duhur kulturore për të kuptuar e shijuar të “fshëhtat” e mjeshtërisë letrare. Së bashku me argëtimin e zbavitjen, së bashku me këto kënaqësi leximi i një poezie e pajis nxënësin me një sasi dijenish të reja, realizon funksion njohës.

Gjatë leximit nxënësin e rrëmben ngjarja, zhytet në botën e librit. Shëtiti në vende të tjera, që ndoshta s’i ka parë as ka dëgjuar për to. Pa kuptuar, në mënyrë jo të vullnetshme, ai mëson shumë gjëra të reja, merr informacion të ri për të cilin nuk ka pasur dijeni më parë. Ky grumbullim dijesh për lexuesin - nxënës bëhet pa farë sforcimi, pa mundim, bëhet me art e jo si në një orë mësimi diturie natyre, gjeografie a historie.

Së fundi gjatë leximit ose pasi e ka mbaruar së lexuari librin (poezinë), nxënësi bie në mendime, mediton, nxjerr përfundimet e veta, miraton apo kundërshton veprimet e personazheve që marrin pjesë në ngjarje, nxjerr mësim nga përvoja e tyre, mësim që mund t’i shërbejnë edhe atij më vonë në jetë. Pra, duke lexuar një krijim artistik, lexuesi emocionohet: gëzohet apo pikëllohet, pëlqen ose urren ndonjë dukuri, një veprim, një ves, një virtyt. Ngjarja e lexuar vepron mbi mendimet e nxënësve, mbi karakterin e tyre, në vullnetin e psikologjinë e tyre. Ndaj themi se me forcën emocionuese, vepra artistike realizon edhe funksionin edukues. Nxënësi është qenie e njomë njerëzore. Gjatë leximit ai kërkon të dëfrehet, të argëtohet. Kështu, studiuesi ynë, Anton Nikë Berisha, thekson se në letërsinë për fëmijë çdo gjë duhet të shprehet në mënyrë të natyrshme

dhe nëpërmjet argëtimit dhe lojës. Kuptimësitë që dalin nga teksti përkatës duhet të jenë të përfutuara në atë mënyrë që fëmijës t'i shkaktojnë kureshtje, kënaqësi e dëfrim. (Bishqemi, Hyrje në teorinë e letërsisë për fëmijë, fq. 34, 2004).

Poezia për fëmijë karakterizohet nga ndjenjat optimiste, nga humori e kënaqësia, dhe krahas elementit estetik e zbavitës, aty zë vend edhe karakteri didaktik. Tematika që i tërheq më shumë nxënësit filloristë nuk janë poezitë erotike, refleksive, sociale etj., por krijimet për prindërit, shkollën, fshatin, vendlindjen, atdheun, shokët, kafshët etj.

Poezitë që shkruhen për fëmijë duhet të kenë karakter konkret figurativ. Këndvështrimi duhet të jetë origjinal, problemi të kapet e të zbërthehet gjithmonë në syrin e fëmijës. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet fjalorit, poetët që shkruajnë për fëmijë duhet të shprehen vetëm me fjalorin dhe me gjuhën që flasin fëmijët, në moshën së cilës i adresohet krijimit poetik. Pra, poetët e mirë e gjejnë këtë raport, këtë ekuilibër në krijimtarinë e vet.

Pra, përmes poezisë hapen dritaret e zemrës, plotësohen zbrazëtitë e zemrës dhe ngjallet vetmia e shpirtit. Poezia është një lidhje fjalësh me shprehësi dhe shqiptim ritmik, ndërsa përmbajtja e atyre fjalëve të lidhura sipas ritmit, kuptimit dhe shprehësisë shkakton ndjenja të thella të lexuesit (nxënësit).

II.5 Kriteret për hartimin e teksteve shkollore dhe përzgjedhjes së poezive në shkallën e tretë të kurrikulës

Kurrikula (lat.: *curriculum*, nga fjala *currere* - vrapoj, rend; d.m.th ecuria e vitit). Kjo fjalë në arsim kuptohet si një sistem i përbërë nga disa elemente me synime arsimore që të lidhura mes tyre, mundësojnë të orientohet dhe të funksionojë sistemi arsimor, nëpërmjet planeve arsimore dhe administrative. Kurrikula bazohet në realitete historike, shoqërore, gjuhësore, politike, fetare, gjeografike dhe kulturore të një vendi. Me anë të saj sigurohet arsimimi cilësor dhe i barabartë për çdo pjesëtar të shoqërisë, pavarësisht nga përkatësia etnike, gjinia pozita shoqërore dhe ndryshime të tjera. Në kurrikul, ndër të tjera, përcaktohet se çfarë duhet të dinë dhe çfarë duhet të jenë në gjendje të bëjnë si duhet nxënësit, cilat vlera dhe qëndrime duhen kultivuar, si duhen aftësuar ata për bashkëjetesë e tolerancë, si mund të japin ndihmesë në mënyrë aktive për mirëqenien shoqërore

dhe vetjake. Teksti shkollor është libër (që ndryshon nga librat e tjerë në përdorim) themelor për secilën lëndë, i shkruar në bazë të planit dhe programit mësimor, në të cilin përmbajtjet i ofrohen nxënësit me aparaturë didaktike të rregulluar, me qëllim që nxënësit t'i përvetësojnë dituritë e nevojshme, t'i zhvillojnë aftësitë e tyre dhe kulturën e punës, duke ofruar material për punë të pavarur dhe krijuese. (Korniza kurrikulare e arsimit parauniversitar, Tiranë, 2012).

Tekstet shkollore përdoren në të gjitha fazat e një ore mësimore nga mësimdhënësit dhe nga nxënësit, por, gjithashtu, mund të përdoren edhe jashtë procesit mësimor të rregullt, në procesin e vetëpërgatitjes së nxënësve për mësim, në shtëpi etj.

Tekstet mësimore u shërbejnë njëkohësisht arsimtarëve për përgatitjen, organizimin dhe zhvillimin e mësimdhënies dhe shtjellim të diturive, në formë të sistematizuar dhe të përmbledhur si dhe nxënësve për përdorim të përditshëm, për arsimimin e tyre, si burim themelor për përvetësimin e njohurive, për lëndën e caktuar në shkollë dhe për përsëritje dhe ushtrime në shtëpi (Bashkim Azemi, Aparatura didaktike në tekstet shkollore, fq.13, 2013).

Meqë tekstet mësimore janë shumë të rëndësishme si për nxënësit ashtu edhe për mësimdhënësit, edhe kriteret për hartimin e tyre kanë rëndësi të veçantë dhe është e vlefshme të dihen kriteret bazë për hartimin e teksteve shkollore dhe zbatimin e realizimit të tyre në praktikë.

Sipas Udhëzimit administrativ secili tekst shkollor duhet t'u përmbahet kritereve të përgjithshme si: (MAShT, 2011)

1. Aspekteve formale (Përputhshmërinë me kurrikulën dhe me tekstet shkollore të së njëjtës lëndë të klasave pararendëse dhe pasuese, paraqitja, pamja, qartësia e teksteve, si dhe ilustrimet të jenë në nivel të shkëlqyeshëm).
2. Aspekteve metodike dhe didaktike (Cilësia, thelbësorja dhe aktualiteti në pikëpamje përmbajtjesore dhe shkencore, përshtatshmëria me moshën e nxënësve, përpunimi dhe përpilimi didaktik, pyetjet dhe detyrat, si dhe aspektet gjuhësore të jenë të ndërtruara sipas zhvillimit psikiko-intelektual)
3. Aspekteve pedagogjike (lidhjet me realitetin shoqëror, historik dhe politik, edukim paqësor, reflektimi i barazisë gjinore, si dhe përmbajtja ndërkurrikulare)

4. Aspekteve të praktikës pedagogjike (materiale pune në lidhje me tekstin shkollor, sprovimi, testimi paraprak i tekstit shkollor)

Pasi kemi hulumtuar në tekstet shkollore të *Gjuhës shqipe 6 dhe 7*, që bëjnë pjesë në shkallën e tretë të kurrikulës, kemi parë planet dhe programet mësimore si dhe kurrikulat, kemi vërejtur se këto tekste as në përqindjen më të vogël nuk i plotësojnë kriteret për përdorim nga nxënësit dhe mësimdhënësit.

Në këto tekste nuk janë respektuar kompetencat e përcaktuara për arritjet e nxënësve, të dyja librat nuk e kanë përmbajtjen mësimore as metodike të përshtatshme për t'i realizuar planprogramet e parapara, nuk përfaqësojnë faza të zhvillimit të letërsisë as nxitin për punë e shkathtësi kreative, ani se në parathënie të librave, hartuesit janë zotuar se synojnë mësimin e gjuhës dhe shkathtësive komunikuese.

Temat mësimore nga gjuha e në veçanti ato nga letërsia janë aq të varfra me material mësimor, me shumë pak informacione dhe aspak aparaturë didaktike. P.sh. në librin bazë *Gjuha shqipe 6*, në faqen 47, është paraqitur njësia e trembëdhjetë, e paraparë për pjesën e letërsisë: Poezi, prozë, tekst dramatik, në këtë mënyrë;

Fillimisht jepet një definicion mbi zhanret: *Shkrimtarët, kur shkruajnë, zgjedhin një kategori të caktuar të tekstit për të shprehur mendimet e veta. Këto kategori i quajmë zhanre* (Bardh Rugova, *Gjuha shqipe 6*, fq. 47, 2019).

Më pas listohen disa nga kategoritë: vepër letrare, proza letrare, poezia, tregimi - novela - romani - tregimet popullore etj. Kjo temë mësimore s'ka fare material mësimor, asnjë informacion për poezinë dhe elementet e saj, ndërsa janë përmendur disa lloje të poezisë: poezia lirike, epike, epiko-lirike, soneti, poema, vargjet e lira etj. Përmendet teksti dramatik, komedia, tragjedia dhe drama, por as këto nuk shpjegohen e nuk trajtohen për nga ana letrare e didaktike. Përmenden veprat joletrare, si: biografia, autobiografia, eseja, fjalimet, tekstet shkollore etj., por për asnjërën nga këto s'kanë dhënë shpjegime as informacione të nevojshme për nxënësit. Te pjesa e prozës letrare e kanë shpjeguar shumë shkurtimisht tregimin, romanin dhe novelën, informacionet sa janë të pakta aq edhe të mangëta për nga ndërtimi ideor e strukturor.

Kështu i shpjegojnë tregimin, romanin dhe novelën:

Tregimi është më i shkurtër dhe trajton një ide më të thjeshtë. Romani është më i gjatë dhe personazhet e ngjarja ofrohen në mënyrë më të gjerë e të detajuar. Novela është mes tregimit dhe romanit (Bardh Rugova, Gjuha shqipe 6, fq. 47, 2019).

Autorët këtu nuk i kanë zbatuar kriteret e përcaktuara më lart në aspektin metodik e didaktik, sipas të cilave synohet që nxënësit të mësojnë lidhur me strukturën e teksteve të ndryshme letrare. Hartuesit e këtij teksti shkollor i kanë përmendur vetëm sipërfaqësisht kategoritë letrare, llojet e poezive e format e prozës joletrare. Dhe kjo sipërfaqësi dhe mangësi e materialit mësimor, pa dyshim se do të sjellë paqartësi, vështirësi në pranimin e informacioneve dhe minimizim të zhvillimit të aftësive dhe shkathtësive kreative të nxënësve. Përmendin edhe sonetin, pa e dhënë as më të voglën informatë për këtë formë letrare. Pra, nxënësit do të mësojnë disa lloje të poezive pa e ditur kuptimin e tyre, pastaj do të mësojnë për sonetin, mirëpo vetëm si një fjalë të re, pa pasur ide se çka është soneti dhe si ndërtohet, gjithashtu do ta kenë shumë të vështirë t'i dallojnë poezitë lirike, epike apo dramatike, si dhe një poezi të formës sonet nëpër libra jashtëshkollorë.

13
**ZHANRET DHE
KATEGORITË LETRARE:
POEZI, PROZË,
TEKST DRAMATIK**

Shkrimtarët, kur shkruajnë, zgjedhin një kategori të caktuar të tekstit për të shprehur mendimet e veta. Këto kategori i quajmë zhanre. Zhanret dallohen mes vete për stile të ndryshme, forma të ndryshme dhe përmbajtje të ndryshme.

Disa nga kategoritë:

Vepër letrare
Prozë letrare
Tregimi – novela – romani – tregimet popullore

Poezi

Poezia lirike – poezia epike – poezia epiko-lirike
Soneti – poema – vjersha me vargje të lira etj.

Teksti dramatik

Komedia – tragjedia – drama

Vepra joletrare

Biografia – autobiografia – eseja – artikulli i gazetës – fjalimet –
tekstet shkencore – tekstet shkollore

Proza letrare:

Tregimi është më i shkurtër dhe e trajton një ide më të thjeshtë.
Romani është më i gjatë dhe personazhet e ngjarja ofrohen në
mënyrë më të gjerë e më të detajuar.
Novela është mes tregimit dhe romanit.

Pra, e gjithë njësia mësimore ndërtohet pa informacione kryesore mbi poezinë, askund nuk shpjegohet se çka është poezia, çfarë ndjenjash dhe emocione shfaq te nxënësi, çka shprehin

poezitë epike e as ato dramatike, as në përqindjen më të vogël nuk janë shpjeguar ndonjëra nga elementet e poezisë: vargu, strofa, ritmi, rima, ideja, motivi, poema a soneti. Kanë kapërcyer të gjitha pengesat dhe kanë dalë në breg pa u përballur me to. Kjo njësi mësimore përfundon pa filluar fare, aq shkurt e pakuptueshëm, pa trajtuar e zbërthyer asnjë element letrar e asnjë kategori letrare, sikur këto tekste të hartoheshin nga njerëz që s'e kanë as më të voglin informacion mbi fushën gjuhët dhe komunikim, më saktë mbi gjuhën dhe letërsinë shqipe.

Tekstet letrare, në veçanti poezitë, sado pak që janë përfshirë në këto tekste (në librin e klasës VI, sepse në atë të klasës VII mungojnë plotësisht) janë të papërshtatshme për moshën e nxënësve të klasës VI dhe VII, me tematikë të thellë, me gjuhë shumë të figurshme, pa aparaturë didaktike, pa fjalorë për fjalët e panjohura, pa trajtim letrar e stilistik, pa analizë strukturore. Këto tekste nuk u japin nxënësve mundësi të zhvillojnë mendimin kritik as të bëjnë analiza letrare. Tekstet shkollorë të gjuhës shqipe gjashtë dhe shtatë nuk përfaqësojnë faza dhe periudha të zhvillimit të letërsisë së hershme dhe asaj bashkëkohore; nuk ndikojnë në thellimin e mendimit, nuk nxitin fantazinë, nuk i tërheqin nxënësit për t'i lexuar. (Mimoza Gjokutaj, *Vërejtje dhe sugjerime për rishikimin e teksteve shkollorë*, 2011).

Në këto tekste vihet re një mungesë jo e vogël didaktike, mosnjohje dhe dembelizëm për të hartuar aparate didaktike të analizës së punës me tekstin (kuptimi, interpretimi, analiza, qëndrimi kritik, personazhi, tema) të cilat duhet të ishin përkthyer në rubrika pune. (Mimoza Gjokutaj, *Vërejtje dhe sugjerime për rishikimin e teksteve shkollorë të Gjuhës shqipe*, fq. 10, 2011). Ajo çka bie në sy në të dy librat është pamundësia që nxënësit të nxiten për zhvillim të imagjinatës e botës së tyre kreative, mundësitë janë më të mëdha për të realizuar mësim riprodhues pa efekte pozitive të të nxënësve.

Në të dy tekstet e, në veçanti në tekstet e klasës VII, janë përmbysur në masë të madhe pothuajse të gjitha kriteret: duke filluar nga pamja, qartësia e ilustrimet, përmbajtja e materialit mësimor, papërshtatshmëria e materialit mësimor me zhvillimin psiko-intelektual të nxënësve e deri te karakteri metodik e didaktik.

Të dy librat, sidomos *Gjuha shqipe 7* më shumë i ngjan një gazete a reviste, me copëza shkrimi nga publicistika e gazetaria, me font shumë të vogël, me ilustrime pa ndonjë cilësi të lartë nga pikëpamja estetike dhe joshpjeguese, pa aparaturë didaktike e pa poezi e tekste të mirëfillta letrare.

Gjuha shqipe si ajo e klasës VI edhe e klasës VII, kanë mungesa të shumta në ofrimin e informacioneve të reja për artin letrar në përgjithësi dhe për poezinë në veçanti, në anën tjetër teprime të informacioneve për tekstet joletrare me elemente të stilit dhe diskursit publicistik e gazetaresk.

Mungesa të përkufizimeve dhe informacioneve bazë për secilën çështje gjuhësore e letrare. Mungesë e madhe e aparaturës didaktike, me detyra dhe ushtrime tejet të mangëta. Në të dy tekstet *Gjuha shqipe 6* dhe *Gjuha shqipe 7* është lënë pothuajse në tërësi jashtë librit pjesa e letërsisë-poezisë, shumë pak poezi. Në librin e klasës VI një numër shumë i vogël, ndërsa në librin e klasës VII mungojnë tërësisht. Sa për t'i mbuluar gabimet e tyre hartuesit më pas disa poezi kanë paraqitur vetëm në fletore pune të klasës VI. Poezitë janë vështirë të kuptueshme, të papërshtatshme për moshën e nxënësve, të thella dhe shumë pak didaktike, nuk i nxisin nxënësit për lexim e as u japin atyre mesazhe me karakter moral e didaktik.

Duhet përmendur edhe kriterin sipas të cilit njësitë mësimore duhet të kenë lidhje me njëra-tjetrën, e që nuk del si kriter i plotësuar, pasi shumë tema nuk përputhen mes vete, p.sh. në librin bazë të klasës VI, faqe 18 mësohet për lajmet dhe si demonstrim i lajmeve është paraqitur poezia *Gjashtë shokët besnikë* e cila nuk lidhet shumë me këtë njësi mësimore. Letërsia si edhe poezia dhe të nxënësit e saj kontribuon në zhvillimin e një kulture të të lexuarit e të të shkruarit brenda dhe jashtë ambienteve shkollore, andaj mospërfshirja e poezisë në tekste shkollore, është humbje e madhe për nxënësit, tekstet shkollore pa aparaturë të duhur didaktike, pa udhëzime, e sugjerime për lexim, pa detyra për punë të pavarur, pa zgjedhje cilësore dhe të përshtatshme për nxënësit janë dëmi më i madh që mund t'u bëhet atyre.

Njohja dhe zotërimi i thellë praktik i gjuhës letrare shqipe, krijimi i shprehive gjuhësore, aftësimi i nxënësve në përdorimin e drejtë të mjeteve dhe të pasurisë gjuhësore, leksikore dhe frazeologjike në të folur e në të shkruar është qëllimi kryesor i lëndës së gjuhës në shkollë. Kurse, kushti kryesor për zotërimin e gjuhës letrare dhe për krijimin e shprehive gjuhësore të nxënësit, është përgatitja e mirë e teksteve shkollore.

II.6 Poezia në tekstet shkollore të shkallës së tretë të kurrikulës, përfshirja e pjesshme e poezive në librin e klasës VI

Tekstet shkollore janë pjesë përbërëse dhe shumë e domosdoshme e procesit mësimor, përmbajtjet dhe aparatura e tyre e saktë, didaktike u ndihmon shumë nxënësve t'i pranojnë sa më lehtë informacionet. Teksti shkollor *Gjuha shqipe 6* i hartuar nga grup autorësh (Rugova, Elezi, Jakupi & Baftiu) dhe i botuar nga shtëpia botuese Dukagjini, më 2019, përmban gjithsej 37 njësi mësimore dhe vetëm gjashtë prej tyre janë të lidhura ngushtë me poezinë, temën qendrore të punimit tonë.

Në gjithë librin e klasës VI janë të përfshira vetëm katër poezi, në faqen 17, njësia e katërt *Lajmet* është shoqëruar me poezinë *Gjashtë shokët besnikë*, faqe 41, njësia e dymbëdhjetë *Theksi* është shoqëruar me poezinë *Libri* dhe në faqe 69 njësia e njëzetë *Ndjenjat*, shoqërohet me dy poezi: *Kënga e qenushes dhe I Pamposhturi*. Në faqe 47 është paraqitur njësia e trembëdhjetë *Zhanret dhe kategoritë letrare: Poezi, prozë, tekst dramatik*. Në këtë njësi mësimore janë përmendur disa nga kategoritë, zhanret, disa nga llojet e poezive, teksti dramatik, dhe veprat joletrare si biografia, eseja, tekstet shkollore, si dhe proza joletrare etj. Nuk është trajtuar fare poezia si gjini letrare dhe nuk janë dhënë përkufizimet as definicionet e kuptueshme dhe të sakta as për zhanret e as për kategoritë letrare. Nuk është paraqitur ndonjë poezi si demonstrim i njësisë mësimore, ndërsa është përzgjedhur tregimi *Peshkaqeni* si shembull i prozës.

Në rubrikën *Detyra dhe pyetje*: E gjitha që kërkohet të dinë nxënësit është të dallohet nëse tregimi *Peshkaqeni* është prozë apo poezi, tekst letrar apo joletrar, roman, novelë apo tregim. Ka shumë pak informacione për romanin, tregimin e novelën. Nuk jepen informacione se çka shprehin poezitë lirike, epike, epiko-lirike, soneti, poema as vjersha me vargje të lira. Nuk ka fare të dhëna se cilat janë llojet e vargjeve, si dallohet poezia lirike nga ajo epike e dramatike, si dallohet soneti, si ndërtohet etj..

E gjithë letërsia e sidomos poezia dhe shpjegimi i saj është copëtuar dhimbshëm. Temë tjetër që lidhet me të nxënësit e poezisë është njësia e shtatëmbëdhjetë *Shprehjet e figurshme*

dhe frazeologjike. Në këtë temë mësimore, fillimisht janë paraqitur me ilustrime disa shprehje figurative dhe frazeologjike, më pas sqarohet se çka paraqesin kuptimet e figurshme të fjalëve:

*Ndonjëherë kuptimin e figurshëm të fjalëve e bëjmë për shkak se duam të shprehim ose të nxisim te tjetri një ndjenjë. Ndonjëherë kuptimi i figurshëm është bërë aq i zakonshëm sa nuk e dallojmë se është i figurshëm. P.sh. pakkush e dallon se kur thua **marr vesh**, ti je duke përdorur një kuptim të figurshëm, sepse **marr vesh** = **kuptoj** e jo në kuptimin e parë, e marr veshin nga një vend në tjetrin. Kuptimet e tilla të fjalëve i quajmë figura.* (Bardh Rugova, Gjuha shqipe 6, fq. 59, 2019)

Pastaj janë paraqitur disa nga figurat letrare: Krahasimi, metafora, hiperbola, onomatopeja; këto figura janë shpjeguar, ani se shkurtimisht dhe janë shoqëruar me shembuj:

Krahasimi paraqet ngjashmërinë në mes të dy gjërave të ndryshme. Realizohet me përdorimin e fjalës si ose sa. Shembuj: I shpejtë si lepuri, E lehtë si era, I fortë si guri etj. (Bardh Rugova, Gjuha shqipe 6, fq. 59, 2019)

Metafora paraqet ngjashmërinë mes dy gjërave të ndryshme pa përdorur mjetin e krahasimit “sa” ose “si”. Një diçka e quan me diçka tjetër. Shembuj: Mesi është një makinë golash. Ti je ylli i gjyshes. Skënderbeu ishte një dragua për turqit (Bardh Rugova, Gjuha shqipe 6, fq. 59, 2019)

Hiperbola shpjegohet si në vijim:

Hiperbola paraqet një krahasim të tepruar të dy gjërave si sasi apo si përmasë. Shembuj: Vij për pesë sekonda. Të kam thënë 100 herë etj. (Bardh Rugova, Gjuha shqipe 6, fq. 59, 2019)

Onomatopeja - figurë që imiton tingujt e krijuar nga një objekt a një qenie. Shembuj: E goditi topin bam (Bardh Rugova, Gjuha shqipe 6, fq. 59, 2019)

Edhe frazeologjitë shpjegohen shkurtimisht dhe përcillen me shembuj të thjeshtë. *Ndonjëherë shprehjet e ndryshme të figurshme janë bërë të zakonshme në gjuhë. Ato kanë kuptim tjetër nga kuptimi i parë i fjalëve që e përbëjnë atë shprehje. Shembull: Ia nxori bishtin = e teproi, marr vesh = e kuptoj, luan vendit = lëviz etj.* (Bardh Rugova, Gjuha shqipe 6, fq. 59, 2019)

Detyrat që janë përcaktuar për këtë njësi mësimore janë të paqarta, siç janë të paqarta edhe ilustrimet, dhe shprehjet që përdoren aty - “Taun- Tërt” (Bardh Rugova, Gjuha shqipe 6, fq. 59, 2019)



Detyrë:

— Taun-tërt imiton cilin veprim?

Diskutoni stripin:

— Çfarë po ndodh në këtë strip?

— A është për të qeshur? Pse?

Të tilla shprehje nuk i nxisin nxënësit për mësim. Është shqetësuese dhe duhet të theksohet se poezisë i është dhënë hapësirë shumë e vogël në këtë libër shkollor. Vetëm katër poezi të përfshira në gjithë tekstin, asnjëra e analizuar në aspektin e mirëfilltë tematik, strukturor, ideor e letrar. Poezia e parë e këtij libri është poezia *Gjashtë shokët besnikë* e shkëputur nga poezia *Fëmija i elefantit* i autorit Rudijard Kipling.

Poezia vjen si shoqëruese me njësinë mësimore *Lajmet*, përmbajtja e poezisë është kjo: Njeriu gjatë gjithë jetës kërkon të mësojë gjëra të reja për çdo gjë që e rrethon. Mësimi dhe hulumtimi për marrjen e çdo informacioni të ri është pasuria më e madhe. Personazhi i vjershës ka gjashtë shokë besnikë, të cilët i dërgon nëpër tokë e det për të marrë informacione, për të mësuar gjëra të reja. Shokët besnikë të personazhit janë pyetjet: *kush, kur, ku, çka, pse* dhe *si*. Këto pyetje pasi të

plotësohen me përgjigjet e kërkuara, kthehen sërish te personazhi i vjershës, për të vazhduar tutje me mësimin e gjërave të reja. Duhet të theksohet se edhe kjo njësi mësimore vuan nga mungesa e qasjes së duhur metodologjike e cila do t'i ndihmonte nxënësit në kapjen e idesë qendrore të poezisë dhe mesazhit kryesor. Në tekst, përveç se janë dhënë informacione se *Gjashtë shokët besnikë* është vjershë dhe shkruhet në vargje, nuk ka asnjë sqarim tjetër se për çka flet poezia dhe kujt i dedikohet, me shprehje të paqarta është dhënë një sqarim në rubrikën *Bashkëbisedojmë* ku thuhet se *poezia është tekst letrar që shfaq një botë që është krijuar në kokën e shkrimtarit*. (Bardh Rugova, Gjuha shqipe 6, fq. 59, 2019)

Nxënësit e klasës VI janë fëmijë të moshës 10-11-vjeçare, ata e kanë të vështirë t'i pranojnë mesazhet kur u ofrohen indirekt, andaj pa informatat hyrëse mbi poezinë dhe pa detyrat me përmbajtje të përshtatshme për zhvillimin e tyre psikik e intelektual, këtë poezi do ta lexojnë, mirëpo vështirë se do ta kuptojnë dhe deshifrojnë në tërësi.

Kam gjashtë shokë besnikë unë/ Më kanë mësuar gjithçka që di

Ata quhen Kush dhe Kur dhe Ku/ Dhe Çka dhe Pse dhe Si (Bardh Rugova, Gjuha shqipe 6, fq.18, 2019)

Kush, Çka, Kur dhe Si, do të bëhen vetëm pikëpyetje në kokat e nxënësve, do të shkaktojnë hamendje e jo argëtim. Nxënësit e vegjël e pëlqejnë poezinë, për lojën, për atdheun, poezinë argëtuese e me mesazhe dhe vlera edukative. Edhe vetë roli i poezisë dhe të nxënët e saj është argëtimi dhe kënaqësia e nxënësve.

Nehas Sopaj thekson se për poezinë për fëmijë janë të huaja pesimizmi, dilemat, dhimbjet shpirtërore. Ajo karakterizohet nga ndjenja optimiste, nga humori siç është vetë bota e të vegjëlve, shpirti i tyre fisnik e bujar. (Bishqemi, Hyrje në teorinë e letërsisë për fëmijë, fq. 148, 2004)

Por, poezia *Gjashtë shokët besnikë*, e paraqitur në tekst e shkëputur nga *Fëmija i elefantit* pa përmbajtje të kapshme e pa qasje të duhur metodologjike nuk arrin të depërtojë në ndjesitë dhe emocionet e nxënësve, nuk u sjell atyre as mësim, as humor as argëtim, ndërsa do t'u shkaktojë dilema dhe pikëpyetje të shumta deri në perceptim të saj. Poezia *Gjashtë shokët besnikë* nuk trajtohet fare as në aspektin letrar, nuk përmenden e as nuk analizohen asnjëra nga elementet e poezisë (strofa, vargu, rima) etj., nuk kërkohet ideja, motivi e as mesazhi që përcjell.

Poezia, para së gjithash, duhet të shkaktojë argëtim dhe kënaqësi dhe poezia e tillë vështirë që e arrin këtë synim, Bishqemi (Bishqemi, 2004) thekson se krijimi artistik, duke transmetuar një informacion të caktuar, në të njëjtën kohë u transmeton lexuesve kënaqësi estetike. Ky është i ashtuquajtimi funksion hedonistik (i kënaqësisë). Tutje thekson Bishqemi (Bishqemi, 2004) së bashku me argëtimin e zbavitjen, së bashku me kënaqësitë, leximi i një vepre letrare e pajis nxënësin me një sasi dijenish të reja, realizon funksionin njohës.

Duke e lexuar një krijim artistik (poezi): lexuesi (nxënësi) emocionohet: gëzohet apo hidhërohet, adhuron ose urren një dukuri, një veprim, një ves, një virtyt. Subjekti, ngjarja vepron mbi mendimet e nxënësve, mbi karakteret e tyre, në vullnetin e psikologjinë e tyre. Ndaj themi se me forcën emocionuese, vepra artistike realizon edhe funksionin edukues. Poezia *Gjashtë shokët besnikë*, me përmbajtjen e pakapshme, mungesën e aparaturës didaktike, qasjen jo të duhur metodologjike del se nuk realizon funksionin njohës e as edukues. Poezia e dytë e përzgjedhur në tekstin *Gjuhë shqipe 6* është poezia *Libri* e cila e shoqëron temën, *Theksi* brenda njësisë së 12-të.

Autorët e tekstit e kanë shpjeguar mësimin e rrokjeve, duke shfrytëzuar vargjet e kësaj poezie. I gjithë fokusi te kjo poezi është aspekti gjuhësor dhe gramatikor, ndërsa lihet anash sërish aspekti letrar, didaktik e metodik i të nxënësve të poezisë. Poezia *Libri* është poezi e shkurtër që tregon vlerën e librit, duke e cilësuar atë dritë dhe dituri.

Adelina Marnaqi

LIBRI

Bashkëbisedojmë:

Në këtë vjershë janë dalluar me shkronja të bardha disa rrokje. Kur ta lexoni vjershën, do ta vëreni se këto rrokje shqiptohen më shumë se rrokjet që janë të shënuara me shkronja të zeza.

Këto rrokje të fjalës që shqiptohen apo dëgjohen më shumë janë rrokje ku bie theksi i fjalës - janë rrokjet e theksuara.

Kjo rrokje e theksuar mund të jetë një zanore e vetme: Po e zëmë, te fjala **a**l: **a** - l, l - ja është rrokja e theksuar.

Kjo rrokje e theksuar mund të jetë me një **a** me më shumë bashkëtingëllore: **shkru**-aj - rrokja **shkru** është e theksuar. Nga këta shembuj vërejmë se rrokja e theksuar është më e zëshme dhe shqiptohet me forcë, me lartësi dhe me gjatësi më të madhe të zërit.

Për shembull, te fjala **lexoj** theksi është në rrokjen e fundit. Te fjala **libër** është në rrokjen e parafundit. Në gjuhën shqipe theksi ka disa rregull të caktuara. Kur fjala merr mbare, theksi nuk lëviz.

mal	male
mali	malet
malit	maleve
malin	malesh

Te të gjitha rastet, theksi është te rrokja **ma**.

**Libri është
dritë e dituri
shumë gjëra
mësova nga ai.**

**mësova të shkruaj,
mësova të lexoj
mësova shumë vjersha
unë të recitoj**



Pyetje:

- Për çfarë bën fjalë kjo vjershë?
- Si e cilëson autorja librin?
- Çfarë ka mësuar ajo nga libri?



Libri është dritë e dituri/ shumë gjëra mësova nga ai. (Bardh Rugova, Gjuha shqipe 6, fq. 41, 2019) Në rubrikën *Pyetje*, te kjo njësi mësimore, janë parashtruar tri pyetje që lidhen me poezinë në aspektin letrar, mirëpo këto pyetje janë krejtësisht të thjeshta dhe të panevojshme e aspak të përshtatshme për nxënësit e klasës VI , (p.sh. *Për çfarë bën fjalë kjo vjershë?, Çfarë ka mësuar ajo nga libri?, Si e cilëson autorja librin? etj.*, thuajse janë dedikuar për nxënësit e klasës së parë ose të dytë) (Bardh Rugova, Gjuha shqipe 6, fq. 41, 2019). Pyetje të tilla nuk kanë për qëllim nxitjen dhe thellimin e mendimit kritik, zhvillimin e kreativitetit e as stimulimin për punë të pavarur. Poezitë dhe vlerat e saj i kanë shkrirë autorët e këtij teksti brenda merakut dhe egos së tyre gjuhësore, duke ua humbur në tërësi letraritetin.

Kënga e qenushes nga Sergej Jesenjen është poezi tjetër e përzgjedhur në librin e klasës VI, si shoqëruese e njësisë mësimore *Ndjenjat*.

Është interesant dhe duhet përmendur se tri nga katër poezitë e përzgjedhura janë të shkruara nga autorët e huaj, ani se kemi poezi të shumta me vlera të larta artistike e letrare të shkruara nga shkrimtarët shqiptarë që nuk janë përfshirë në tekst. Poezia *Kënga e qenushes* është poezi lirike që tregon dhimbjen, vuajtjen dhe sakrificën që përjeton nëna për t'i mbrojtur fëmijët e saj, kjo poezi ngjall emocione dhe ndjenja, pasqyron dhimbjen e kryepersonazhit që është një qenushe - nënë e cila lufton në dritë e në errësirë për qetësinë e të vegjëlve të saj:

Deri në muzg i mbante ngat vetes/Ua lëpinte qimet në dritë hëne

Me qumësht ajo i ushqente/ Nga ai gjoks i ngrohtë nëne,

(Bardh Rugova, Gjuha shqipe 6, fq.71, 2019); Kjo poezi është ndoshta poezia më e përshtatshme për moshën e nxënësve në këtë nivel shkollor. Tematika e poezisë është më e kuptueshme dhe lehtë e perceptueshme, gjuha e poezisë është e thjeshtë dhe e drejtpërdrejtë, ndër figurat qendrore është krahasimi, që njihet si figura më e përshtatshme për fëmijë. Madje (Bishqemi, 2004) e thekson se të vegjlit i kanë qejf kafshët, duan të miqësohen me to. Ndaj edhe në letërsinë e tyre shkrimtarët tregohen të kujdesshëm ndaj këtij fakti.

Figurën e krahasimit e kanë praktikuar pothuajse të gjithë krijuesit tanë. Duke pasur parasysh se vepra u kushtohet të vegjëlve, ata kanë pasur kujdes të veçantë që figura po ashtu të ketë natyrë

fëmijërore. Nga kjo anë, në shumicën e rasteve, ose objekti i krahasimit, ose edhe ai me të cilin krahasohet, ndërlidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me botën e fëmijëve ose me dukuri të afërta për ta. (Bishqemi, Hyrje në letërsinë e teorisë për fëmijë, fq.112, 2004). Poezia *Kënga e qenushes* zgjon kërshtërinë e lexuesit, ngjall emocion dhe jep mesazhin se nëna është e madhe dhe lufta për t’i shpëtuar të vegjlit e saj s’përfundon kurrë, qoftë edhe në botën e kafshëve. E vetmja kjo poezi është trajtuar në aspektin letrar (tematika, subjekti), ani se në masë shumë të vogël, ndërsa mungon fjalori i fjalëve të reja.

Poezia *I Pamposhturi* është poezia e fundit e përzgjedhur në tekstin *Gjuha shqipe 6*, i takon poezisë lirike, shpreh ndjenja dhe dhimbjen personale të një shpirti luftarak që nuk dorëzohet para asnjë sfide. Poezia *I Pamposhturi* është e ndërtuar me shumë figura stilistike (metafora, epitete, simbol), me gjuhë të thellë figurative, si dhe është e mbuluar me fjalë të panjohura e që nuk janë shpjeguar fare dhe si e tillë shkakton vështirësi për t’u kuptuar e analizuar nga nxënësit e klasës VI. Mënyra se si është paraqitur në tekst pa ndonjë koment hyrës që do t’i ndihmonte nxënësit në deshifrimin e saj, pa shpjegim të fjalëve të panjohura dhe me mesazhin e fshehtë që vështirë mund ta kapin nxënësit, nuk përkon me nivelin shkollor të këtyre nxënësve as me zhvillimin e tyre psikik e intelektual:

Tek nata më mbulon anembanë/ E zezë si skëterrë pambarim,

I falënderoj zotat kudo janë,/ Për të pamposhturin shpirtin tim. (Bardh Rugova, *Gjuha shqipe 6*, fq.72, 2019)

Poezia për fëmijë, para së gjithash, duhet të jetë e thjeshtë t’i argëtojë e t’i kënaqë ata. (Bishqemi, 2004) thekson se kënaqësia rrjedh nga përmbajtja e librit që lexojmë, po edhe nga forma, nga mënyra me të cilën është shkruar ai, nga mjeshtëria e shkrimtarit. Te lexuesi fëmijë kjo kënaqësi më tepër buron nga përmbajtja sesa nga forma e veprës letrare, sepse, siç kemi vënë në dukje edhe më parë, lexuesi i moshës së njomë nuk e ka përgatitjen e duhur kulturore për të kuptuar e shijuar “të fshehtat” e mjeshtërisë letrare.

Pra, poezia *I Pamposhturi* i mban të fshehtat që nxënësit e klasës VI e kanë të vështirë t’i zbulojnë. Në këtë poezi pyetjet e pakta në rubrikën *Pyetje dhe diskutim* janë të lidhura me kërkesat e poezisë në aspektin letrar.

II.6.1 Përfaqësimi i poezisë në librin *Gjuha shqipe 6 - Fletore pune*

As në librin *Gjuha shqipe 6 - Fletore pune* poezia nuk trajtohet sa duhet. Shembujt dhe detyrat praktike janë të pakta dhe nuk kërkojnë angazhimin e nxënësve. Në faqe gjashtë është bërë një përsëritje e shkurtër mbi poezinë *Gjashtë shokët besnikë*.

Aty kërkohet nga nxënësit të dallojnë nëse kjo vjershë është ose nuk është e shkruar në vargje, nëse është prozë apo poezi, si dhe të dallojnë nëse është tekst letrar apo joletrar. Detyrë tjetër që lidhet me poezinë dhe u shtrohet nxënësve, është përmbledhja e poezisë me fjalët e tyre.

Detyra të tjera që nxësin zhvillimin e mendimit kritik, kërkojnë analiza letrare, strukturore dhe tematike nuk ka. Njësia e katërmbëdhjetë *Zhanret dhe kategoritë letrare*, pasqyrohet në librin *Fletore pune* me poezinë *Në munç* të autorit Rudijard Kipling dhe të përkthyer nga F. Noli e Namik Abazi.

Nga leximi dhe analiza e poezisë kuptojmë se poezia *Në munç* është poezi që autori ia dedikon të birit, duke e këshilluar që të bëhet njeri me karakter të fortë e të ekuilibruar për t'u përballur me sfidat e jetës. Poezia *Në Munç* është poezi që përcjell mesazh edukativ dhe synon t'i nxisë nxënësit drejt vlerave njerëzore, por për të arritur deri te kuptimi i saj nxënësit e kanë shumë të vështirë, pengesë për këtë paraqet mënyra e shkrimit të saj, përveç që është e shkruar në dialektin gegë, as fjalët e panjohura nuk janë të shpjeguara si dhe mungon tërësisht aparatura didaktike, puna me tekstin, me gjuhën dhe stilin që do ta lehtësonte dukshëm të nxënësit e saj.

Edhe te kjo poezi kërkohet nga nxënësit të dallojnë nëse teksti është prozë apo poezi si dhe nëse është tekst letrar apo joletrar, kërkohet të gjejnë dialektin në të cilin është shkruar, por nuk kërkohet të gjejnë, motivin, temën apo mesazhin që përcjell poezia. Nuk ka ndonjë detyrë që kërkon të dallohet vargu as rima, strofa e as figurat stilistike.

As poezitë *Kënga e qenushes dhe I Pamposhturi* në librin *Gjuhë shqipe - Fletore pune 6*, nuk janë trajtuar fare nga aspekti letrar, te të dyja, detyra e vetme është të dallohen nëse janë prozë apo poezi dhe nëse janë tekste letrare apo joletrare.

II.6.2 Mospërfshirja e poezive në tekstin Gjuhë shqipe 7

Teksti bazë *Gjuhë shqipe 7* është hartuar nga profesorët Rrahman Paçarizi dhe Adelinë Selmani. I gjithë libri përmban 104 njësi mësimore dhe vetëm pesë njësi lidhen tërthorazi me letërsinë-poezinë, ndërsa nuk është paraqitur brenda tekstit as edhe një poezi e vetme, duke lënë jashtë interesit të nxënësve këtë kategori shumë të rëndësishme letrare e poetike. Duhet theksuar se hartuesit e këtij libri rëndësi më të madhe u kanë kushtuar teksteve joletrare, më shumë se gjysma e njësisve që përmban ky tekst shkollor janë nga fusha e gazetarisë, të ndërtuara mbi stilin gazetaresk e diskursin publicistik, thuajse nxënësit do të përgatiten për t'u bërë gazetarë e analistë. Është shumë shqetësuese për mua, për nxënësit dhe për secilin mësimdhënës të gjuhës shqipe të ketë në duar një tekst të tillë, që nuk i plotëson as për së afërmi kërkesat e tyre dhe të nxënësve, për ta pasur më të lehtë të nxënësit e gjuhës dhe letërsisë shqipe.

Gjuha shqipe si lëndë mësimore zë vend të rëndësishëm në planprogramet mësimore dhe kap fond më të madh të orëve në krahasim me lëndët e tjera. Mësimi i temave nga fusha e saj gjuhësore, gramatikore e letrare i ndihmon nxënësit të zhvillojnë kompetencat gjuhësore, të përforcojnë aftësitë metakognitive e refleksive, si dhe të nxisë komunikimin dhe ndërveprimin e nxënësve. Poezia si krijim i veçantë në ndjenjat, emocionet dhe shpirtin e secilit lexues e nxënës, do të duhej të zinte vend kyç në faqet e këtij libri e jo të mungonte plotësisht. *Gjuha e letërsisë, Figurat stilistike, Teksti dhe konteksti, Kulturë tradicionale ku bëjnë pjesë këngët e kreshnikëve dhe llojet e poezisë lirike* janë njësitë e vetme që kanë të bëjnë me poezinë dhe të nxënësit e saj e që janë shpjeguar në librin e klasës VII. Në faqe 64 shpjegohet me pak rreshta *Gjuha e letërsisë*:

Gjuha e letërsisë është një gjuhë e mbushur me figura stilistike, që rrallë përdoren në fushat e tjera. Përmes gjuhës së figurshme, shkrimtari prodhon efekte të caktuara letrare ose artistike. Në kuadër të këtij shpjegimi është shkëputur një strofë e vetme e poezisë. Gjeniu i anijes nga Lasgush Poradeci, e cila përdor një figurë stilistike, përveç informacionit se strofa e përzgjedhur është ndërtuar me figurën e aliteracionit, përmes përsëritjes së tingullit "sh"...dhe këtë e ka bërë për të krijuar rimë, si dhe idenë e fëshfërimës që krijon anija duke lundruar nëpër ujë nuk ka informacione të tjera.

Vështroni si shket sipër valash/ E tundet anija me nge?-

...Me krismë e me prush prej stërkalash/ Mi të shkrepëtiu një rrufe!...

(Adelina Selmani, Gjuha shqipe 7, fq.64, 2019)

Është trajtuar si njësi mësimore tema llojet e poezisë lirike, janë dhënë pak informacione mbi lirikën dhe llojet e saj; himnin, oden, elegjinë, ditirambin etj.

Poezinë lirike e shpjegojnë në këtë mënyrë:

Poezia lirike është poezi e shkurtër, ku autori shpreh mendimet dhe ndjenjat personale, gjendjen emocionale, mendimet, qëndrimet, perceptimet etj. në vetën e parë. Poezia lirike nuk tregon ndonjë ngjarje, por është shumë personale dhe përqendrohet vetëm në ndjenjën dhe idetë personale të folësit. (Adelina Selmani, Gjuha shqipe 7, fq.53, 2019)

Himnin e shpjegojnë në këtë mënyrë:

Himni është vjershë që i është kushtuar dikujt a diçkaje që njeriu e adhuron dhe e konsideronte hyjnore. Tradita e kësaj poezie të lashtë lirike sot ruhet përmes himneve të shteteve, himneve të kombeve etj. Edhe për oden japin informacione. Oda e ka origjinën në vjershat korale të Greqisë së vjetër. Tematika e saj shtrihet më gjerë se ajo e himnit. Shkruhet për nder të dikujt që është mjaft i afërt dhe i dashur me poetin. Është poezi, e cila i thur lavdi një individi apo edhe një ngjarjeje.

Për elegjinë kanë dhënë këto informacione:

Elegjia është formë e poezisë lirike që shkruhet për nder të dikujt që ka vdekur. Zakonisht kjo poezi vajton vdekjen e dikujt. Në letërsinë shqipe është e njohur poezia “Elegji” e Çajupit. (Adelina Selmani, Gjuha shqipe 7, fq.54, 2019)

Sonetin e cilësojnë si llojin më të njohur të poezisë lirike por s’kanë marrë mundin të shpjegojnë se çka nënkuptojmë me sonet, si ndërtohet ai, cilët autorë e kanë shkruar e as ndonjë informatë tjetër. S’janë paraqitur poezitë që do t’i përgjigjeshin secilit lloj, ndërsa nuk janë përmendur poezitë epike e ato dramatike, as elementet që e bëjnë një poezi të plotë nuk janë përfshirë fare. Askund në librin e klasës VI e as në librin e klasës VII s’ka ndonjë përkufizim të lehtë e të përshtatshëm mbi poezinë, (është përmendur që shkruhet në vargje) nuk trajtohet askund rima e as llojet e saj, s’përmendet strofa, as ritmi, vargu, tema, ideja, subjekti e as mesazhet që përçon poezia te

lexuesit. Nxënësit e lexojnë poezinë, për t'u kënaqur, dhe mospërfshirja e saj në tekstet shkollore i dëmton ndjeshëm ata. Brenda njësisë mësimore *Kulturë tradicionale* janë përfshirë *Këngët e Kreshnikëve*, jepen pak informacione, ndërsa mungojnë detyrat dhe hulumtimet që do të ngjallnin interes dhe do t'i tërhiqnin nxënësit për këtë tematikë letrare.

Këngët e kreshnikëve shpjegohen si në vijim: *Në epikën legjendare përfshihen këngë që bëjnë fjalë për ngjarje e heroizma të individëve. Në epikën legjendare shqiptare, cikli i “Këngëve kreshnike” është më i njohuri dhe më i rëndësishmi. Kryeheronjtë janë Muji e Halili, dy vëllezër trima. Këngët e kreshnikëve këndoheshin të shoqëruara nga lahuta e më vonë edhe nga sharkia e çiftelia. Tematika e këtyre këngëve është aventureske. Trimëria, fuqitë mbinatyrore, bashkëpunimi me figurat mitologjike shqiptare, si Zanat dhe Orët e malit, tradhtitë dhe dashuria e respekti ndërmjet vëllezërve janë temat mbizotëruese.*

Një hapësirë e vogël i është dhënë njësisë mësimore *Figurat stilistike*. Të mësohen figurat letrare pa e mësuar fillimisht poezinë dhe veçoritë e saj është çështje e gabuar. Nëse figurat janë mure, poezia është themeli dhe muret nuk lartësohen pa qëndruar mbi themele. Në këtë njësi mësimore, figurat letrare shpjegohen shumë thjesht, jepen pak informacione mbi krahasimin, simbolin, metaforën, metoniminë, sinekdokën, personifikimin, hiperbolën e aliteracionin. Ata i shpjegojnë figurat letrare në këtë mënyrë: *Figura e simbolit ndërtohet kur një fjalë ka kuptimin e vet, por përdoret për të përfaqësuar diçka krejtësisht të ndryshme: Shembull: E gjithë bota është një skenë dhe të gjithë burrat dhe gratë janë thjesht lojtarë* (Adelina Selmani, Gjuha shqipe 7, fq.50, 2019) (Adelina Selmani, Gjuha shqipe, fq.51, 2019)

Krahasimin e shpjegojnë si në vijim: *Krahasimi është një figurë letrare me ç' rast përdoren lidhëza krahasuese “si” ose “sa” për të krahasuar një objekt ose koncept me një tjetër, për të sugjeruar se janë njësoj: Punëtore si bleta krahasimi)*

Për metaforën shprehen si në vijim: *Metafora pohon një fakt duke e nxjerrë nga krahasimi, por pa e krahasuar. Përderisa krahasimi thotë se je sikur një send tjetër, metafora thotë se je një send tjetër. Kur përdorim metaforën, pohojmë diçka që nuk ka kuptim të saktë. Për shembull, “Koha është hajdute”, koha nuk vjedh nga ju, por kjo përcjell idenë se orët ose ditët ndonjëherë duket të kalojnë pa u vënë re. Metafora ka kuptim vetëm kur ngjashmëritë midis dy gjërave që krahasohen*

janë të dukshme, por lexuesit e kuptojnë lidhjen ndërmjet fjalëve: *Shembull: Ti je drita ime (metafora).*

Metoniminë e kanë shpjeguar si në vazhdim: *Metonimia është figurë e përdorimit të një fjale që lidhet kuptimisht me një objekt apo koncept. Shembuj të metonimisë gjenden gjithandej, qoftë në tekste letrare, qoftë në gjuhën e përditshme. Metonimia është figurë që në mënyrë shumë të qartë përfaqëson tiparin e një koncepti të caktuar. Ndër shembujt e famshëm është: Shpata e ka kuptimin e sulmit ushtarak.*

Për figurën e sinekdokës kanë dhënë këto informacione: *Sinekdoka është përdorimi i pjesës për të përfaqësuar të tërën. Për shembull, kur themi “Me këtë punë ai nxjerr bukën e gojës”, fjala “bukën” e përfaqëson ushqimin në tërësi dhe jo vetëm bukën. Mirëpo sinekdokë është edhe përdorimi i së tërës për të përfaqësuar një pjesë të së tërës: “Policia ka ndaluar disa vetura që nuk kishin pajisje dimërore”. Në këtë rast fjala “policia” nuk e ka kuptimin e të gjithë policisë së botës apo policisë së një vendi, por bëhet fjalë për një dy a një grup të vogël policësh.*

Edhe për figurën e personifikimit kanë dhënë informacione: *Personifikimi u jep tipare njerëzore, objekteve, kafshëve, ose sendeve jo të gjalla. Kjo mund të ndikojë në mënyrën se si lexuesi i imagjinon gjërat. Personifikimi përdoret shpesh në poezi. Shembull: Fati i trokiti në derë. Hiperbola është një figurë e ekzagjerimit apo stërmadhimit të një sendi, apo të tiparit a cilësisë së tij: Ai gërhet zhurmshëm si një tren. Aliteracioni është përsëritja e të njëjtit tingull, ose grupi tingullor në një sërë fjalësh për të krijuar imazhin e dëshiruar: Vështron si shket sipër valash. (Adelina Selmani, Gjuha shqipe 7, fq.51, 2019)*

Pra, kur shpjegohen figurat, nuk demonstohen me shembuj nga vargjet e poezive, por me shembuj të thjeshtë. Me këta shembuj dhe me të dhënat e pakta që janë dhënë, nxënësit mund t'i lexojnë dhe t'i prodhojnë mekanikisht informacionet, por vështirë se mund t'i dallojnë figurat stilistike nëpër poezi dhe librat e tjerë.

Teksti dhe konteksti është një tjetër njësi mësimore në tekst që lidhet me fushën e letërsisë, e tërthorazi edhe me poezinë. Konteksti shpjegohet në këtë mënyrë: Konteksti i referohet një situatë ose rrethane. Ky term mund të përshkruajë situatën e krijuar brenda një narracioni ose brenda një teksti. Nëse një personazh është bllokuar në një ishull të shkretë pasi barka është fundosur, ne

do ta përshkruanim këtë gjendje si kontekst. E kemi shqyrtuar këtë njësi mësimore pasi që në librin Gjuha shqipe 7 - Fletore pune, është përfshirë një poezi si demonstrim i saj.

Ky tekst shkollor është shumë i papërshtatshëm, me material shumë të varfër gjuhësor e letrar. Me këtë tekst shkollor është i vështirë mësimi i gjuhës dhe i letërsisë, nuk mësohet poezia as mënyra se si ndërtohet ajo. Mungon tërësisht poezia, mungon aparatura didaktike dhe sistemi teorik-konceptual, ndërsa pasqyrohen përmbledhjet mbi lajmet, intervistat, tekstet hulumtuese, analitike, editorialet etj., as zhanreve të tjera letrare nuk është se u është dhënë vendi dhe hapësira e merituar, por me poezinë kanë vepruar mizorisht. Thënë shkurt e qartë më duhet të pohoj dhimbshëm se këta gjuhëtarë, profesorë e ligjërues të gjuhës shqipe, e kanë vrarë poezinë, e kanë copëtuar librin dhe e kanë zhveshur tërësisht nga pasuria letrare. *Gjuha shqipe 7* ka formën e një studimi të thjeshtë mbi fushën e gazetarisë dhe një studim i tillë assesi s'mund t'u ofrojë nxënësve mundësi për perceptim të lehtë të informacioneve nga gramatika dhe letërsia, për zhvillim të imagjinatës dhe mendimit kritik, për kënaqësinë shpirtërore që jep poezia dhe të nxënët e saj.

II.6.3 Poezia në librin Gjuha shqipe 7 - Fletore pune

Gabimin me mospërfshirjen e plotë të poezive në librin *Gjuha shqipe 7*, hartuesit e tekstit shkollor e kanë mbuluar me përfshirjen e pjesshme të poezive në librin *Gjuha shqipe 7 - Fletore pune*. Në këtë libër janë përfshirë shtatë poezi, që u përgjigjen temave nga letërsia, figurave stilistike, tekstit dhe kontekstit si dhe llojeve të poezisë lirike. Te njësia *Figurat stilistike* janë paraqitur dy poezi: *Mbretnesha* nga Kujtim Shala dhe *Dritaren lëre hapur* nga Basri Çapriqi. Të dyja janë poezi antologjike, shumë të pasura estetikisht dhe me vlera të larta poetike. Shumë të pasura me figura stilistike (metafora, simbole, metonimi, hiperbola), me gjuhë të shprehur figurative dhe me përmbajtje e tematikë të thellë.

Poezia *Mbretnesha* ka ligjërim të thellë kodifikues, të plotësuar me ndjeshmëri dhe tipare erotike, të shfaqura nga subjektiviteti i qenies. Në botën krijuese të Kujtim Shalës ndërtohen raportet si ideal i jetesës dhe qenësisë së njeriut: bota dhe hiqi, jeta dhe vdekja, e shkuara dhe e tashmja, vuajtja dhe dashuria, të cilat marrin funksion figurativ, poetik e simbolik me qëllim zgjidhjen

e zberthimin e enigmave të ligjërit. Kjo poezi trajton imazhin e dashurisë, mallin, kujtimin e dhimbjen. Dashuria përfaqësohet si emocion e dhimbje, si ndjenjë e shkrirë e fshehur, e mpiksuar në ekzistencën e individit.

Emocionet e autorit janë enigma që vështirë zberthehen, kode që vështirë se deshifrohen. Mbretnesha është vajza që e dashuron ai, ajo është e madhe, dashuria ndaj saj, është hyjnore, ajo është superiorja, prej saj varet ai dhe uni i tij. *Ndër sundin tënd / e tana rrugët mbarojnë te këmba jote..* (Paçarizi, Gjuha shqipe 7 - Fletore pune, fq.62, 2019)

Ajo është pushtuese e zemrës dhe fronit të tij shpirtëror. Prania e saj është jetë dhe lindje. Vetëm rruga të cilën e shkel ajo e bota që preket prej syrit të saj, ndrit, të tjerat, sipas poetit, janë të parëndësishme, veç pluhur dhe e shkuar.

Rrnoj/Kah shkel kamba jote/ e syni yt shejon/ tana tjerat janë pluhun (Paçarizi, Gjuha shqipe 7 - Fletore pune, fq.62, 2019)

Në përgjithësi poezia e autorit Kujtim Shala për t'u kuptuar duhet të lexohet si tërësi, kodifikimi ligjërues, bota figurative dhe përmbajtja e thellë e bëjnë poezinë *Mbretnesha* vështirë të perceptueshme dhe shumë pak të kuptueshme për nxënësit e klasës VII. Për ta ajo do të mbetet vetëm një ekuacion i pazgjidhur me shumë të panjohura. Një poezi që lexohet dhe nuk kuptohet të fëmijët, s' shkakton tjetër pos mosbesim, pasiguri e huti, assesi nuk ngjall emocion, nuk krijon kënaqësi as fisnikërim të ndjenjave.

Edhe poezia *Dritaren lëre hapur* bën pjesë në grupin e poezive antologjike, për shkak të ritmit, dhe shpalimit ideor, "dritarja" nuk është një objekt konkret, por merr përmasën e një simboli. Përmes dritares së hapur poeti nxjerr jashtë mllëfin e kërkon të hyjë brenda freskia. Dritarja që simbolizon dritën, ndriçimin dhe lirinë del edhe në poezi si simbol i çlirimit nga mbyllja, nga terri e nga e keqja. Ai kërkon përmes figuracionit të thellë, të jetë i pacunguar nga djallëzia, smira e pamëshira. Kërkon liri për qenin e për insektet dhe falje për të vdekurit. Me poezinë *Dritaren lëre hapur*, autori i thërret njerëzimit për katarzë shpirtërore, për ndërgjegje të pastër e çlirim hyjnor e tokësor.

Dritaren lëre hapur dritaren lëre

Çlirohu nga epshet nga faji

Përfalu me të vdekurit tuaj sidomos

Dritaren lëre hapur dritaren lëre

Me qentë ta bësh gjumin me insektet

Me shpirtrat e territ me zërat e largët. (Paçarizi, Gjuha shqipe 7 - Fletore pune, fq.62, 2019)

Edhe kjo poezi është e thellë me figura të shumta (metafora, simbole, personifikim) me përmbajtje të fuqishme letrare dhe natyrisht se vështirë do të perceptohet nga nxënësit e klasës VII.

Mbretnesha

Mbretneshtë

Asnjherë e prekun prej durve t'zeshkta
Kapakt e syve lshuem rand
Shtete e pushtete floku yt
E gjini i thepisun
Rrxojnë
Ku nis me dashtë ti
Mbarojnë ujnate qeta
Rritet zjarmi
Ku nis idhnimi yt
Rrukulliset qielli i bardhë
Rruzullimi vorr bahet
Me terr përziem mbi e ndër dhë

Mbretneshtë

Sa herë kujtoj se m'ishon sy
Tanë vullkanet i kam për veti
Dhe Mbretneshtë për veti ty
Ma dimën se dimni
N'mue
Ndër sundin tand
Lejnë e mbesin kput për dhë
Njerzit e dheut tem
E tana rrugtë mbarojnë te kamba jote
Me pak qiell t'rrxuem

Mbretneshtë

Për një vorr me pak qiell përziem
Rrnoj
Kah shkel kamba jote
E syni yt shejon
Tana tjerat janë pluhun
E tjetër s'bahen asnjherë

Kujtim Shala

Dritaren lëre hapur

Dritaren lëre hapur dritaren lëre
të hyjë ajri nga rruga flaka t'i dalë
Dritaren lëre hapur dritaren lëre
ta përpish frymën
të dalë erë e keqe e trupit
Dritaren lëre hapur dritaren lëre
të thyhet vizioni në sy ta spastrosh shpirtin
nga hapësirë e mbyllur
Dritaren lëre hapur dritaren lëre
ushton zë epik i poetëve nxitojnë fëmijët të ikin
nga terr nga tingujt e mprehur
Dritaren lëre hapur dritaren lëre
zbrasin bishat nga malet
shkelin mollët në gratë e vdekura
Dritaren lëre hapur dritaren lëre
shi bie pak ujë sidomos pak ujë
në buzë të plasur vëre
Dritaren lëre hapur dritaren lëre
çlirohu nga epsheet nga faji
përfalu me të vdekurit tuaj sidomos
Dritaren lëre hapur dritaren lëre
me qentë ta bësh gjumin me insektet
me shpirtat e territ me zërat e largët
Dritaren lëre hapur dritaren lëre
kufomat janë bashkudhëtarët tuaj të sinqertë shih
ata s'të vrasin s'të zënë kalimin frymën
Dritaren lëre hapur dritaren lëre
para se të niseni në atë udhëtim të fundit
me nga një ombrellë të çeliktë shi i kuq pikë
Dritaren lëre hapur dritaren lëre
thyeje pasqyrën katrore me fytyrën tënde në
kënd të dhomës e nisur
Dritaren lëre hapur dritaren lëre
se ti je i vdekur në ushtrinë që marshon nga
qielli mbylle derën mbylle
mos të dalin bishat dhe njerëzit

Basri
Çapriqi

Te njësia llojet e poezisë lirike, janë pasqyruar tri poezi: (*Shpell' e Dragobisë, Mes grilash - feniks, Vaje*), por nuk janë përcaktuar se cilit lloj i përkasin, nuk janë shpjeguar fjalët e panjohura e as janë përcjellë me detyra dhe ushtrime që nxisin thellimin e dijeve letrare. Ne i kemi përcaktuar llojet si në vijim: Poezia *Shpellë e Dragobisë* (himn), *Mes grilash- Feniks* (sonet), dhe *Vaje* (Elegji). *Mes Grilash - feniks* është poezi e formës sonet, dedikim për shkrimtarin e madh Adem Demaçi, informacione të tilla nuk pasqyrohen në tekst, pra nxënësit nuk informohen se kjo poezi

është e formës letrare sonet, as që i dedikohet Adem Demaçit. Vlerat e poezisë janë të nivelit të lartë kulturor e artistik. Me mjeshtëri poetike himnizohet ideali, lufta dhe sakrificat e Adem Demaçit. Për poetin Mustafa, Adem Demaçi është feniks, që ngjallet dhe ndrit rrugët e fitores, qëllimi i lirisë ngadhënjën mbi grilat dhe mbi vetminë.

Dhe prore po zbres në sytë e rrugëve kah ti

E ëmbël është vdekja në qëllim

Me e puthë atë dritë në horizonte që rri

Akoma i etur jam në këtë varg, i humbur në trishtim (Paçarizi, Gjuha shqipe 7- Fletore pune, fq. 66, 2019).

Siç e dimë soneti ndërtohet nga dy strofa katërshe dhe dy strofa treshe, mirëpo në tekstin *Gjuha shqipe 7- Fletore pune*, janë bashkuar katrenat me tercinat dhe kjo bën që nxënësit ta kenë të vështirë njohjen e kësaj forme letrare, qoftë edhe si strukturë.

I. Lexo poezitë në vazhdim dhe trego se ç'loji i përkasin. Pastaj analizojini në klasë bashkë me arsimtarin apo arsimtaren.

Shpell' e Dragobisë

Kur tufani e çthuri fenë,
Kur tirani e krrusi atdhenë,
Mi një brek të Dragobisë
Priret Flamur' i lirisë.

Atje nisi, atje mbaroj,
Atje krisi, atje pushoj,
Rrufe-shkab' e Malësisë,
Në një shkëmb të Dragobisë.

Vendi dridhej, ay mbeti
Se s'tronditej nga tërrmeti.
Dif drangoj i Dragobisë,
Trim tribun i Vegjëlisë.

O Bajram, bajrak i gjallë,
More nam me gjak në ballë,
Te një shpell' e Dragobisë,
Yll i rrall' i burrërisë.

Thon' u-shtri e thon' u-vra,
Po ti s'vdiqe, or Baba,
As te shkëmb' i Dragobisë,
As te zëmr' e Djalërisë.

As je vrar' e as po vritesh
Legjendar Ante po rritesh.
Dithiramb i Dragobisë,
Tmerr, panik i mizorisë.

66

(Fan Noli)

MES GRILASH – FENIKS

Agimin e zi po e ngjyros me lot kujtimi
Derisa këngën po e thyej nëpër fytyrën tënde
E në heshtje po tretëm e fikem si jetimi
Me ndezë dëshirat e fjetura si krande
Dhe prorrë po zbres në sytë e rrugëve kah ti
E ëmbël është vdekja në qëllim
– Me e puthë atë dritë në horizonte që rri
Akoma i etur jam në këtë varg, i humbur në
trishtim

Qetësi e natës kridhet në grila e mbërthyer
I lodhur një zog diku me krahë të thyer
Tash këngës ia thotë me afsh në gj
– I amshuar balsam në varg qëndron
Këngë ngadhënjimi lyre e poetit shënon
Rrugët ndrit qëllimi në këtë natë plot vetmi.

(Xhemail Mustafa)

Për himnin dhe elegjinë janë dhënë pak informacione në librin bazë, andaj edhe kuptimi i tyre do të jetë më i lehtë për këta nxënës. *Vaje* është elegji për gruan e vdekur.

Në këtë poezi poeti shpreh dhimbjen e madhe për humbjen e gruas si dhe mbetjen e djalit jetim, ta shohë djalin teksa rritet pa ngrohtësinë e së ëmës për autorin është dhimbje e madhe. Në vargjet e fundit shihet humbja e motivit, vullnetit dhe kënaqësisë për jetë pikërisht nga malli që ka lënë pas humbja e Evgjenisë.

Edhe poezia *Shpell' e Dragobisë* është elegji. Poezia *Shpell' e Dragobisë* e shkrimtarit të letërsisë shqiptare F.S. Noli është një elegji kushtuar trimit kosovar Bajram Curri, i cili luftoi me trimëri të rrallë kundër pushtuesve osmanë, shovinistëve serbë dhe kundër Ahmet Zogut. Bajram Curri nuk u arratis jashtë atdheut as pas Revolucionit të Qershorit, por, përkundrazi, qëndroi maleve të Shqipërisë ku u rrethua në Shpellën e Dragobisë (katund në Malësinë e Gjakovës) dhe u vra duke u përpjekur të çajë rrugën me armë në dorë.

Te njësia teksti dhe konteksti, në librin Gjuha shqipe 7 - Fletore pune, janë demonstruar dy poezi, *Lum Lumi* (e shkurtuar) si dhe poezia *Armenia* e Ali Podrimjes. Te poezia *Lum Lumi* kërkohet nga nxënësit të ndërtohet konteksti dhe rrethanat në të cilat është shkruar ajo. Meqë poezia është e shkruar me një gjuhë gati të zakonshme dhe ka përmbajtje lehtë të perceptueshme, nxënësit do ta kenë më të lehtë receptimin dhe interpretimin e saj, do ta kuptojnë se në këtë poezi pasqyrohet qëndrimi i Lumit në spital teksa përballëj me sëmundjen e rëndë, dhimbja e babait teksa shihte të birin që vuante dhe shpresa e tij për ditë më të mira.

A thua është dita jote e fundit në spital

Do t'i biem deri ne fund a thua

Edhe kësaj dite të lodhur në orën e familjes. (Paçarizi, Gjuha shqipe 7- Fletore pune, fq.54, 2019)

Në anën tjetër te poezia *Armenia* e cila pasqyrohet brenda tekstit në këtë mënyrë:



Armenia/ Ar(dh) menia te kjo poezi kërkohet nga nxënësit të zbulohen fjalët që ndihmojnë në gjetjen e kontekstit në të cilin është shkruar ajo. S’ka asnjë informacion mbi poezinë dhe përmbajtjen e saj, andaj natyrisht se këtu nxënësit do ta kenë më vështirë të zbulojnë elementet që ndihmojnë në gjetjet e kontekstit.

II.6.4. Mungesa e aparaturës didaktike për poezinë në tekstet shkollore të shkallës së tretë të kurrikulës (Gjuha shqipe 6 dhe 7)

Pas hartimit të kurrikulës së re, e cila bazohet në kompetenca një ndër objektivat themelore do të jetë edhe hartimi i teksteve të reja shkollore, të cilat janë pjesë përbërëse e realizimit të procesit mësimor në shkolla. Brenda teksteve shkollore aparatura didaktike zë një vend tejet të rëndësishëm, prandaj gjithnjë duhet të jetë në funksion të mësimdhënësve e nxënësve, për punë më atraktive dhe më të lehtë me tekstin. (Bashkim Azemi, Aparatura didaktike në tekstet shkollore, fq.7, 2013)

Jo gjithherë hartuesit e teksteve shkollore orientohen nga aparatura didaktika, shpesh më tepër i japin vëmendje përmbajtjes nga niveli shkencor sesa strukturës metodike, ani se aparatura didaktike u ndihmon teksteve shkollore që ta kenë përmbajtjen sa më të kuptueshme.

Aparaturë didaktike konsiderohen të gjitha ato pjesë përcjellëse që nuk janë tekst themelor, por që janë në funksion të tekstit mësimor, të cilat kontribuojnë për kuptimin më të mirë të

informacioneve të tij, si: pyetjet, detyrat, shprehjet, fjalori, ilustrimet, biografitë, komentet, udhëzimet etj. (Bashkim Azemi, Aparatura didaktike në tekstet shkollore, fq.14, 2013)

Aparatura didaktike është pjesë përbërëse e të gjitha teksteve shkollore, ani pse shpeshherë është e mangët dhe e papërshtatshme.

Aparatura e qëlluar didaktike: Ilustrimet, detyrat, pyetjet dhe fjalorët, e bëjnë më të lehtë mësimdhënien dhe mësimnxënien, i thjeshtojnë përmbajtjet, ngjallin interesimin e nxënësve, si dhe u shton efikasitetin orëve mësimore.

Gjuha shqipe 6 përmban gjithsej 188 njësi të aparaturës didaktike, 37 njësi mësimore, 39 ilustrime dhe foto, 24 pyetje, 25 detyra, 48 bashkëbisedojmë, 5 fjalorë, 10 detyra dhe diskutim. *Detyra dhe pyetje* është rubrikë e cila paraqitet shpesh në libër, pyetjet janë kryesisht pyetje që kërkojnë mësim riprodhues dhe pa motive nxitëse për zhvillim të mendimit kritik e imagjinatës së nxënësve. P.sh. në faqe 19 të librit bazë pasi mësohet poezia, *Gjashtë shokët besnikë*, shtrohet pyetja: Cilët qenkan gjashtë shokët besnikë të personazhit të vjershës? - pyetje që nuk kërkon shumë angazhim as përpjekje për të nxjerrë në dritë përgjigjen, në të njëjtën detyrë më bie në sy gjuha ofenduese dhe diskriminuese që është përdorur në kundërshtim me etikën dhe rregulloren ligjore për hartimin e teksteve shkollore. Pyetja: *Personazhi i kësaj vjershe duket se bën shumë pyetje, kjo do të thotë se ai është:*

- Kureshtar
- Hutaq
- Budalla

Kjo pyetje mund të shkaktojë ndjesi jo të pëlqyera për nxënësit dhe për mësimdhënësit, ndjenja të frikës e mosbesimit ndaj ambientit të ngrohtë shkollor. (Bardh Rugova, Gjuha shqipe 6, fq.19, 2019) shumë rrallë pyetjet janë të natyrës analitike e hulumtuese që kërkojnë angazhim dhe interes të veçantë nga nxënësit.

Njësi tjetër e shpeshtë e aparaturës didaktike në libër është njësia *Bashkëbisedojmë*, në këtë njësi jepen përmbledhje të shkurtra në lidhje me temat mësimore që përfshihen në tekst. Sikur njësitë

mësimore edhe rubrikat bashkëbisedojmë, vuajnë nga varfëria e materialit mësimor, të dhënat nuk janë të përshtatshme dhe thelbësoret për temat që shkruhen, andaj themi se nuk i përmbushin as për së afërmi nevojat dhe kërkesat e nxënësve. P.sh. në faqe 49 është shkëputur një tregim nga romani *Shpella e piratëve* dhe është bërë kjo përmbledhje për të:

Kjo është një pjesë nga romani “Shpella e piratëve”. Në këtë pjesë kemi shtjellimin e një ideje. Romani brenda vetes i shtjellon ngjarjet në mënyrë më të gjerë, duke përfshirë më shumë episode. Ky është një episod i përballjes së një peshkatari me peshkaqenin. (Bardh Rugova, Gjuha shqipe 6, fq.49, 2019)

Rubrika *Detyrë*, paraqitet më së shpeshti me kërkesën për nxënësit që ta bëjnë përmbledhjen e pjesës që e kanë lexuar në tekst, theksoj se detyra të tilla më ka rastisur të shoh edhe në tekstet shkollore të klasës së tretë dhe të katërt, pasi moshën e tyre nuk lejon për mësim analizues e studiues, por më tepër merren më mësimin riprodhues. Shpesh në rubrikën *Detyrë* shtrohen pyetje të thjeshta që kërkojnë përgjigje të drejtpërdrejta ose përgjigje me alternativa dhe rrumbullakosje. Te njësia *Zhanret dhe kategoritë letrare* e gjithë detyra që u shtrohet nxënësve është rrumbullakosja e përgjigjes së saktë të pyetjeve të parashtruara:

p.sh. Teksti i mësipërm është:

- a) prozë
- b) poezi
- c) tekst letrar
- d) tekst joletrar

Dembelia dhe joserioziteti i hartuesve të këtij teksti shpalosin ushtrimet praktike kaq të pakta dhe të pamjaftueshme për zhvillim e përparim gjuhësor e letrar. Në gjithë tekstin janë përfshirë vetëm pesë fjalorë apo rubrika me fjalë të reja.

Fjalët e reja evidentohen në tekst, mirëpo nuk u shpjegohet kuptimi, pra mbeten të panjohura për nxënësit. P.sh. në faqe 26 të librit bazë janë gjetur fjalët e reja: *Galop, lëndinë, puhi, mamuze, rrangallë, mokër*, por asnjëra nga këto fjalë nuk i është shpjeguar domethënia. (Bardh Rugova, Gjuha shqipe 6, fq.26, 2019)

Fjalë të reja:

Galop, lëndinë, puhi, mamuze, rrangallë, mokër

Kilometër = njësi matëse.

(Autori, në të vërtetë, e përdor fjalën legë. Një legë është përafërsisht aq sa mund të ecë një njeri për një orë. Pra, përfshin distancë 4 deri gati 6 kilometra).

26

Njëjtë është vepruar me gjithë fjalorët e përfshirë në tekst, p.sh. në faqe 72 janë gjetur fjalët *cohë, koshare, skëterrë, i sertë, mëri etj.*, por edhe këto të pashpjeguara. (Bardh Rugova, Gjuha shqipe 6, fq.72, 2019)

Ulliam Ernest Henlej

I PAMPOSHTURI



Pyetje dhe diskutim:

- Cilët janë subjekti dhe tema e kësaj vjershe?
- Çfarë ndjenje keni kur e lexoni këtë vjershë?

Tek nata më mbulon anembanë,
E zezë si skëterra pambarim,
I falënderoj zotat kudo janë,
Për të pamposhtshmin shpirtin tim.

Kur rrethanat më shtynë me hov të rreptë
As kam dënesur, as qarë me lot
Tek më kaploi një fat i sertë
Kokën ma thyen, por s'ma ulën dot


Diku përtej vajit dhe mërisë
Ku tmerri i ferrit mori të sundojë
Kërcënimi i viteve që vijnë
Nuk më zë kurrë në drojë

S'ka gjë që porta s'më zë dot
As sa i ashpër secili ndëshkim
Për fatin tim unë dal zot
Jam komandant i shpirtit tim

Fjalë të reja:

Agmi, cohë, koshare, skëterrë, i sertë, dënes, kërcënim, mëri

Fotografitë dhe ilustrimet të shumtën e herëve nuk përshtaten me pjesën përmbajtësore të tekstit si dhe tekstet brenda ilustrimeve janë të pasqaruara dhe të pakuptueshme. Edhe fotografia e heroit Skënderbe paraqitet shumë e dobët grafikisht, nuk vërehet mirë, nuk vijëzohet pamja e fytyrës dhe mezi dallohet figura e tij.



Edhe rubrika *Detyra dhe diskutim* ndërtohet me pyetje të thjeshta, të drejtpërdrejta pa shumë mundësi për analiza të hollësishme letrare e ushtrime praktike për t'i zbërthyer konceptet teorike. *Libri Gjuha shqipe 6 - Fletore pune* gjithsej përmban 94 njësi të aparaturës didaktike. Prej tyre, 37 njësi mësimore, 44 detyrë, 15 pyetje, duhet theksuar se ky libër përmban një numër të konsiderueshëm të ushtrimeve praktike.

Njësia *Detyrë* kryesisht përmban detyra që kërkojnë nga nxënësit të bëjnë përmbledhjen e temave të mësuara shkurtimisht, si dhe të bëjnë hulumtime në internet për tema të caktuara. Njësi tjetër e aparaturës didaktike është rubrika *Pyetje*, te kjo rubrikë zakonisht paraqiten pyetje të cilat lidhen drejtpërsëdrejti me temat mësimore dhe nxisin mësimin riprodhues.

Përveç këtyre njësive, libri përmban disa ushtrime praktike të organizuara pak më mirë se në librin bazë. Këta shembuj kërkojnë angazhimin e nxënësve, i nxisin për punë praktike dhe për mësim nga libri, ushtrimet praktike janë të rëndësishme, sepse e bëjnë mësimin më interesant dhe

përmbajtjen mësimore më lehtë të perceptueshme. *Gjuha shqipe 7* përmban gjithsej 104 njësi mësimore, mirëpo në këtë tekst shkollor mungon tërësisht aparatura didaktike, e cila lehtëson të kuptuarit e përmbajtjeve mësimore nga nxënësit, si dhe e bën më të lehtë mësimdhënien dhe mësimnxënien në të gjitha etapat e orës. Përveç temave mësimore, që shumica janë nga lëmi i gazetarisë, s'ka ndonjë njësi të aparaturës didaktike.

Hartuesit e tekstit shkollor *Gjuha shqipe 7* sikur kanë harruar se çdo temë e re ka nevojë për një material mbështetës që nxit dhe ndihmon nxënësit të reflektojnë dhe të analizojnë njohuritë e dhëna. Materiali mbështetës mund të përmbajë pyetje të ndërlidhura me material që pasqyrojnë njohuritë e dhëna, kërkesa të hartuara në mënyrë të tillë që ta shtyjnë nxënësit të formësojë mendimin e vet kritik.

Aparatura didaktike është shumë e rëndësishme dhe e bën më të lehtë mësimdhënien dhe mësimnxënien. Mungesa e saj te nxënësit shkakton vështirësi në përvetësimin e informacioneve dhe te mësimdhënësit vështirësi në shpjegim. E pamë se në librin bazë *Gjuha shqipe 7* mungon tërësisht aparatura didaktike, ndërsa këtë mungesë hartuesit janë përpjekur ta plotësojnë në librin *Fletore pune*. Libri *Gjuha shqipe fletore pune 7* nuk ka njësi të ndara të aparaturës didaktike, por pas secilës njësi mësimore janë shtruar disa pyetje dhe ushtrime të cilat sadopak mund t'i nxisin nxënësit për mësim.

Detyrat dhe ushtrimet kryesisht parashtrojnë pyetje rikujtuese, përmbledhëse dhe më pak pyetje të komentit e pyetje kreative. Aparatura didaktike e lehtëson të kuptuarit dhe ndihmon në zbërthimin e çështjeve mësimore, e bën tekstin më të kuptueshëm dhe më të qartë, andaj mungesa e saj në tekstet shkollore është humbje e madhe për të gjithë e, në veçanti, për nxënësit.

II.7 Krahasimi i teksteve Gjuhë shqipe 6 dhe 7 (botimet e Dukagjinit), të përcaktuara me kurrikulë dhe tekstet paraprake Leximi letrar 6 (botimet Albas) dhe Leximi letrar 7 (botimet Libri shkollor)

Tekstet shkollore janë pjesë përbërëse dhe shumë e domosdoshme e procesit mësimor, u shërbejnë nxënësve dhe mësimdhënësve për mësimdhënie dhe mësimnxënie sa më të lehtë. Sipas UNESCO-s tekstet shkollore duhet të nxisin çdo element të procesit të nxënies dhe roli i tyre të mos kufizohet vetëm mbi nxënien e njohurive faktike, si cilësi që nxit aktivisht nxënësin drejt procesit të ndërtimit të dijeve, shkathtësive dhe qëndrimeve të nevojshme për t'u bërë qytetar i përgjegjshëm në komunitetin ku jeton. (Bashkim Azemi, Aparatura didaktike në tekstet shkollore, fq.13, 2013).

Përmbajtjet mësimore sa më të përshtatshme për moshën e nxënësve si dhe aparatura e duhur didaktike i bëjnë tekstet shkollore më të kuptueshme, më atraktive dhe më tërheqëse për nxënësit dhe u ndihmojnë atyre që ata të përgatiten për punë të pavarur, për të mendim kritik dhe për pasurim të fjalorit me fjalë dhe shprehje të reja. Kur i krahasuam tekstet shkollore të shkallës së tretë, *Gjuha shqipe 6 dhe 7* të përcaktuara me kurrikulë dhe tekstet shkollore *Leximi letrar 6, botim i Albasit dhe Leximi letrar 7, botim i Librit shkollor*, arritëm të nxjerrim këto dallime:

Gjuha shqipe 6 (botimi i Dukagjinit) i përcaktuar me KKK nuk u ka dhënë prioritet kriterëve shkencore didaktike në përzgjedhjen e pjesëve gjuhësore e letrare të teksteve, në anën tjetër *Leximi letrar 6* i shmanget konceptit të vjetër antologjik në hartimin e teksteve të leximit, duke i vënë në radhë të parë kriteret shkencore e didaktike. Te pjesa e poezive *Gjuha shqipe 6* janë përfshirë vetëm pesë poezi, të cilat shoqërojnë tema të ndryshme të fushave gjuhësore, gramatikore e psikologjike. Asnjëra nga poezitë nuk është trajtuar e analizuar për nga aspekti letrar. Nuk janë seleksionuar poezitë sipas llojeve të shkrimit e as janë dhënë shpjegime për përmbajtjen e tyre. Poezitë e përzgjedhura janë të papërshtatshme për moshën e nxënësve, vështirë të kuptueshme dhe të analizueshme nga ta. Në anën tjetër të *Leximi letrar 6* janë përfshirë gjithsej shtatëmbëdhjetë poezi, ato janë ndarë në grupin e poezisë lirike e më pas janë dhënë edhe nëndarjet në poezi atdhetare, poezi të peizazhit, poezi me tematika të ndryshme, poezi të llojit fabul etj. Të gjitha poezitë trajtohen nga aspekti letrar, për secilën poezi është dhënë shpjegim se çka përmbajnë dhe çfarë mesazhi përçojnë te nxënësit. Jepen informacione se nga cili libër janë shkëputur poezitë dhe çfarë lloji i poezive janë. P.sh. Poezia *Vjeshta* nga *Leximi letrar 6*, është poezi peizazhi e shkëputur nga libri *Vepra të zgjedhura*, e shkruar me një gjuhë të qartë e koncize, shumë të kapshme për nxënësit e klasës VI.

Te libri *Gjuhë shqipe 6* poezitë nuk seleksionohen fare në grupin e llojeve letrare, nuk shpjegohen për nga përmbajtja as për nga elementet e tjera letrare, ndërsa në *Leximin letrar* ndahen sipas llojit, shpjegohen në plotëni, si përmbajtjet edhe fjalët e panjohura si dhe detyrat pasuese janë të lidhura ngushtë me to me shpjegimin e vargjeve, temës, rimës, mesazhit që e përcjell ajo te nxënësit.

Te *Leximi letrar 6* elementet e poezisë, ritmi, strofa, rima si dhe figurat stilistike gjithmonë janë shpjeguar e demonstruar me vargjet e poezive të përfshira në tekst, ndërsa te *Gjuha shqipe 6*, nuk shpjegohet asnjë element i poezisë, ndërsa figurat letrare nuk demonstrohen me vargje të poezive të përzgjedhura në libër.

Tek *Gjuha shqipe 6* figurat letrare mësohen si njësi e veçantë, pa asnjë poezi pasuese, ndërsa merren shembuj të thjeshtë: *I shpejtë si vetëtima.*, e në anën tjetër në librin *Leximi letrar 6*, në faqe 87 mësohet poezia *Bota fëmijërore* dhe njëkohësisht shpjegohet figura e hiperbolës e paraqitur me vargjet e poezisë: *Pesë kilometra dëshira* (Rita Petro, 2004)

Sqarimet e dhëna për secilën poezi, grupimi brenda llojeve dhe nënndarja në poezi atdhetare, peizazhi, epike, fabula, gjëgjëza, gjuha e lehtë dhe jo shumë e figurshme si dhe përmbajtja e qartë dhe koncize bën që këto poezi të shkaktojnë ndjenja, emocione dhe kënaqësi te nxënësit, si dhe lehtësi për mësimdhënësit. Edhe tek aparatura didaktike vërejtëm dallime të shumta, në *Leximin letrar 6* janë gjithsej 358 njësi të aparaturës didaktike. Prej tyre 52 njësi mësimore, 37 fjalorë, 64 ilustrime dhe foto, 26 biografi, 53 kuptojmë tekstin, 30 vlerësojmë dhe interpretojmë tekstin, 49 studiojmë tekstin, 49 studiojmë gjuhën e tekstit dhe 49 detyra. Në anën tjetër *Gjuha shqipe 6* përmban gjithsej 188 njësi të aparaturës didaktike. Prej tyre 37 njësi mësimore, vetëm pesë fjalorë, fjalët e huaja evidentohen, por nuk sqarohen fare domethëniet e tyre, janë 39 foto dhe ilustrime, asnjë biografi dhe 35 detyra, 24 njësi me pyetje dhe 48 njësi të llojit bashkëbisedojmë.

Te *Leximi letrar 6* secila njësi mësimore në punën me tekstin është e ndërtuar nga katër rubrika:

1. *Kuptojmë tekstin*
2. *Studiojmë gjuhën e tekstit*
3. *Vlerësojmë dhe interpretojmë tekstin dhe*
4. *Nganjëherë është përcaktuar edhe ndonjë detyrë shtesë.*

Në rubrikën *Kuptojmë tekstin* fillimisht jepen sqarime për njësinë mësimore, pastaj jepen detyra dhe pyetje që zgjojnë kërshërinë e nxënësve, nxisin imagjinatën dhe mendimin kritik, i motivojnë nxënësit për mësim aktiv dhe e lehtësojnë të kuptuarit e përmbajtjeve. Te rubrika *Studiojmë gjuhën e tekstit* shpjgohen elementet si: rima, strofa, figurat stilistike si dhe u kërkohet nxënësve t'i dallojnë ato nëpër vargjet e poezive.

Rubrika *Vlerësojmë dhe interpretojmë* i ndihmon nxënësit të zbulojnë kuptimet e figurshme, ka detyra dhe ushtrime praktike që kërkojnë angazhim dhe hulumtim, qoftë grupor, qoftë individual. Detyrat gjithmonë janë të lidhura ngushtë me njësinë mësimore si dhe nxisin interesimin e nxënësve për mësim.

Libri *Gjuha shqipe 6* më së shpeshti ndërtohet nga rubrika *detyrë* dhe *bashkëbisedojmë*. Në rubrikën *bashkëbisedojmë* jepen disa shpjgime të shkurtra në lidhje me njësinë mësimore, jo shumë të qarta dhe të kuptueshme. Pyetjet që shtrohen, të shumtën e rasteve, janë pyetje që nxisin mësimin riprodhues e më pak atë kreativ. Rubrika *detyrë*, nuk ka detyra as ushtrime të tjera përveç kërkesës për të përmbledhur njësinë mësimore me mendimet e nxënësve. Njësoj si teksti *Gjuha shqipe 6* e përcaktuar me KKK edhe *Gjuha shqipe 7*, u është shmangur në tërësi kriterëve të përcaktuara për përdorimin e teksteve shkollore. Ky libër nuk i plotëson kriteret shkencore e didaktike e as përmban fare aparaturë didaktike. Libri *Gjuha shqipe 7* është shumë i varfër edhe në aspektin e përzgjedhjes së materialit dhe përmbajtjes mësimore.

Mungojnë përmbajtjet gjuhësore e sidomos përmbajtjet letrare. Në gjithë librin nuk është përfshirë asnjë poezi e vetme, përveç në librin Fletore pune, në anën tjetër libri *Leximi letrar 7*, nga Mazllom Kumnova dhe Munish Hyseni, botim i vitit 2004, është shumë më i plotësuar si nga kriteret shkencore e didaktike, si për nga përzgjedhja e përmbajtjes gjuhësore e letrare, ashtu edhe për nga aparatura didaktike.

Leximi letrar 7 përmban gjithsej dymbëdhjetë poezi, të cilat përmbajnë sqarime për përmbajtjen dhe kuptueshmërinë e tyre. Poezitë janë të përshtatshme për moshën e nxënësve, ngjallin emocione dhe përcjellin mesazhe të karakterit didaktik. Secila poezi është e ndërlidhur ngushtë me detyrat

dhe ushtrimet që pasojnë. Edhe këtu poezitë e përzgjedhura janë të shkruara me gjuhë të lehtë, të kuptueshme, përmbajtje të qarta si dhe fjalorë e shpjegime për secilën fjalë.

Sa i përket anës didaktike *Gjuha shqipe 7* nuk ka fare aparaturë didaktike, ndërsa libri *Leximi letrar 7*, botim i Librit shkollor, gjithsej përmban 292 njësi të aparaturës didaktike. Prej tyre, 40 njësi mësimore, 30 fjalorë, 61 ilustrime, 31 foto, 29 biografi, 2 detyra dhe 36 punë e pavarur, 22 të mësojmë më shumë, 39 të bisedojmë për tekstin dhe 2 provo edhe këtë. Secila poezi pasohet nga tri rubrika:

- Bisedojmë për tekstin
- Punë e pavarur dhe
- Fjalor

Rubrika *bisedojmë për tekstin* përmban pyetje të cilat nxisin mësimin riprodhues, por edhe atë kreativ, zhvillojnë imagjinatën dhe mendimin kritik. Edhe rubrika *Punë e pavarur* stimulon nxënësit, përmes detyrave dhe ushtrimeve të përshtatshme që ata të merren me letërsi dhe poezi, jo vetëm në mënyrë pasive, receptive, por edhe në mënyrë kreative, komunikative, vepruese dhe krijuese. Përmes fjalorëve shpjegohen fjalët e huaja dhe shpjegimi i tyre paraqet shumë rëndësi dhe lehtësi në të kuptuarit e përmbajtjeve nga nxënësit. Me detyra praktike dhe të qarta, pyetje me karakter kërkues dhe fjalorë të shumtë, mësimi gjithmonë do të jetë më i lehtë.

Duke e pasur parasysh përmbajtjen e teksteve shkollore dhe përshtatjen e tyre me zhvillimin psikik e intelektual të nxënësve, pajisjen e tyre me aparaturë didaktike dhe ndërlidhjen e plotë të saj me përmbajtjen, detyrat, pyetjet dhe fjalorët arrijmë në përfundim se leximi letrar 6 dhe 7 janë më të përparshëm me realizimin e kriterëve të përgjithshme për hartimin e teksteve shkollore, më të kuptueshme, më të kapshme e të përshtatshme për moshën e nxënësve.

III. METODOLOGJIA

Në këtë studim populacion janë nxënësit e katër shkollave fillore në Mitrovicë, ShFMU “*Abdullah Shabani*”; *Ismail Qemali*” “*Musa Hoti*” dhe “*Andon Zako Çajupi*” Hulumtimi është i tipit sasior, mostra e përgjithshme në hulumtimin tonë përfshin gjithsej dy nivele klasore në të cilën kemi zbatuar pyetësin për nxënës dhe pyetësin tjetër të cilin e kemi realizuar me mësimdhënësit. Numri i nxënësve të cilët kanë marrë pjesë në hulumtim është përafërsisht 60 të klasës VI dhe 60 të klasës VII, gjithsej 120 nxënës. Pas zhvillimit të pyetësorëve dhe marrjes së rezultateve të dhënat janë përpunuar nga programi statistikor SPSS duke përdorur grafikët dhe tabelat e statistikave të ndryshme.

III.1. Qëllimi i hulumtimit

Baza e këtij hulumtimi është poezia si lloji më i zhvilluar i krijimtarisë poetike. Ky hulumtim është i lidhur ngushtë me pjesën teorike dhe praktike duke pasur si bazë poezitë në tekstet shkollore të shkallës së tretë. Duke u nisur nga këto, hulumtimi ka për qëllim të shohë se sa përkojnë poezitë dhe tematika e tyre me nivelin arsimor në të cilin përdoren si dhe sa janë të përshtatshme për mësimdhënësit që t’i shpjegojnë e paraqesin sa më qartë para nxënësve si dhe do të mundohemi të shohim sa e njohin nxënësit këtë gjini letrare dhe sa i kuptojnë poezitë e përfshira në tekstet shkollore.

III.2 Pyetjet e hulumtimit

Rëndësi të veçantë për projektin kanë pyetjet e hulumtimit. Roli i tyre në punim është i dyanshëm. Në njërin anë shprehin qëllimin e hulumtimit në anën tjetër ndihmojnë në gjithë procesin e hulumtimit.

1. Sa e kanë plotësuar kriterin e përzgjedhjes sipas kurrikulës poezitë e përfshira në këto tekste shkollore?
2. Sa janë të perceptueshme për nxënësit e klasave VI dhe VII këto krijime poetike?
3. Sa e ndiejnë dhe e përjetojnë poezinë gjatë leximit dhe interpretimit nxënësit?

III.4 Hipotezat e këtij punimi janë:

1. Tekstet e reja shkollore për letërsinë, të miratuara më 2019 nga Ministria e Arsimit, nuk i plotësojnë kriteret e përzgjedhjes për lëndën e gjuhës shqipe dhe konkretisht për poezinë.
2. Tekstet shkollore për klasën VI dhe veçanërisht për klasën VII as në përqindjen më të vogël nuk e kanë të përfaqësuar poezinë dhe aparaturën didaktike të të nxënit të saj.

III.5 Metoda e kërkimit

Përfundimet në çdo fushë dalin vetëm atëherë kur janë vëzhguar dhe përpunuar të dhënat e dala nga studimi dhe puna shkencore e kryer.

Si bazë e studimit janë marrë tri pyetje kërkimore dhe dy hipoteza. Analizat e të dhënave të marra nga pyetësorët do të na ndihmojnë për t'i vërtetuar hipotezat e punimit.

III.6 Mostra

Grupin e studimit në këtë hulumtim e përbëjnë gjithsej 120 nxënës të shkollave fillore. Nxënësit janë të gjinisë mashkullore dhe femërore, moshë ideale është nga 11-12 vjeç për klasën VI dhe 12-13 vjeç për klasën VII. Për më shumë informacione do të paraqesim tabelën më poshtë me të dhëna mbi mostrën e pjesëmarrësve.

Analiza e të dhënave përfshin një numër operacionesh të ngjashme të realizuara me qëllim të përmbledhjes së të dhënave dhe të organizuara në atë mënyrë që t'u përgjigjen pyetjeve kryesore të studimit duke i pohuar ose mohuar ato. Kjo fazë e studimit fillon me përcaktimin e variablave dhe kodimin e tyre për të bërë të mundur lehtësimin në hedhjen e të dhënave.

Pasi janë koduar variablat dhe janë hedhur të dhënat, është realizuar procesi i përpunimit të të dhënave.

Gjinia			
Nivel shkollor	Gjithsej	Femra	Meshkuj
Klasa VI	60	31	29
Klasa VII	60	29	31
	120		

Tabela 1. Shpërndarja e mostrës sipas nivelit shkollor dhe gjinisë.

Nivel shkollor	Gjithsej	Mosha
Klasa VI	60	11-12
Klasa VII	60	12-13
	120	

Tabela 2. Shpërndarja e mostrës sipas nivelit shkollor dhe moshës

III.6 Instrumentet

Në këtë hulumtim është përzgjedhur metodologjia e hulumtimit sasior, si dhe për mbledhjen e të dhënave sasiore, u shfrytëzuan pyetësorët. Me anë të pyetësorit nxënësit na ofruan të dhëna se si e

shohin ata poezinë, sa e kuptojnë dhe sa e ndiejnë atë, gjithashtu edhe mësimdhënësit me anë të pyetësorit të realizuar me ta na dhanë informacionet mbi përfaqësimin e poezisë në tekste shkollore, perceptimin e saj nga nxënësit, si dhe metodat më efektive për shpjegimin e poezisë para tyre.

IV. ANALIZA E TË DHËNAVE DHE REZULTATET

Të dhënat e marra në lidhje me pyetjet kërkimore u analizuan duke përdorur programin metoda statistikore dhe analitike. Ky kapitull ka të bëjë me prezantimin e rezultateve nga analiza e të dhënave. Rezultatet paraqiten në tabela dhe grafikë sipas pyetjeve dhe hipotezave të hulumtimit që drejtuan studimin.




Figura 1. A ju pëlqen poezia

Shohim se nga 120 pjesëmarrës në pyetësor, 60 janë të klasës së gjashtë dhe 60 të tjerë janë të klasës së shtatë. Në pyetjen e parë se a ju pëlqen poezia, nga gjithsej 60 nxënës të klasës së gjashtë, 73.33% kanë deklaruar se e pëlqejnë poezinë, 18.33% nuk e pëlqejnë dhe 8.33% kanë zgjedhur opsionin *nuk e di*. Ndërsa, nga gjithsej 60 nxënës të klasës së shtatë në të njëjtën pyetje, 81.67% kanë thënë se u pëlqen poezia, dhe 18.33% kanë thënë se nuk u pëlqen poezia. Shohim se në të dy nivelet, nxënësit në përqindje të lartë e pëlqejnë këtë krijimtari, andaj përfshirja e kësaj krijimtarie poetike në tekstet shkollore është e rëndësishë së veçantë.




Figura 2. A mësoni shpesh poezi në shkollë

Në pyetjen e dytë a mësoni shpesh poezi në shkollë, rezultatet e fituara në grafikët e klasës së gjashtë tregojnë se nga gjithsej 60 nxënës, 46.67% prej tyre janë përgjigjur *rrallë*, 6.67% e nxënësve janë përgjigjur *asnjëherë*, 36.67% janë përgjigjur *ndonjëherë* dhe 10.00% e nxënësve janë përgjigjur *shpesh*. Shohim se në përqindjen më të madhe janë opsionet *rrallë* dhe *ndonjëherë* që pasqyrojnë saktë përfaqësimin e paktë të poezisë në tekste shkollore. Rezultatet e fituara në grafikët e klasës së shtatë në pyetjen e njëjtë tregojnë se 56.67% e nxënësve janë përgjigjur *rrallë*, 18.33% *asnjëherë*, 23.33% e tyre thonë *ndonjëherë* dhe 1.67% thonë se mësojnë *shpesh* poezi në shkollë. 56.67% (*rrallë*) është treguesi i saktë për mospërfshirjen e poezive në tekstet shkollore të shkollës së tretë, klasa e shtatë.




Figura 3. A mësoni poezi përmendsh në shkollë

Në pyetjen e tretë se a mësoni poezi përmendsh, nga gjithsej 60 nxënës të klasës së gjashtë, 53.33% janë përgjigjur *rrallë*, 23.33% kanë thënë se *asnjëherë* nuk mësojnë poezi përmendsh, 20.00% kanë thënë *ndonjëherë* dhe 3.33% theksojnë se *shpesh* mësojnë poezi përmendsh. Për të njëjtën pyetje nga gjithsej 60 nxënës të klasës së shtatë kemi fituar këto rezultate: 55.00% e nxënësve tregojnë se *rrallë* mësojnë poezi përmendsh, 21.67% janë përgjigjur *asnjëherë*, 20.00% *ndonjëherë* dhe 3.33% e tyre kanë thënë *shpesh*.




Figura 4. A i kuptoni poezitë që i mësoni në shkollë

Në pyetjen e katërt se a i kuptoni poezitë që i mësoni në shkollë, nga gjithsej 60 nxënës të klasës së gjashtë, 18.33% e tyre kanë thënë *rrallë*, 10.00% e nxënësve kanë thënë *asnjëherë*, 46.67% janë përgjigjur *ndonjëherë*, 21.67% theksojnë se i kuptojnë ato *shpesh*, ndërsa 3.33% *shumë shpesh*.

Në përqindjen më të madhe kemi grafikun e përgjigjes *ndonjëherë* me 46.67%, që i bie se poezitë që mësohen në klasën e gjashtë jo gjithnjë janë të kuptueshme për nxënësit. Rezultatet e fituara nga grafikët e klasës së shtatë në të njëjtën pyetje janë këto: nga 60 nxënës gjithsej, 36.67% thonë se *rrallë* i kuptojnë poezitë që i mësojnë në shkollë, 18.33% e tyre janë përgjigjur *asnjëherë*, 21.67% *ndonjëherë* dhe 18.33% *shpesh*. Nga kjo arrijmë në përfundim se poezitë e përfshira në tekstet shkollore të klasës së shtatë në përqindje të lartë janë të pakuptueshme nga ana e nxënësve.




Figura 5: A i komentoni poezitë që i mësoni në shkollë

Në pyetjen e pestë a i komentoni poezitë që i mësoni në shkollë, nga gjithsej 60 nxënës të klasës së gjashtë, 20.00% janë përgjigjur *rrallë*, 8.33% e tyre kanë thënë *asnjëherë*, 15.00% janë përgjigjur *ndonjëherë*, 46.67% *shpesh*, ndërsa 10.00% *shumë shpesh*. Në të njëjtën pyetje, nga klasa e shtatë, gjithsej 60 nxënës janë përgjigjur si më poshtë: 15.00% kanë thënë *rrallë* i komentojnë poezitë, 13.33% nga ata janë përgjigjur *asnjëherë*, 23.33% kanë thënë *ndonjëherë*, 38.33% theksojnë se *shpesh* i komentojnë poezitë që i mësojnë dhe 10.00% kanë thënë se i komentojnë *shumë shpesh*. Rezultatet e fituara në grafikët e të dy klasave tregojnë se nxënësit në përqindjen më të lartë kanë thënë *shpesh* i komentojnë poezitë e mësuara në shkollë.




Figura 6: A ju duken interesante poezitë që i mësoni në shkollë

Në pyetjen e gjashtë a ju duken interesante poezitë që i mësoni në shkollë, nga gjithsej 60 nxënës të klasës së gjashtë, 41.67% e tyre kanë thënë po, 46.67% e tyre kanë thënë *jo* dhe 11.67% janë përgjigjur në opsionin *nuk e di*. 60 nxënësit e klasës së shtatë në pyetjen e njëjtë janë përgjigjur si në vijim: 35.00% kanë thënë se poezitë që i mësojnë në shkollë u duken *interesante*, 51.67% kanë thënë që poezitë nuk u duken interesante dhe 13.33% e tyre janë përgjigjur në opsionin *nuk e di*. Nga rezultatet e grafikëve për të dy nivelet shohim se në përqindjen më të madhe poezitë nuk u duken interesante nxënësve të klasës së gjashtë e, në veçanti, atyre të klasës së shtatë.




Figura 7. A e dini ndonjë poezi që e keni mësuar në shkollë

Në pyetjen e shtatë a e dini ndonjë poezi që e keni mësuar në shkollë, nga 60 nxënës të klasës së gjashtë, kemi fituar këto rezultate: 50.00% e nxënësve kanë thënë *po*, 38.33% e tyre kanë thënë *jo*,

dhe 11.67% nga ta janë përgjigjur në opsionin *nuk e di*. Nga rezultatet e fituara në grafikët e klasës së shtatë, shohim se nga gjithsej 60 nxënës, 43.33% e tyre e dinë ndonjë poezi që e kanë mësuar në shkollë, 35.00% nuk e dinë dhe 21.67% e tyre janë përgjigjur në opsionin *nuk e di*. Nga kjo pyetje hulumtuese dhe nga rezultatet e fituara kuptojmë se nxënësit e duan poezinë dhe e mësojnë atë me dëshirë, ani se e mësojnë rrallë në shkollë.




Figura 8. A ju pëlqejnë më shumë poezitë nga shkrimtarët shqiptarë apo të huaj

Në pyetjen e tetë a ju pëlqejnë më shumë poezitë e shkruara nga shkrimtarët shqiptarë apo të huaj., nga 60 nxënës të klasës së gjashtë, 78.33% kanë thënë se u pëlqejnë nga shkrimtarët shqiptarë, ndërsa 21.67% e pëlqejnë poezinë e shkruar nga shkrimtarët e huaj. Përqindje më të lartë të shkrimtarëve shqiptarë kemi fituar edhe nga rezultatet e nxënësve të klasës së shtatë, nga gjithsej 60 nxënës të këtij niveli, 80.00% kanë thënë se e pëlqejnë poezinë e shkruar nga shqiptarët dhe 20.00% e tyre kanë thënë se e pëlqejnë poezinë e shkruar nga të huajt.

Nga këto rezultate vërtetojmë edhe një dobësi të teksteve shkollore për shkallën e tretë të përcaktuara me kurrikulë, të cilat në përqindje të madhe përmbajnë poezi të shkruara nga shkrimtarët e huaj, sidomos te klasa e gjashtë.




Figura 9. A i recitoni poezitë që i mësoni në shkollë, në klasë dhe programe shkollore

Në pyetjen e nëntë a i recitoni poezitë që i mësoni në shkollë dhe në programe, nga 60 nxënës të klasës së gjashtë, 45.00% janë përgjigjur *rrallë*, 25.00% *asnjëherë*, 15.00% e tyre kanë thënë *ndonjëherë*, 11.67% *shpesh* dhe 3.33% *shumë shpesh*. Nga 60 nxënës të klasës së shtatë, në pyetjen e njëjtë kemi fituar këto rezultate: 45.00% e tyre kanë thënë *rrallë* i recitojmë poezitë, 25.00% *asnjëherë*, 25.00% *ndonjëherë* dhe 5.00% kanë thënë *shpesh*.




Figura 10. A i njihni figurat stilistike

Te pyetja e dhjetë a e dini ndonjë figurë stilistike, në grafikun e klasës së gjashtë, nga 60 nxënës në total, 28.33% e tyre kanë thënë *po*, 56.67% kanë thënë *jo*, ndërsa 15.00% kanë shtypur opsionin *nuk e di*. Nga gjithsej 60 nxënës të klasës së shtatë në pyetjen e njëjtë kemi fituar këto rezultate: 50.00% e nxënësve kanë thënë *po*, 35.00% e tyre kanë thënë *jo*, dhe 15.00% janë përgjigjur *nuk e*

di. Nga rezultatet e fituara kuptojmë se nxënësit e klasës së gjashtë në përqindjen më të madhe nuk i njohin figurat stilistike, ndërsa nxënësit e klasës së shtatë në përqindjen më të madhe i njohin ato.

Statistikat përshkruese të pyetësorit për mësimdhënës të klasës VI

Ne hulumtimin tonë kanë marrë pjesë edhe 15 mësimdhënës të katër shkollave të qytetit të Mitrovicës. Shtatë për klasën e VI dhe tetë për klasën e VII. Më poshtë, do të shihni të dhënat të cilat i kemi fituar nga realizimi i pyetësorëve nga mësimdhënësit.

Klasa VI	“Abdullah Shabani”		“Ismail Qemali”		“Musa Hoti”		“A. Z. Çajupi”	
	Fr.	%	Fr.	%	Fr.	%	Fr.	%
Sa është e përfaqësuar, poezia në tekstet shkollore të shkallës së tretë të kurrikulës?								
• Pak	0	100%	1	50%	0	0	1	50%
• Aspak	0		1	50%	0	0	1	50%
• Mesatari sht	2		0	0	1	100%	0	0
• Shumë	0		0	0	0	0	0	0

Tabela 3. Sa është e përfaqësuar, poezia në tekstet shkollore të shkallës së tretë të kurrikulës

Sa është e përfaqësuar, poezia në tekstet shkollore të shkallës së tretë të kurrikulës. Në pyetjen e parë sa është e përfaqësuar poezia në tekstet shkollore të shkallës së tretë, nga gjithsej shtatë mësimdhënës të klasës së gjashtë, kemi fituar këto rezultate: Dy mësimdhënësit nga ShFMU “Abdullah Shabani” janë përgjigjur 100% *mesatarisht*, dy mësimdhënësit e ShFMU “Ismail Qemali” janë përgjigjur 50% *pak* dhe 50% *aspak*, një mësimdhënës i ShFMU “Musa Hoti” ka thënë se poezia nuk përfaqësohet *aspak* 100% dhe dy mësimdhënës nga ShFMU “A. Z. Çajupi” kanë thënë 50% *pak* dhe 50% *aspak*. Nga përgjigjet arrijmë në përfundim se mësimdhënësit e tri shkollave nuk janë *aspak* të kënaqur me përfaqësimin e poezisë në tekstet shkollore (gjuhë shqipe) të klasës së gjashtë, ndërsa mësimdhënësit e ShFMU “Abdullah Shabani” mendojnë se poezia në këtë nivel është e përfaqësuar *mesatarisht*.

Klasa VI	“Abdullah Shabani”		“Ismail Qemali”		“Musa Hoti”		“A. Z. Çajupi”	
	Sa jeni të kënaqur me përzgjedhjen e poezive në tekstet shkollore të shkallës së tretë?							
• Pak	1	50%	1	50%	1	100%	0	0
• Aspak	0	0	0	0	0	0	1	50%
• Mesatarisht	1	50%	1	50%	0	0	1	50%
• Shumë	0	0	0	0	0	0	0	0

Tabela 4. Sa jeni të kënaqur me përzgjedhjen e poezive në tekstet shkollore të shkallës së tretë

Në pyetjen e dytë sa jeni të kënaqur me përzgjedhjen e poezive në tekstet shkollore të shkallës së tretë, nga gjithsej gjashtë mësimdhënës të klasës së gjashtë, kemi fituar këto rezultate: Dy mësimdhënësit nga ShFMU “Abdullah Shabani” janë përgjigjur 50% *pak* dhe 50 % *mesatarisht*, dy mësimdhënësit e ShFMU ” Ismail Qemali” janë përgjigjur 50% *pak* dhe 50% *mesatarisht*, një mësimdhënës i ShFMU “Musa Hoti” ka thënë se është i kënaqur *pak* 100% dhe dy mësimdhënës nga ShFMU “A. Z. Çajupi” kanë thënë se nuk janë *aspak* të kënaqur 50% dhe janë *mesatarisht* të kënaqur 50%. Nga përgjigjet arrijmë në përfundim se mësimdhënësit e te gjitha shkollave janë *pak* dhe *mesatarisht* të kënaqur me përzgjedhjen e poezisë në tekstet shkollore (gjuhë shqipe) të klasës së gjashtë.

Klasa VI	“Abdullah Shabani”		“Ismail Qemali”		“Musa Hoti”		“A. Z. Çajupi”	
Sa janë të perceptueshme poezitë e përfshira në këto tekste?								
• Pak	1	50%	1	50%	0	0	1	50%
• Aspak	1	50%	0	0	1	100%	0	0
• Mesatarisht	0	0	1	50%	0	0	1	50%
• Shumë	0	0	0	0	0	0	0	0

Tabela 5. Sa janë të perceptueshme poezitë e përfshira në këto tekste?

Në pyetjen e tretë sa janë të perceptueshme poezitë e përfshira në tekstet shkollore të shkallës së tretë, nga gjithsej shtatë mësime të klasës së gjashtë, kemi fituar këto rezultate: Dy mësime nga ShFMU “Abdullah Shabani” janë përgjigjur 50% *pak* dhe 50% *aspak*, dy mësime të ShFMU “Ismail Qemali” janë përgjigjur 50% *pak* dhe 50% *mesatarisht*, një mësime të ShFMU “Musa Hoti” ka thënë se poezia e përfshirë në këto tekste shkollore nuk është aspak e perceptueshme 100% dhe dy mësime nga ShFMU “A. Z. Çajupi” kanë thënë 50% *pak* dhe 50% *mesatarisht*. Nga rezultatet e fituara shohim se mësime të ShFMU “Ismail Qemali” dhe ShFMU “A. Z. Çajupi” mendojnë se poezitë e përfshira në këto tekste janë *pak* dhe *mesatarisht* të perceptueshme, ndërsa ata të ShFMU “Abdullah Shabani” dhe ShFMU “Musa Hoti” theksojnë se këto poezi janë *pak* dhe *aspak* të perceptueshme.

Klasa VI	“Abdullah Shabani”		“Ismail Qemali”		“Musa Hoti”		“A. Z. Çajupi”	
Sa e kanë plotësuar kriterin e përzgjedhjes poezitë në tekstet shkollore të shkallës së tretë?								
• Pak	1	50%	1	50%	0	0	0	0
• Aspak	0	0	0	0	0	0	1	50%
• Mesatarisht	1	50%	1	50%	1	100%	1	50%
• Shumë	0	0	0	0	0	0	0	0

Tabela 6. Sa e kanë plotësuar kriterin e përzgjedhjes, poezitë në tekstet shkollore të shkallës së tretë

Në pyetjen e katërt sa e kanë plotësuar kriterin e përzgjedhjes poezitë e përfshira në tekstet shkollore të shkallës së tretë, nga gjithsej shtatë mësimdhënës të klasës së gjashtë kemi fituar këto rezultate: Dy mësimdhënësit nga ShFMU “ Abdullah Shabani” janë përgjigjur 50% *pak* dhe 50% *mesatarisht*, dy mësimdhënësit e ShFMU” Ismail Qemali” janë përgjigjur 50% *pak* dhe 50% *mesatarisht*, një mësimdhënës i ShFMU “Musa Hoti” ka thënë se poezia e përfshirë në këto tekste shkollore i plotëson kriteret e përzgjedhjes *mesatarisht* 100% dhe dy mësimdhënës nga ShFMU “A. Z. Çajupi” kanë thënë 50% *aspak* dhe 50% *mesatarisht*. Nga rezultatet e fituara shohim se mësimdhënësit e ShFMU “Abdullah Shabani”, ShFMU “Ismail Qemali” dhe ShFMU “Musa Hoti” mendojnë se poezitë e përfshira në këto tekste i kanë plotësuar kriteret e përzgjedhjes pak dhe mesatarisht, ndërsa ata të ShFMU “A. Z. Çajupi” theksojnë se këto poezi s’e plotësojnë kriterin e përzgjedhjes *aspak* dhe *mesatarisht*.

Klasa VI	“Abdullah Shabani”		“Ismail Qemali”		“Musa Hoti”		“A. Z. Çajupi”	
Sa e ndiejnë nxënësit poezinë gjatë interpretimit?								
• Pak	0	0	1	50%	0	0	1	50%
• Aspak	0	0	0	0	0	0	1	50%
• Mesatarisht	2	100%	1	50%	1	100%	0	0
• Shumë	0	0	0	0	0	0	0	0

Tabela 7. Sa e ndiejnë nxënësit poezinë gjatë interpretimit

Në pyetjen e pestë sa e ndiejnë nxënësit poezinë, që mësohet në tekstet shkollore të shkallës së tretë, nga gjithsej shtatë mësimdhënës të klasës së gjashtë, kemi fituar këto rezultate: Dy mësimdhënësit nga ShFMU “Abdullah Shabani” janë përgjigjur 100% *mesatarisht*, dy mësimdhënësit e ShFMU “Ismail Qemali” janë përgjigjur 50% *pak* dhe 50% *mesatarisht*, një mësimdhënës i ShFMU “Musa Hoti” ka thënë se poezia e përfshirë në këto tekste shkollore ndihet *mesatarisht* 100% nga nxënësit dhe dy mësimdhënës nga ShFMU “A. Z. Çajupi” kanë thënë se nxënësit e ndiejnë poezinë 50% *pak* dhe 50% *aspak*. Nga rezultatet e fituara shohim se mësimdhënësit e ShFMU “Abdullah Shabani”, ShFMU “Ismail Qemali” dhe ShFMU “Musa Hoti” mendojnë se poezitë e përfshira në këto tekste ndihen nga nxënësit *pak* ose *mesatarisht*, ndërsa ata të ShFMU “A. Z. Çajupi” theksojnë se këto poezi ndihen *pak* ose *aspak* nga nxënësit

Klasa VI	“Abdullah Shabani”		“Ismail Qemali”		“Musa Hoti”		“A. Z. Çajupi”	
Sa janë të përshtatshme me moshën e nxënësve poezitë e përzgjedhura në shkallën e tretë të kurrikulës?								
• Pak	1	50%	0	0	0	0	1	50%
• Aspak	0	0	1	50%	0	0	0	0
• Mesatarisht	1	50%	1	50%	1	100%	1	50%
• Shumë	0	0	0	0	0	0	0	0

Tabela 8. Sa janë të përshtatshme me moshën e nxënësve poezitë e përzgjedhura në shkallën e tretë të kurrikulës

Në pyetjen e gjashtë sa janë të përshtatshme me moshën e nxënësve poezitë e përzgjedhura në tekstet shkollore të shkallës së tretë të kurrikulës, nga gjithsej shtatë mësimdhënës të klasës së gjashtë, kemi fituar këto rezultate: Dy mësimdhënësit nga ShFMU “Abdullah Shabani” janë përgjigjur 50% *pak* dhe 50% *mesatarisht*, dy mësimdhënësit e ShFMU ” Ismail Qemali” janë përgjigjur 50% *aspak* dhe 50% *mesatarisht*, një mësimdhënës i ShFMU “ Musa Hoti” ka thënë se poezia e përfshirë në këto tekste shkollore është e përshtatshme me moshën e nxënësve 100% *mesatarisht* dhe dy mësimdhënës nga ShFMU “A. Z. Çajupi” kanë thënë se poezitë e përzgjedhura janë të përshtatshme me moshën e nxënësve *pak* 50% dhe *mesatarisht* 50%. Nga rezultatet e fituara shohim se mësimdhënësit e ShFMU“ Abdullah Shabani” , “Musa Hoti” dhe “ A. Z. Çajupi” mendojnë se poezitë janë të përshtatshme me moshën e nxënësve *pak* ose *mesatarisht*, ndërsa mësimdhënësit e ShFMU “ Ismail Qemali” theksojnë se poezitë nuk janë *aspak* ose *mesatarisht* të përshtatshme me moshën e nxënësve.

Klasa VI	“Abdullah Shabani”		“Ismail Qemali”		“Musa Hoti”		“A. Z. Çajupi”	
	Me cilat metoda e shpjegoni poezinë para nxënësve?							
<ul style="list-style-type: none"> • Shpjegim të koncepteve dhe analizë 	0	0	1	50%	0	0	1	50%
<ul style="list-style-type: none"> • Lexim, analizë, komentim 	2	100%	1	50%	1	100%	1	50%

Tabela 9. Me cilat metoda e shpjegoni poezinë para nxënësve

Në pyetjen e shtatë me cilat metoda e shpjegoni poezinë para nxënësve, nga gjithsej shtatë mësimdhënës të klasës së gjashtë kemi fituar këto rezultate: Dy mësimdhënësit nga ShFMU

“Abdullah Shabani” janë përgjigjur 100% me metodën *lexim, analizë, komentim*, dy mësime nga ShFMU “Ismail Qemali”, janë përgjigjur 50% me metodën *shpjegim të koncepteve dhe analizë* dhe 50% me metodën *lexim, analizë, komentim*, një mësime nga ShFMU “Musa Hoti” ka thënë se e shpjegon poezinë 100% me metodën *lexim, analizë, komentim*, dhe dy mësime nga ShFMU “A. Z. Çajupi” kanë thënë se e shpjegojnë poezinë 50% me metodën *shpjegim të koncepteve dhe analizë*, si dhe 50 % *lexim, analizë dhe komentim*. Nga rezultatet e fituara shohim se mësime të ShFMU “Abdullah Shabani” dhe ShFMU “Musa Hoti” e shpjegojnë poezinë para nxënësve 100% me metodën *lexim, analizë, komentim*, ndërsa mësime të shkollave “Ismail Qemali” dhe “A. Z.Çajupi” theksojnë se e shpjegojnë poezinë me të dyja metodat, 50% *shpjegim të koncepteve dhe analizë*, si dhe 50% *lexim, analizë, komentim*.

Klasa VI	“Abdullah Shabani”		“Ismail Qemali”		“Musa Hoti”		“A. Z. Çajupi”	
Sa janë të vështira për t’u analizuar poezitë e përzgjedhura në tekstet shkollore të shkallës së tretë?								
• Pak	0	0	0	0	0	0	1	50%
• Aspak	1	50%	0	0	0	0	0	0
• Mesatarisht	1	50%	1	50%	1	100%	0	0
• Shumë	0	0	1	50%	0	0	1	50%

Tabela 10. Sa janë të vështira për t’u analizuar poezitë e përzgjedhura në tekstet shkollore të shkallës së tretë

Në pyetjen e tetë sa janë të vështira për t’u analizuar poezitë e përzgjedhura në tekstet shkollore të shkallës së tretë nga nxënësit, nga gjithsej shtatë mësimdhënës të klasës së gjashtë, kemi fituar këto rezultate: Dy mësimdhënës nga ShFMU “Abdullah Shabani” janë përgjigjur 50% *aspak* dhe 50% *mesatarisht*, dy mësimdhënës nga ShFMU “Ismail Qemali” janë përgjigjur 50% *mesatarisht* dhe 50% *shumë* të vështira për t’u analizuar, një mësimdhënës nga ShFMU “Musa Hoti” ka thënë se poezitë e përzgjedhura për klasën e gjashtë janë të vështira për t’u analizuar 100% *mesatarisht* dhe dy mësimdhënës nga ShFMU “A. Z. Çajupi” theksojnë se 50% janë *pak* të vështira dhe 50% *shumë* të vështira për t’u analizuar nga nxënësit e këtij niveli shkollor. Nga rezultatet e fituara shohim se mësimdhënësit e ShFMU “Abdullah Shabani”, “Ismail Qemali” dhe “Musa Hoti” mendojnë se poezitë e përzgjedhura për klasën e gjashtë janë të vështira për t’u analizuar *mesatarisht*, ndërsa ata të ShFMU “A. Z. Çajupi” theksojnë se këto poezi janë *pak* dhe *shumë* të vështira.

Klasa VI	“Abdullah Shabani”		“Ismail Qemali”		“Musa Hoti”		“A. Z. Çajupi”	
Ju si mësimdhënës gjatë shpjegimit të poezisë, sa shpesh ofroni të dhëna të tjera që nuk ofrohen në libër?								
• Pak	0	0	0	0	0	0	0	0
• Aspak	0	0	0	0	0	0	0	0
• Mesatarisht	1	50%	0	0	0	0	2	100%
• Shumë	1	50%	2	100%	1	100%	0	0

Tabela 11. Ju si mësimdhënës gjatë shpjegimit të poezisë, sa shpesh ofroni të dhëna të tjera që nuk ofrohen në libër

Në pyetjen e nëntë ju si mësimdhënës gjatë shpjegimit të poezisë sa shpesh ofroni të dhëna të tjera që nuk ofrohen në libër, nga gjithsej shtatë mësimdhënës të klasës së gjashtë, kemi fituar këto rezultate: Dy mësimdhënësit nga ShFMU “Abdullah Shabani” janë përgjigjur 50% *mesatarisht* dhe 50% *shumë*, dy mësimdhënësit nga ShFMU “Ismail Qemali” janë përgjigjur 100% *shumë*, një mësimdhënës nga ShFMU “Musa Hoti” ka thënë gjatë shpjegimit të poezisë, përveç të dhënave që ofrohen në libër ofroj të dhëna të tjera 100% *shumë* dhe dy mësimdhënësit nga ShFMU “A. Z. Çajupi” theksojnë se ofrojnë të dhëna shtesë 100% *mesatarisht*. Nga rezultatet e fituara shohim se mësimdhënësit e të gjitha shkollave ofrojnë informata shtesë, *mesatarisht* ose *shumë*.

Klasa VI	“Abdullah Shabani”		“Ismail Qemali”		“Musa Hoti”		“A. Z. Çajupi”	
A janë të përfshira të gjitha llojet e poezive në tekstet shkollore?								
• Po	0	0	0	0	0	0	0	0
• Jo	2	100%	2	100%	1	100%	2	100%
• S’di	0	0	0	0	0	0	0	0

Tabela 12. A janë të përfshira të gjitha llojet e poezive në tekstet shkollore

Në pyetjen e dhjetë a janë të përfshira të gjitha llojet e poezive në tekstet shkollore, nga gjithsej shtatë mësimdhënës të klasës së gjashtë, kemi fituar këto rezultate: Dy mësimdhënësit nga ShFMU “Abdullah Shabani” janë përgjigjur 100% *jo*, dy mësimdhënësit nga ShFMU “Ismail Qemali” janë përgjigjur 100% *jo*, një mësimdhënës nga ShFMU “Musa Hoti” ka thënë 100% *jo* nuk janë përfshirë të gjitha llojet e poezive në tekstet shkollore dhe dy mësimdhënësit nga ShFMU “A. Z. Çajupi” theksojnë gjithashtu 100% *jo* për përfshirjen e të gjitha llojeve të poezisë në librat e klasës së gjashtë, gjuhë shqipe. Nga rezultatet e fituara shohim se mësimdhënësit e të gjitha shkollave thonë se nuk janë përfshirë të gjitha llojet e poezive në librat shkollore.

Statistikat përshkruese të pyetësorit për mësimdhënës të klasës VII

Klasa VII	“Abdullah Shabani”		“Ismail Qemali”		“Musa Hoti”		“A. Z. Çajupi”	
	Fr.	%	Fr.	%	Fr.	%	Fr.	%
Sa është e përfaqësuar poezia në tekstet shkollore të shkallës së tretë?				50				
• Pak	0		1	50	0	0	0	0
• Aspak	3	100	1	%	0	100	1	50%
• Mesatarisht	0	%	0	0	1	%	1	50%
• Shumë	0		0	0	0	0	0	0

Tabela 13. Sa është e përfaqësuar poezia në tekstet shkollore të shkallës së tretë

Në pyetjen e parë sa është e përfaqësuar poezia në tekstet shkollore të shkallës së tretë nga gjithsej tetë mësimdhënës të klasës së shtatë kemi fituar këto rezultate: Tre mësimdhënësit nga ShFMU “Abdullah Shabani” janë përgjigjur 100% *aspak*, dy mësimdhënësit nga ShFMU “Ismail Qemali” janë përgjigjur 50% *pak* dhe 50% *aspak* një mësimdhënës nga ShFMU “Musa Hoti” ka thënë 100% *mesatarisht* dhe dy mësimdhënësit nga ShFMU “A. Z. Çajupi” theksojnë 50% *aspak* dhe 50% *mesatarisht* është përfaqësuar poezia në këto tekste. Nga rezultatet e fituara shohim se mësimdhënësit e të tri shkollave, “Abdullah Shabani”, “Ismail Qemali” dhe njëri mësimdhënës nga ShFMU “A. Z. Çajupi” nuk janë të kënaqur me përfaqësimin e poezisë në tekstet shkollore të shkallës së tretë, ndërsa mësimdhënësi ShFMU “Musa Hoti” dhe njëri mësimdhënës i ShFMU “A. Z. Çajupi” kanë thënë se poezia përfaqësohet në tekste shkollore *mesatarisht*.

Tabela 14. Sa jeni të kënaqur me përzgjedhjen e poezive në tekstet shkollore të shkallës së tretë

Klasa VII	“Abdullah Shabani”		“Ismail Qemali”		“Musa Hoti”		“A. Z. Çajupi”	
	Fr.	%	Fr.	%	Fr.	%	Fr.	%
Sa jeni të kënaqur me përzgjedhjen e poezive në tekstet shkollore të shkallës së tretë?								
• Pak	0	0	1	50%	0	0	0	0
• Aspak	3	100%	1	50%	1	100%	1	50%
• Mesatarisht	0	0	0	0	0	0	0	0
• Shumë	0	0	0	0	0	0	1	50%

Në pyetjen e dytë sa jeni të kënaqur me përzgjedhjen e poezive në tekstet shkollore të shkallës së tretë të kurrikulës, nga gjithsej tetë mësimdhënës të klasës së shtatë, kemi fituar këto rezultate: Tre mësimdhënësit nga ShFMU “Abdullah Shabani” janë përgjigjur 100% *aspak*, dy mësimdhënësit nga ShFMU “Ismail Qemali” janë përgjigjur 50% *pak* dhe 50% *aspak* një mësimdhënës nga ShFMU “Musa Hoti” ka thënë 100% *aspak* dhe dy mësimdhënësit nga ShFMU “A. Z. Çajupi” theksojnë 50% *aspak* dhe 50% *shumë* të kënaqur me përzgjedhjen e poezive në këtë nivel shkollor. Nga rezultatet e fituara shohim se mësimdhënësit e të tri shkollave, “Abdullah Shabani”, “Ismail Qemali”, “Musa Hoti” dhe njëri mësimdhënës nga ShFMU “A. Z. Çajupi” nuk janë të kënaqur me përzgjedhjen e poezisë në tekstet shkollore të shkallës së tretë, ndërsa njëri mësimdhënës i ShFMU “A. Z. Çajupi” është përgjigjur se është *shumë* i kënaqur me këtë përzgjedhje.

Klasa VII	“Abdullah Shabani”		“Ismail Qemali”		“Musa Hoti”		“A. Z. Çajupi”	
	Fr.	%	Fr.	%	Fr.	%	Fr.	%
Sa janë të perceptueshme poezitë e përfshira në këto tekste?								
• Pak	1	33%	0	0	0	0	0	0
• Aspak	2	67%	2	100%	1	100%	1	50%
• Mesatarisht	0	0	0	0	0	0	1	50%
• Shumë	0	0	0	0	0	0	0	0

Tabela 15. Sa janë të perceptueshme poezitë e përfshira në këto tekste

Në pyetjen e tretë sa janë të perceptueshme nga nxënësit poezitë e përfshira në tekstet shkollore të shkallës së tretë, nga gjithsej tetë mësimdhënës të klasës së shtatë, kemi fituar këto rezultate: Tre mësimdhënësit nga ShFMU “ Abdullah Shabani” janë përgjigjur 33% *pak* dhe 67% *aspak*, dy mësimdhënësit nga ShFMU “ Ismail Qemali” janë përgjigjur 100 % *aspak*, një mësimdhënës nga ShFMU “Musa Hoti” ka thënë 100% *aspak* dhe dy mësimdhënësit nga ShFMU “ A. Z. Çajupi” theksojnë 50% *aspak* dhe 50% *mesatarisht* poezitë janë të perceptueshme në këto tekste. Nga rezultatet e fituara shohim se mësimdhënësit e të katër shkollave, “Abdullah Shabani”, “ Ismail Qemali” , “Musa Hoti” dhe njëri mësimdhënës nga ShFMU “ A. Z. Çajupi” mendojnë se poezitë e përfshira në tekstet shkollore nuk janë të perceptueshme, ndërsa njëri nga mësimdhënësit e ShFMU “ A. Z. Çajupi” ka thënë poezitë janë të perceptueshme nga nxënësit *mesatarisht*

Klasa VII	“Abdullah Shabani”		“Ismail Qemali”		“Musa Hoti”		“A. Z. Çajupi”	
	Fr.	%	Fr.	%	Fr.	%	Fr.	%
Sa e kanë plotësuar kriterin e përzgjedhjes poezitë në tekstet shkollore të shkallës së tretë?								
• Pak	0	0	0	0	0	0	0	0
• Aspak	3	100%	2	100%	1	100%	1	50%
• Mesatarisht	0	0	0	0	0	0	0	0
• Shumë	0	0	0	0	0	0	1	50%

Tabela 16. Sa e kanë plotësuar kriterin e përzgjedhjes poezitë në tekstet shkollore të shkallës së tretë

Në pyetjen e katërt sa e kanë plotësuar kriterin e përzgjedhjes poezitë e përfshira në tekstet shkollore të shkallës së tretë, nga gjithsej tetë mësimdhënës të klasës së shtatë, kemi fituar këto rezultate: Tre mësimdhënësit nga ShFMU “Abdullah Shabani” janë përgjigjur *aspak* 100% dy mësimdhënësit e ShFMU “Ismail Qemali” janë përgjigjur *aspak* 100%, një mësimdhënës i ShFMU “Musa Hoti” ka thënë se poezitë e përfshira në këto tekste shkollore nuk i plotësojnë kriteret e përzgjedhjes *aspak* 100% dhe dy mësimdhënës nga ShFMU “A. Z. Çajupi” kanë thënë 50% *aspak* dhe 50% *shumë*. Nga rezultatet e fituara shohim se mësimdhënësit e të katër shkollave ShFMU “Abdullah Shabani”, “Ismail Qemali”, “Musa Hoti” dhe njëri mësimdhënës nga shkolla fillore “A. Z. Çajupi” mendojnë se poezitë e përfshira në këto tekste nuk i kanë plotësuar kriteret e përzgjedhjes, ndërsa njëri mësimdhënës nga “A. Z. Çajupi” thekson se këto poezi e plotësojnë kriterin e përzgjedhjes *shumë*.

Klasa VII	“Abdullah Shabani”		“Ismail Qemali”		“Musa Hoti”		“A. Z. Çajupi”	
	Fr.	%	Fr.	%	Fr.	%	Fr.	%
Sa e ndiejnë nxënësit poezinë gjatë interpretimit?								
• Pak	0	0	0	0	1	100%	0	0
• Aspak	3	100%	2	100%	0	0	1	50%
• Mesatarisht	0	0	0	0	0	0	0	0
• Shumë	0	0	0	0	0	0	1	50%

Tabela 17. Sa e ndiejnë nxënësit poezinë gjatë interpretimit

Në pyetjen e pestë sa e ndiejnë nxënësit poezinë që mësohet në tekstet shkollore të shkallës së tretë, nga gjithsej tetë mësimdhënës të klasës së shtatë, kemi fituar këto rezultate: Tre mësimdhënës nga ShFMU “Abdullah Shabani” janë përgjigjur *aspak* 100%, dy mësimdhënës të ShFMU “Ismail Qemali” janë përgjigjur *aspak* 100%, një mësimdhënës i ShFMU “Musa Hoti” ka thënë se nxënësit e ndiejnë pak 100% poezinë që mësohet në këto tekste shkollore dhe dy mësimdhënës nga ShFMU “A. Z. Çajupi” kanë thënë nxënësit nuk e ndiejnë poezinë *aspak*, 50% dhe e ndiejnë *shumë* 50%. Nga rezultatet e fituara shohim se mësimdhënës të katër shkollave ShFMU “Abdullah Shabani”, “Ismail Qemali”, “Musa Hoti” dhe njëri mësimdhënës nga shkolla fillore “A. Z. Çajupi” mendojnë se nxënësit nuk i ndiejnë poezitë që mësohen në klasën e shtatë, ndërsa njëri mësimdhënës nga ShFMU “A. Z. Çajupi” ka thënë nxënësit e ndiejnë *shumë* poezinë e përfshirë në këto tekste.

Klasa VII	“Abdullah Shabani”		“Ismail Qemali”		“Musa Hoti”		“A.Z. Çajupi”	
	Fr.	%	Fr.	%	Fr.	%	Fr.	%
Sa janë të përshtatshme me moshën e nxënësve poezitë e përzgjedhura në shkallën e tretë të kurrikulës?								
• Pak	1	33%	0	0	0	0	0	0
• Aspak	2	67%	2	100%	1	100%	1	50%
• Mesatarisht	0	0	0	0	0	0	1	50%
• Shumë	0	0	0	0	0	0	0	0

Tabela 18. Sa janë të përshtatshme me moshën e nxënësve poezitë e përzgjedhura në shkallën e tretë të kurrikulës

Në pyetjen e gjashtë sa janë të përshtatshme me moshën e nxënësve poezitë e përzgjedhura në tekstet shkollore të shkallës së tretë të kurrikulës, nga gjithsej tetë mësimdhënës të klasës së shtatë, kemi fituar këto rezultate: Tre mësimdhënësit nga ShFMU “ Abdullah Shabani” janë përgjigjur *pak* 33% dhe *aspak* 67%, dy mësimdhënësit e ShFMU ”Ismail Qemali” janë përgjigjur *aspak* 100%, një mësimdhënës i ShFMU “Musa Hoti” ka thënë se poezitë në këtë nivel shkollor nuk janë *aspak* 100% të përshtatshme me moshën e nxënësve dhe dy mësimdhënës nga ShFMU” A. Z. Çajupi” kanë thënë se poezitë nuk janë *aspak* të përshtatshme 50% dhe janë *mesatarisht* të përshtatshme 50%. Nga rezultatet e fituara shohim se mësimdhënësit e të katër shkollave ShFMU “Abdullah Shabani”, “IsmailQemali”, “Musa Hoti” dhe njëri mësimdhënës nga shkolla fillore “A. Z. Çajupi” mendojnë se poezitë nuk janë të përshtatshme me moshën e nxënësve, ndërsa njëri mësimdhënës i ShFMU “A. Z. Çajupi” ka thënë se janë të përshtatshme *mesatarisht*.

Klasa VII	“Abdullah Shabani”		“Ismail Qemali”		“Musa Hoti”		“A. Z. Çajupi”	
	Fr.	%	Fr.	%	Fr.	%	Fr.	%
Me cilat metoda e shpjegoni poezinë para nxënësve?								
<ul style="list-style-type: none"> • Shpjegim të koncepteve dhe analizë 	0	0	0	0	1	0	0	0
<ul style="list-style-type: none"> • Lexim, analizë, komentim 	3	100%	2	100%	1	100%	2	100%

Tabela 19. Me cilat metoda e shpjegoni poezinë para nxënësve

Në pyetjen e shtatë me cilat metoda e shpjegoni poezinë para nxënësve, nga gjithsej tetë mësimdhënës të klasës së shtatë, kemi fituar këto rezultate: Tre mësimdhënësit nga ShFMU “Abdullah Shabani” janë përgjigjur me metodën *lexim, analizë, komentim* 100%, dy mësimdhënësit e ShFMU “Ismail Qemali” janë përgjigjur me metodën *lexim, analizë, komentim* 100%, një mësimdhënës i ShFMU “Musa Hoti” ka thënë se poezitë i shpjegon me metodën *lexim, analizë, komentim* 100%, si dhe dy mësimdhënësit nga ShFMU “A. Z. Çajupi” kanë thënë se e përdorin të njëjtën metodë 100%. Nga rezultatet e fituara shohim se mësimdhënësit e të katër shkollave ShFMU “Abdullah Shabani”, “Ismail Qemali”, “Musa Hoti” dhe “A. Z. Çajupi” e shpjegojnë poezinë para nxënësve me metodën *lexim, analizë dhe komentim*.

Klasa VII	“Abdullah Shabani”		“Ismail Qemali”		“Musa Hoti”		“A.Z. Çajupi”	
	Fr.	%	Fr.	%	Fr.	%	Fr.	%
Sa janë të vështira për t’u analizuar poezitë e përzgjedhura në tekstet shkollore të shkallës së tretë?								
• Pak	0	0	0	0	0	0	1	50%
• Aspak	0	0	0	0	0	0	0	0
• Mesatarisht	1	33%	0	0	1	100%	0	0
• Shumë	2	67%	2	100%	0	0	1	50%

Tabela 20. Sa janë të vështira për t’u analizuar poezitë e përzgjedhura në tekstet shkollore të shkallës së tretë

Në pyetjen e tetë sa janë të vështira për t’u analizuar poezitë e përzgjedhura në tekstet shkollore të shkallës së tretë të kurrikulës, nga gjithsej tetë mësimdhënës të klasës së shtatë, kemi fituar këto rezultate: Tre mësimdhënësit nga ShFMU “Abdullah Shabani” janë përgjigjur *mesatarisht* 33% dhe *shumë* 67%, dy mësimdhënësit e ShFMU “Ismail Qemali” janë përgjigjur *shumë* 100%, një mësimdhënës i ShFMU “Musa Hoti” ka thënë se poezitë në këtë nivel shkollore janë të vështira për t’u analizuar *mesatarisht* 100% dhe dy mësimdhënës nga ShFMU “A. Z. Çajupi” kanë thënë se poezitë janë të vështira *pak* 50% dhe janë *shumë* të vështira 50%. Nga rezultatet e fituara shohim se mësimdhënësit e të katër shkollave ShFMU “Abdullah Shabani”, “Ismail Qemali”, “Musa Hoti” dhe njëri mësimdhënës nga shkolla fillore “A. Z. Çajupi” mendojnë se poezitë janë *shumë* dhe *mesatarisht* të vështira, ndërsa njëri mësimdhënës i ShFMU “A. Z. Çajupi” ka thënë se *pak* janë të vështira për t’u analizuar.

Klasa VII	“Abdullah Shabani”		“Ismail Qemali”		“Musa Hoti”		“A.Z. Çajupi”	
	Fr.	%	Fr.	%	Fr.	%	Fr.	%
Ju si mësimdhënës gjatë shpjegimit të poezisë, sa shpesh ofroni të dhëna të tjera që nuk ofrohen në libër?								
• Pak	0	0	0	0	0	0	0	0
• Aspak	0	0	0	0	0	0	0	0
• Mesatarisht	1	33%	0	0	0	0	2	100%
• Shumë	2	67%	2	100%	1	100%	0	0

Tabela 21. Ju si mësimdhënës gjatë shpjegimit të poezisë, sa shpesh ofroni të dhëna të tjera që nuk ofrohen në libër

Në pyetjen e nëntë ju si mësimdhënës gjatë shpjegimit të poezisë sa shpesh ofroni të dhëna të tjera që nuk ofrohen në libër, nga gjithsej tetë mësimdhënës të klasës së shtatë, kemi fituar këto rezultate: Tre mësimdhënësit nga ShFMU “Abdullah Shabani” janë përgjigjur *mesatarisht*, 33% dhe *shumë* 67%, dy mësimdhënësit e ShFMU “Ismail Qemali” janë përgjigjur *shumë* 100%, një mësimdhënës i ShFMU “Musa Hoti” ka thënë se ofron të dhëna që nuk janë në libër *shumë* 100% dhe dy mësimdhënës nga ShFMU “A. Z. Çajupi” kanë thënë se ofrojnë informacione shtesë *mesatarisht* 100%. Nga rezultatet e fituara shohim se mësimdhënësit e të tri shkollave ShFMU “Abdullah Shabani”, “Ismail Qemali”, dhe “Musa Hoti” ofrojnë të dhëna shtesë shumë, ndërsa mësimdhënësit nga shkolla fillore “A. Z. Çajupi” theksojnë se ofrojnë të dhëna *mesatarisht*.

Klasa VII	“Abdullah Shabani”		“Ismail Qemali”		“Musa Hoti”		“A.Z.Çajupi”	
	Fr.	%	Fr.	%	Fr.	%	Fr.	%
A janë të përfshira të gjitha llojet e poezive në tekste shkollorë?								
• Po	0	0	0	0	0	0	1	50
• Jo	3	100	2	100	1	100	1	50
• S’di	0	0	0	0	0	0	0	0

Tabela 22. A janë të përfshira të gjitha llojet e poezive në tekste shkollorë

Në pyetjen e dhjetë a janë të përfshira të gjitha llojet e poezive në tekste shkollorë të shkallës së tretë të kurrikulës, nga gjithsej tetë mësimdhënës të klasës së shtatë, kemi fituar këto rezultate: Tre mësimdhënës nga ShFMU “Abdullah Shabani” janë përgjigjur *jo*, 100% dy mësimdhënës e ShFMU “Ismail Qemali” janë përgjigjur *jo*, 100% një mësimdhënës i ShFMU “Musa Hoti” ka thënë se nuk janë përfshirë të gjitha llojet e poezive në këtë nivel shkollor 100%, si dhe dy mësimdhënës nga ShFMU “A. Z. Çajupi” kanë thënë se janë përfshirë të gjitha llojet 50% dhe nuk janë përfshirë të gjitha llojet 50%. Nga rezultatet e fituara shohim se mësimdhënësit e të katër shkollave ShFMU “Abdullah Shabani”, “Ismail Qemali”, “Musa Hoti” dhe njëri mësimdhënës nga shkolla fillore “A. Z. Çajupi” mendojnë se nuk janë përfshirë të gjitha llojet e poezive në tekste shkollorë, ndërsa njëri mësimdhënës i ShFMU “A. Z. Çajupi” ka thënë se janë përfshirë 50%

Testimi i hipotezave

T-test				
	Mean	St. Deviation	t- value	[Sig 2-tailed]
Klasa	-.710	.412	- 1.722	.007
Shkolla	.327	.380	.861	.000
Mësimdhënësit	.016	.950	.017	.001
Constant	33.124***	3.362	9.853	.000
Numberofobservations	120			
R-squared	0.25			

Për të testuar hipotezat kemi përdorur T-testin e dyanshëm. T-testi i dyanshëm tregon se a ka dallime statistikore në mes të grupeve. Në mostrën tonë kemi katër shkolla, mësimdhënës dhe nxënës të klasave të gjashta dhe të shtata, ku, duke u bazuar në përgjigjet e tyre, shohim se nuk ka dallime statistikore në mesataret aritmetike (Sig 2-Tailed = 0.000) të të gjitha shkollat që janë të përfshira në mostër dhe gjithashtu nuk ka dallime të vlefshme statistikore në mes mësimdhënësve të këtyre shkollave (Sig 2-Tailed = 0.001). Ky rezultat na mundëson të konkludojmë se kemi

vërtetuar hipotezat tona “*Tekstet e reja shkollore për letërsinë, të miratuara më 2019 nga Ministria e Arsimit, nuk i plotësojnë kriteret e përzgjedhjes për lëndën e gjuhës shqipe dhe konkretisht për poezinë*”. Dhe, gjithashtu vërtetojmë se tekstet shkollore nuk e kanë të përfaqësuar sa duhet poezinë gjë që e vërteton hipotezën tonë të dytë që kemi ngritur duke thënë se *Tekstet shkollore për klasën e gjashtë dhe veçanërisht për klasën e shtatë as në përqindjen më të vogël nuk e kanë të përfaqësuar poezinë dhe aparaturën didaktike të të nxënimit të saj*.

IV. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Tekstet shkollore dhe, para së gjithash, formësimi didaktik i tyre, synon që nxënësit të aftësohen për të pranuar informacionet e reja, të mësojnë pa vështirësi dhe t'i kuptojnë me lehtësi përmbajtjet mësimore, por jo të gjitha tekstet i realizojnë synimet e parapara. Materialet mësimore, gjuhësore e letrare që përfshihen brenda teksteve shkollore, shpesh e vënë në pah mosrealizimin e kritereve për hartimin e këtyre teksteve. Pas një analize dhe vlerësimi të theksuar mbi tekstet shkollore të përcaktuara nga MASHT-i për shkallën e tretë të kurrikulës, një analize të hollësishme të hulumtimit të këtij punimi dhe shqyrtimit të literaturës së punimit, kemi nxjerrë disa përfundime dhe rekomandime në lidhje me hartimin e teksteve shkollore në atë mënyrë që tekstet e reja të korrigjohen e të plotësohen dhe kështu do të ofrojnë lehtësi në mësim si për nxënësit ashtu edhe për mësimdhënësit. Me anë të hulumtimit tonë kemi vënë në pah mungesën e poezive si dhe aparaturën didaktike të tyre, në tekstet shkollore të shkallës së tretë të kurrikulës (Në klasën e gjashtë poezia është përfshirë pjesërisht, ndërsa në të shtatën mungon plotësisht). Pamë se poezia - gjinia letrare më e kultivuar nuk është përfshirë sa duhet në këto tekste, gjithashtu përzgjedhja e atyre pak poezive që janë përfshirë në këtë nivel shkollor, nuk i plotëson kriteret e përzgjedhjes, përmbajtja e tyre nuk përkon me moshën e nxënësve as me zhvillimin psikik e intelektual të tyre. Rezultatet e hulumtimit tregojnë se mospërshtatja e materialit mësimor me moshën e nxënësve bën që këta të fundit të kenë shumë vështirësi për t'i kuptuar e analizuar ato. Problemet e tilla i kemi vërtetuar me anë të pyetësorëve të cilët i kemi realizuar me nxënës dhe me mësimdhënësit. Me anë të hulumtimit kemi parë edhe mospërfshirjen e të gjitha llojeve të poezive në tekstet shkollore, një problematikë e tillë ndikon negativisht te nxënësit si dhe e shton mundësinë që ata të mos i njohin llojet e poezive.

Rezultatet e hulumtimit e vërtetojnë edhe një fakt jo të mirë në lidhje me mësimin e figurave stilistike, nga rezultatet shohim se figurat letrare si element shumë i rëndësishëm në njohjen dhe deshifrimin e poezisë nuk janë shumë të njohura dhe të kuptueshme nga nxënësit e këtij niveli, që i bie se pjesa ku shpjegohen dhe paraqiten në tekste lë vend për përmirësime. Sa u përket metodave me të cilat mësimdhënësit e realizojnë mësimin dhe shpjegimin e poezive, me anë të rezultateve

të fituara shohim se metoda *lexim, analizë dhe komentim* është metoda më efikase dhe produktive. Një tjetër element i rëndësishëm që e kemi fituar gjatë përpunimit të të dhënave është fakti se nxënësit e pëlqejnë më shumë poezinë e shkruar nga shkrimtarët shqiptarë sesa nga ata të huaj, ndërsa në të dy librat, Gjuha shqipe 6 dhe 7, dominojnë poezitë e shkruara nga shkrimtarët e huaj. Meqë përmbajtja e materialit mësimor (poezitë) janë të papërshtatshme dhe vështirë të kuptueshme për nxënësit e klasës së gjashtë dhe të shtatë, rezultatet tregojnë se nxënësit nuk e ndiejnë dhe nuk e përjetojnë aspak poezinë që e mësojnë në shkollë.

Rekomandimet

- Pas analizës së hulumtimit arritëm në këto rekomandime
- Pjesës së letërsisë t'i jepet vendi i merituar në tekstet shkollore
- Materialet mësimore (poezitë) të përshtaten me moshën dhe zhvillimin psiko-fizik e intelektual të nxënësve
- Të përdoren më shumë shembuj për secilën njësi në mënyrë që nxënësit t'i kuptojnë sa më lehtë përmbajtjet
- Të mos mungojë aparatura didaktike
- Të përfshihen më shumë poezitë e shkruara nga autorët shqiptarë
- Elementet e zhanreve dhe gjinive letrare të analizohen si tërësi dhe të demonstrohen me shembuj në varësi të llojit
- Ilustrimet të jenë me përmbajtje dhe cilësi më të madhe
- Kur mësohen figurat stilistike ose elementet e tjera letrare, si: Rima, vargu, strofa, ritmi, le të përdoren shembuj me poezi në mënyrë që nxënësit t'i kenë sa më të qarta
- Tekstet shkollore të përmbajnë fjalorë, në mënyrë që nxënësit të kuptojnë më lehtë fjalët e panjohura dhe shprehjet e reja.

Bibliografia

- Selmani, Adelinë & Paçarizi, Rahman (2019). *Gjuha shqipe 7*, Pejë: “Dukagjini”.
- Aliu, Ali (1986). *Teoria e letërsisë*, Prishtinë: “Rilindja”
- Rugova, Bardh & Elezi, Shpëtim (2019). *Gjuha shqipe 6*. Pejë: “Dukagjini”.
- Azemi, Bashkim (2013). *Aparatura didaktike në tekstet shkollore*, Prishtinë: Instituti Pedagogjik i Kosovës
- Bishqemi, Astrit (2004). *Hyrje në teorinë e letërsisë për fëmijë*. Elbasan.
- Brada, Riza (2005). *Metodika e gjuhës shqipe*. Pejë.
- CDE. (2011). *Të nxënit ndërveprues - gjuhë shqipe 6-12*. Tiranë.
- Deva, Agim (1986). *Poezia shqipe për fëmijë (1872-1980)*. Prishtinë.
- Eko, U. (2006). *Si shkruhet një punim diplome*. Dituria.
- Gjokutaj, M. H. K. (2016). *Fjalor termash në edukim-shpjegues-krahasues*. Prishtinë: Dukagjini
- Gjokutaj, Mimoza (2012). *Didaktika e gjuhës shqipe*. Tiranë.
- MAShT. (2011). *Udhëzim administrativ (standarde për tekste shkollore)*. Prishtinë.
- Gjokutaj, Mimoza & Gjoshi, Ragip. (2011). *Vërejtje dhe sugjerime për rishikimin e teksteve shkollore*. Tiranë.
- Kumnova, M, Hyseni, M. (2014). *Leximi letrar 7*. Prishtinë. Libri shkollor
- Tevo, P. (2000). *Komenti letrar*. Tiranë.
- Paçarizi, Rahman (2019). *Gjuha shqipe 7. Fletore pune*. Pejë.
- Petro, Rita (2004). *Leximi letrar 6*. Tiranë.
- Rahmani, Zejnullah (2008). *Teoria e letërsisë*. Prishtinë.
- Solar, Milivoj (2004). *Hyrje në shkencën për letërsi*. Tiranë.
- Sopaj, Nehas (2010). *Poezia dhe poeti: interpretim dhe prezantim*. Shkup.
- Vinca, Agim (1985). *Struktura e zhvillimit të poezisë së sotme shqipe (1945-1980)*. Prishtinë.
- Allan C. Orsten & Francis P. Hunkins (2003). *Kurrikula, bazat, parimet dhe problemet*. Tiranë: Instituti i Studimeve Pedagogjike.

MAShT (2016). *Kurrikula bërthamë*. Prishtinë: Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

Zylfiu, Njazi (1997). *Didaktika*. Prishtinë.

MAShT. (2011). *Korniza e Kurrikulës e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës*. Prishtinë: Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

MAShT. (2011). *Udhëzues. Standardet e Vlerësimit. 490/01 B*. Prishtinë: Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

Zeneli, I. (2003). *Bazat e standardizimit dhe vlerësimit*. Prishtinë: Libri shkollor.

Fakulteti i Edukimit në Universitetin e Prishtinës, në organizimin e studimeve postdiplomike ka të paraparë zhvillimin e tezës së masterit. Në këtë kuadër, unë kam zgjedhur të zhvilloj këtë hulumtim

“ Kriteret e përzgjedhjes së poezisë në tekstet shkollore të shkallës së tretë të kurrikulës dhe të nxënit e saj” në Komunën e Mitrovicës. Unë ju siguroj që të dhënat e mbledhura në këtë studim, do të përdoren vetëm për realizimin e qëllimit të këtij studimi. Të gjitha të dhënat janë konfidenciale.

Vërejtje: Për secilën pyetje nga një përgjigje.

SHTOJCA A

Pyetësor për nxënës

Gjinia _____

Mosha: _____

ShFMU _____

Klasa: _____

1. A ju pëlqen poezia? (*Po, Jo, S’di*)
2. A mësoni shpesh poezi? (*Rrallë, Asnjëherë, Ndonjëherë, Shpesh, Shumë shpesh*)
3. A mësoni poezi përmendsh? (*Rrallë, Asnjëherë, Ndonjëherë, Shpesh, Shumë shpesh*)
4. A i kuptoni poezitë që i mësoni në shkollë? (*Rrallë, Asnjëherë, Ndonjëherë, Shpesh, Shumë shpesh*)
5. A i komentoni poezitë që i mësoni në shkollë? (*Rrallë, Asnjëherë, Ndonjëherë, Shpesh, Shumë shpesh*)
6. A ju duken interesante poezitë që i mësoni në shkollë? (*Rrallë, Asnjëherë, Ndonjëherë, Shpesh, Shumë shpesh*)
7. A e dini ndonjë poezi që e keni mësuar në shkollë? (*Po, Jo, S’di*)

8. A ju pëlqejnë më shumë poezitë e shkruara nga shkrimtarët shqiptarë apo nga të huajt?

A. Shkrimtarët shqiptarë B. Shkrimtarët e huaj

9. A i recitoni poezitë që i mësoni, në shkollë dhe në programe shkollore?

(Rrallë, Asnjëherë, Ndonjëherë, Shpesh, Shumë shpesh)

10. A e njihni ndonjë figurë stilistike? (*Po, Jo, S'di*)

Fakulteti i Edukimit në Universitetin e Prishtinës, në organizimin e studimeve postdiplomike ka të paraparë zhvillimin e tezës së masterit. Në këtë kuadër, unë kam zgjedhur të zhvilloj këtë hulumtim

“ Kriteret e përzgjedhjes së poezisë në tekstet shkollore të shkallës së tretë të kurrikulës dhe të nxënit e saj” në Komunën e Mitrovicës. Unë ju siguroj që të dhënat e mbledhura në këtë studim, do të përdoren vetëm për realizimin e qëllimit të këtij studimi. Të gjitha të dhënat janë konfidenciale.

Vërejtje: Për secilën pyetje nga një përgjigje.

SHTOJCA B

Pyetësor për mësimdhënës

Gjinia _____

ShFMU _____

Klasa: _____

1. Sa është e përfaqësuar poezia në tekstet shkollore të letërsisë në shkallën e tretë të kurrikulës?
(Pak, Aspak, Mesatarisht, Shumë, Plotësisht)
2. Sa jeni të kënaqur me përzgjedhjen e poezive në tekstet shkollore të shkallës së tretë të kurrikulës?
(Pak, Aspak, Mesatarisht, Shumë, Plotësisht)
3. Sa janë të perceptueshme poezitë e përfshira në këto tekste? *(Pak, Aspak, Mesatarisht, Shumë, Plotësisht)*
4. Sa e kanë plotësuar kriterin e përzgjedhjes poezitë në tekstet shkollore të shkallës së tretë?
(Pak, Aspak, Mesatarisht, Shumë, Plotësisht)
5. Sa e ndiejnë nxënësit poezinë që mësohet në shkollë gjatë interpretimit? *(Pak, Aspak, Mesatarisht, Shumë, Plotësisht)*
6. Sa janë të përshtatshme me moshën e nxënësve poezitë e përfshira në tekstet shkollore të shkallës së tretë? *(Pak, Aspak, Mesatarisht, Shumë, Plotësisht)*
7. Me cilat metoda e shpjegoni poezinë? **A. Shpjegim i koncepteve dhe analizë B. Lexim, Analizë, Komentim**
8. Sa janë të vështira për t'u analizuar poezitë e përzgjedhura në këto tekste?
(Pak, Aspak, Mesatarisht, Shumë, Plotësisht)
9. Ju si mësimdhënës sa shpesh ofroni të dhëna shtesë, përveç atyre që janë në libra?
(Pak, Aspak, Mesatarisht, Shumë, Plotësisht)
10. A janë të përfshira të gjitha llojet e poezive në tekste shkollore?
(Po, Jo, S'di) Ju Faleminderit!